

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 22

numër 5

qershor 2020

Data e botimit: 10.06.2020

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.36, datë 3.6.2020 "Për miratimin e rregullores "për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS" 4
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.37, datë 3.6.2020 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin e brendshëm të funksionimit të sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH"" 51
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.38, datë 3.6.2020 "për miratimin e rregullores "Për organizimin e brendshëm të funksionimit të sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS"" 69
4. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 22, numër 1, mars 2020 91
5. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 22, numër 2, mars 2020 91
6. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 22, numër 3, prill 2020 92
7. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 22, numër 4, qershor 2020 92



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 36, datë 3.6.2020

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË
PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE – AIPS"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronjat "a" dhe "b", nenit 3, pika 4, shkronja "dh", nenit 14, nenit 21, nenit 43, shkronja "c", nenit 53, pika 4, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 13 të ligjit nr. 133/2013 "Për sistemin e pagesave"; si dhe të nenit 129, pika 6 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Emisionit dhe Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme me zbatimin e këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 53, datë 26.9.2007, "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS"", i ndryshuar.
4. Marrëveshjet tip të nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, janë të vlefshme deri në nënshkrimin e marrëveshjeve tip bashkëlidhur rregullores së miratuar me këtë vendim.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pjesëmarrësit nuk do të pajisen me certifikata pjesëmarrjeje. Certifikatat e pjesëmarrjes të lëshuara sipas rregullores që shfuqizohet nga ky vendim, nuk kanë më vlefshmëri juridike.
6. Pavarësisht këtij vendimi, vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 26, datë 8.4.2020, "Për heqjen e komisioneve të aplikuara nga bankat për transfertat e kreditit në formë joletër për klientët e tyre, si dhe të tarifave për pjesëmarrësit banka në sistemet e pagesave AIPS dhe AECH të operuara nga Banka e Shqipërisë" do të zbatohet për të gjithë periudhën e përcaktuar në përmbajtjen e tij.
7. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

RREGULLORE
“PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË PAGESAVE NDËRBANKARE ME
VLERË TË MADHE – AIPS”

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave për organizimin dhe funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe (AIPS).
2. Rregullorja përcakton kushtet për pjesëmarrjen në AIPS, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve, procedurat e përpunimit dhe shlyerjes së instruksioneve të pagesave, përfaqshjen ndaj administrimit të rrezikut, procedurat që duhet të ndiqen në rastin e ngjarjeve të paparashikuara, si dhe të gjitha kushtet e tjera në lidhje me funksionimin e sistemit.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore hartohet në bazë të:

- a) ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”;
- b) ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;
- c) ligjit “Për sistemin e pagesave”;
- d) ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”;
- e) rregullores “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)”;
- f) akteve të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë që lidhen, por nuk kufizohen me: minimumin e rezervës së detyruar, instrumentet e pagesave elektronike, kredinë brenda ditës për bankat, kredinë njëditore për bankat etj.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Subjektet e zbatimit të kësaj rregulloreje janë pjesëmarrësit e sistemit AIPS dhe Banka e Shqipërisë.

Neni 4
Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- 1) Agjent shlyerës – është personi juridik që u ofron llogari shlyerjeje pjesëmarrësve në sistemin AIPS, nëpërmjet të cilave shlyhen

- urdhërtransfertat në sistemin AIPS dhe që, në raste të veçanta, mund t'u ofrojë kredi pjesëmarrësve për qëllime shlyerjeje. Agjenti shlyerës mund të jetë edhe shtëpi klerimi;
- 2) AIP FIN Y-Copy – është një shërbim mesazhesh i ofruar nga kompania SWIFT, i përdorur në funksion të sistemit AIPS, nëpërmjet të cilit instruksionet e pagesës shkëmbehen midis anëtarëve të AIPS CUG;
 - 3) AIPSCUG (*Closed User Group*) – është grup i mbyllur i pjesëmarrësve të anëtarësuar në SWIFT e të grupuar për qëllim të përdorimit të sistemit AIPS;
 - 4) Anëtarësimi në AIPS – është procedura që një bankë ose institucion tjetër (që klasifikohet në një nga kategoritë e mundshme të pjesëmarrësve në sistemin AIPS), kryen, nën kujdesin e Bankës së Shqipërisë, për t'u bërë pjesëmarrëse në sistemin AIPS;
 - 5) Bankë – është personi juridik me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë që ushtron veprimtari bankare dhe veprimtari të tjera sipas përcaktimeve në legjislacionin bankar;
 - 6) *Cut-Off* paraprak – është afati maksimal i përcaktuar në kalendarin e sistemit AIPS për pranimin e instruksioneve të pagesave për klientët sipas Shtojcës A, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
 - 7) *Cut-Off* përfundimtar – është afati maksimal i përcaktuar në kalendarin e sistemit AIPS për pranimin e instruksioneve të pagesave ndërbankare sipas Shtojcës A;
 - 8) Certifikatë dixhitale – është një bashkësi të dhënash elektronike, të cilat shërbejnë për certifikimin e identitetit të përdoruesve gjatë përdorimit të sistemit AIPS dhe për certifikimin e autenticitetit të informacioneve të dërguara/marra;
 - 9) Datëvaluta AIPS – është data në të cilën ekzekutohet shlyerja e urdhërpagesës në sistemin AIPS;
 - 10) *Fallback Recovery* – është procedura e kthimit në një situatë normale, pasi ka pasur një dështim të funksionimit të sistemit primar;
 - 11) FIFO (*First In First Out*) – është parimi i cili bën vendosjen në radhë të instruksioneve të pagesave, në varësi të momentit të mbërritjes në sistem, dhe ku instruksioni i pagesës së parë të mbërritur në radhën e çdo pjesëmarrësi shlyhet i pari (për të njëjtin nivel përparësie);
 - 12) Instruksion pagese – është një mesazh elektronik që përmban informacionin e një kërkesë për shlyerje neto apo një urdhërpagese;
 - 13) Klerim – është procesi i transmetimit, rakordimit dhe/ose konfirmimit të instruksioneve të pagesave përpara shlyerjes, që përfshin kompensimin e instruksioneve dhe përcaktimin e pozicioneve përfundimtare për shlyerje;
 - 14) Kompensim (*netting*) – është konvertimi në një pozicion të vetëm neto, debitues ose kreditues, i të drejtave ose detyrimeve, si rezultat i të cilit vetëm një pozicion përfundimtar neto mund të kërkohet apo të jetë i detyrueshëm. Kompensimi është kontraktor dhe mund të jetë dypalësh ose shumëpalësh, me apo pa përtëritje;
 - 15) Llogari shlyerjeje – quhet llogaria e një pjesëmarrësi në sistemin AIPS, e cila përdoret për mbajtjen e fondeve (*cash-it*) dhe që shërben për të shlyer urdhërtransfertat ndërmjet pjesëmarrësve në sistemin AIPS;

- 16) Marrëveshje tip – është marrëveshja ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe
 - i. pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë, ose
 - ii. pjesëmarrësit operator të licencuar sipas ligjit “Për sistemin e pagesave”, në AIPS, sipas Shtojcës B bashkëlidhur, e cila nënshkruhet nga Drejtori në Bankën e Shqipërisë që mbulon fushën e sistemeve të pagesave;
- 17) Marrëveshje e posaçme – është marrëveshja ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ose marrëveshja ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe një pjesëmarrësi të tërthortë që do të aksesojë/kryejë aktivitetet operacional në sistemin AIPS, ose marrëveshja ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe një pjesëmarrësi operator i tipit të skemës ndërkombëtare të pagesave me kartë, e cila nënshkruhet nga Drejtori në Bankën e Shqipërisë që mbulon fushën e sistemeve të pagesave;
- 18) Mbikëqyrja (e sistemeve të pagesave) – është një funksion i bankës qendrore me anë të të cilit objektivat e sigurisë dhe eficiencës realizohen nëpërmjet monitorimit të sistemeve ekzistuese apo të planifikuara, vlerësimit të tyre kundrejt këtyre objektiveve dhe, aty ku është e nevojshme, kryerjes së ndryshimeve;
- 19) Ndërfaqe – është një komponente (*software* dhe/ose *hardware*) e ndarë ndërmjet dy sistemeve, e cila u shërben atyre për të shkëmbyer informacion;
- 20) Ngjarje e paparashikuar – është një ngjarje që shkakton probleme në funksionimin normal të sistemit AIPS;
- 21) Nivel përparësie – është niveli sipas të cilit vendoset se cilat nga pagesat e vëna në radhë janë më të rëndësishme për t’u shlyer të parat;
- 22) Operator – është personi juridik që, i vetëm ose në bashkëpunim me persona të tjerë juridikë, operon një sistem të licencuar;
- 23) Pajisje sigurie – janë *hardware* dhe *software* të konfiguruar për të implementuar procesin e krijimit dhe verifikimit të certifikatave dixhitale;
- 24) Përfitues – është pjesëmarrësi, i cili merr një instruksion pagese për kreditimin e llogarisë së tij në sistemin AIPS;
- 25) Pjesëmarrës – nënkupton Bankën e Shqipërisë, një bankë, një institucion financiar, një institucion të huaj të ngjashëm me bankat dhe institucionet financiare, një agjent shlyerës, një operator, një autoritet publik, vendas a ndërkombëtar, ose një sistem, të cilit i lejohet të dërgojë/marrë urdhërtransferta të *cash*-it me pjesëmarrësit e tjerë në sistemin AIPS;
- 26) Pjesëmarrës shlyerës – është një pjesëmarrës në sistem, i cili zotëron një ose më shumë llogari me një agjent shlyerës, në mënyrë që të shlyejë urdhërtransferta për llogari të tij dhe/ose për llogari të pjesëtarëve të tjerë të tregut. Pjesëmarrësi shlyerës mund të luajë edhe rolin e agjentit shlyerës;
- 27) Nënpjesëmarrës – është personi juridik, i cili ka marrëdhënie kontraktuese me një pjesëmarrës në një sistem që ekzekuton

- urdhërtransfertat, duke i mundësuar në këtë mënyrë personit juridik kalimin e urdhërtransfertave nëpërmjet sistemit;
- 28) Pozicion neto – i një pjesëmarrësi, është shuma e vlerës së të gjitha urdhërpagesave që ka marrë, minus vlerën e të gjitha urdhërpagesave që ka dërguar, deri në një kohë të caktuar;
 - 29) Radhë – quhet renditja e instruksioneve nga urdhëruesi ose sistemi AIPS dhe mbajtja e këtyre instruksioneve deri sa iniciuesi të sigurojë fonde të mjaftueshme për shlyerjen e tyre, nga llogaria e tij;
 - 30) Rezerva e detyruar – është një instrument i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë që synon rregullimin e ofertës së parasë, likuiditetit në sistemin bankar, si dhe ruajtjen e sigurisë së sistemit. Rezerva e detyruar mbahet në llogarinë rrjedhëse të bankave pranë Bankës së Shqipërisë;
 - 31) Rregullat dhe procedurat e sistemit AIPS – janë tërësia e akteve që rregullojnë sistemin AIPS, ku përfshihet rregullorja e sistemit AIPS, manualet e përdoruesit të sistemit AIPS dhe çdo dokumentacion tjetër, i cili u vihet në dispozicion pjesëmarrësve nga operatori;
 - 32) Rreziku i përgjithshëm i biznesit – nënkupton çdo dëmtim të mundshëm të pozitës/pozicionit financiar të sistemit, nga pikëpamja e biznesit, si pasojë e një rënieje në të ardhurat ose një rritjeje në shpenzimet e tij, në mënyrë të tillë që shpenzimet tejkalojnë të ardhurat dhe, si rrjedhojë, humbjet duhet t'i ngarkohen kapitalit;
 - 33) Rreziku i likuiditetit – përfaqëson mundësinë që një kundërpalë, qoftë pjesëmarrës apo subjekt tjetër, të mos ketë fonde të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet financiare siç pritet dhe në kohën e pritur, megjithëse mund të jetë i aftë për t'i përmbushur ato në të ardhmen;
 - 34) Rreziku operacional – përfaqëson mundësinë e realizimit të humbjeve financiare, dëmtimit të reputacionit, ose të dyja të marra së bashku, si rezultat i një apo disa shkaqeve të lidhura me: faktorin njerëzor, me papërshtatshmërinë ose dështimin e proceseve të brendshme, me papërshtatshmërinë ose dështimin e sistemeve, apo me ngjarje të jashtme;
 - 35) Seancë klerimi – është intervali kohor brenda të cilit sistemi AECH kryen klerimin me bazë neto të instruksioneve të pagesave, duke debituar apo kredituar për vlerat e tyre, llogaritë teknike përkatëse të pjesëmarrësve;
 - 36) Shlyerje – është lëvizja e fondeve midis llogarive të pjesëmarrësve të përfshirë në të në sistemin AIPS, që finalizon urdhërpagesën përkatëse;
 - 37) Shlyerje bruto – është procesi në të cilin shlyerja e fondeve ose e instruksioneve të transferimit të titujve ndodh individualisht, instruksion pas instruksioni;
 - 38) Shlyerje neto – është procesi në të cilin instruksionet e pagesave shlyhen në bazë neto;
 - 39) Shlyerje në kohë reale – është shlyerja e ekzekutuar pa vonesë, menjëherë pas marrjes së instruksionit, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje;
 - 40) Shtëpi klerimi – është personi juridik që bën llogaritjen dhe krijimin

- e pozicioneve neto për pagesat, me qëllim shlyerjen finale në AIPS, transfertat e titujve ose marrëveshjet që kanë të bëjnë me transaksionet financiare; përlllogaritje dhe/ose pozicione të tilla mund të bazohen në faktin që shtëpia e klerimit është blerës për çdo shitës dhe shitës për çdo blerës në një grup të specifikuar transaksionesh financiare;
- 41) Sistem *backup* – është tërësia e *hardware* dhe *software* të dedikuar për të shërbyer në situata emergjente, kur sistemi primar del jashtë funksionimi;
 - 42) Sistem primar – është tërësia e *hardware* dhe *software* të dedikuar për të shërbyer për funksionimin dhe kryerjen e veprimtarisë ditore të sistemit AIPS;
 - 43) Sistem test – është tërësia e *hardware* dhe *software* të dedikuar për të shërbyer për funksionimin dhe kryerjen e veprimtarisë për efekt testimi të sistemit AIPS;
 - 44) Sistem vartës (*ancillary*) – është një sistem i cili operohet nga Banka e Shqipërisë ose nga një entitet i licencuar sipas ligjit të sistemit të pagesave, dhe që realizon shkëmbime dhe/ose klerim pagesash dhe/ose instrumentesh financiare, dhe që shlyerjen e fondeve përkatëse e realizon në sistemin AIPS;
 - 45) Sistemi AECH (*Albanian Electronic Clearing House*) – është sistemi elektronik i klerimit të instruksioneve të pagesave në Lek me vlerë të vogël, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, që mundëson:
 - a) shkëmbimin e fileve të instruksioneve të pagesave midis pjesëmarrësve,
 - b) llogaritjen e pozicioneve shumëpalëshe neto,
 - c) dërgimin e një instruksioni shlyerjeje neto në sistemin AIPS;
 - 46) Sistemi AIPS (*Albanian Interbank Payment System* – Sistemi i pagesave ndërbankare me vlerë të madhe) – është sistemi i shlyerjes bruto në kohë reale të urdhërpagesave në Lek, me rëndësi sistemike, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar;
 - 47) SWIFT – varësisht nga konteksti, do të kuptohet kompania SWIFT (*Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication*), platforma dhe shërbimet e ofruara nga kompania SWIFT, tërësia e aplikacioneve (*software*) të ofruara nga kompania SWIFT të instaluar dhe në përdorim nga një institucion;
 - 48) Urdhërpagesë – është një urdhër financiar për kryerjen e një pagese në sistemin AIPS, me anë të të cilit një pjesëmarrës kërkon transferimin e fondeve;
 - 49) Urdhërues – është pjesëmarrësi i cili dërgon një instruksion pagese për debitimin e llogarisë së tij në sistemin AIPS;
 - 50) VPN (*Virtual Private Network*) – është rrjet virtual privat që përdoret për të krijuar një lidhje të sigurt, nëpërmjet rrjeteve publike të komunikimit, i cili mundëson aksesin dhe përdorimin e sistemit AIPS.

KREU II

ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E BANKËS SË SHQIPËRISË NË SISTEMIN AIPS

Neni 5

Roli i Bankës së Shqipërisë

1. Banka e Shqipërisë është pronar i sistemit AIPS.
2. Banka e Shqipërisë organizon, rregullon dhe mbikëqyr sistemin AIPS.
3. Banka e Shqipërisë është administrator dhe operator i sistemit AIPS.
4. Banka e Shqipërisë kryen funksionet e agjentit shlyerës.
5. Banka e Shqipërisë është pjesëmarrëse në shlyerje, për kryerjen e pagesave që rrjedhin nga aktiviteti i saj operacional.

NENI 6

ORGANIZIMI DHE RREGULLIMI SISTEMIT AIPS

Banka e Shqipërisë, në rolin e organizuesit dhe rregulluesit të sistemit AIPS, kryen detyrat e mëposhtme:

- a) harton aktet nënligjore të nevojshme për mirëfunksionimin dhe sigurinë e sistemit të pagesave;
- b) pranon pjesëmarrës të rinj në sistemin AIPS ose ndryshon informacionin e mbajtur që ka të bëjë me një pjesëmarrës ekzistues në këtë sistem;
- c) çel dhe mban llogaritë e shlyerjes, si dhe zhvillon procesin e shlyerjes në cilësinë e agjentit shlyerës;
- d) nënshkruan marrëveshjen tip të pjesëmarrjes me pjesëmarrësit e sistemit AIPS;
- e) ndërton mekanizma për mbulimin e nevojave për likuiditet, me qëllim shlyerjen e instruksioneve të pagesave të dërguara nga pjesëmarrësit;
- f) vendos për kufizimin e përkohshëm dhe përjashtimin e një pjesëmarrësi në/nga sistemi AIPS;
- g) siguron zhvillimin e sistemit AIPS, në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare në fushën e pagesave.

Neni 7

Administrimi dhe operimi i sistemit AIPS

Banka e Shqipërisë, në rolin e administratorit dhe operatorit të sistemit AIPS, kryen detyrat e mëposhtme:

- a) mban sistemin në gjendje pune, duke u lejuar pjesëmarrësve akses në sistem, në përputhje me oraret e punës së sistemit, si dhe me dispozitat e kësaj rregulloreje;
- b) përcakton plane emergjence, të cilat sigurojnë përmbushjen në kohë të proceseve ditore të sistemit, në rrethana të paparashikuara;

- c) administron sistemin dhe u mundëson pjesëmarrësve akses të barabartë, duke u bazuar në mekanizma të sigurt për mbrojtjen e aksesit në sistem, për autentifikimin e dërguesit të instruksionit të pagesës, për mbrojtjen e besueshmërisë dhe të konfidencialitetit të informacionit të marrë dhe të ruajtur nga AIPS;
- d) përcakton procedurat ditore të operimit dhe mirëmbajtjes teknike të sistemit;
- e) përcakton oraret e punës së sistemit AIPS, sipas Shtojcës A bashkëlidhur, dhe në rast ndryshimesh të këtyre orareve në situata të paparashikuara emergjence, për nevoja të lidhura me shlyerjen e instruksioneve të sistemeve vartëse, ose pasi vlerëson kërkesën individuale nga një pjesëmarrës siç përcaktohet në këtë rregullore, njofton menjëherë pjesëmarrësit;
- f) përcakton përfshirjen e pjesëmarrësve në sistem dhe kryen procedurat e anëtarësimit të një pjesëmarrësi të ri në sistem sipas kalendarit të anëtarësimit të hartuar dhe njoftuar nga Banka e Shqipërisë;
- g) administron sigurinë e sistemit AIPS;
- h) administron shërbimin AIP FIN Y-Copy dhe AIPS CUG;
- i) monitoron sistemin AIPS;
- j) administron ngjarjet e paparashikuara në infrastrukturën pranë Bankës së Shqipërisë, lidhur me mirëfunksionimin e sistemit AIPS.

Neni 8 **Përgjegjësitë e administratorit**

1. Banka e Shqipërisë, në cilësinë e administratorit, është përgjegjëse për dështimet e sistemit AIPS, por këto të kufizuara deri në gabimet në operacionet që administrohen dhe regjistrohen nga vetë administratori dhe vetëm për vlerat e transaksioneve të transmetuara në mënyrë të rregullt në këtë sistem.
2. Banka e Shqipërisë, në cilësinë e administratorit, nuk është përgjegjëse për rastet e mëposhtme:
 - a) dështim i sistemit AIPS që rezulton nga përdorimi jo korrekt i tij nga pjesëmarrësit;
 - b) sigurinë, cilësinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve të ofruara nga kompania SWIFT;
 - c) dëmet e shkaktuara nga instruksionet e gabuara të pjesëmarrësve apo nga gabime të instruksioneve, të cilat nuk janë kriter i përcaktuar për vlerësimin e vlefshmërisë së instruksioneve;
 - d) dëmet e shkaktuara nga mosushtrimi i përgjegjësisë së pjesëmarrësve për monitorimin e llogarive të tyre;
 - e) dëmet e shkaktuara nga mosekzekutimi i instruksioneve brenda orareve të përcaktuara, për arsye pamjaftueshmërie të fondeve;
 - f) kapacitetin për të vepruar dhe gjendjen financiare të pjesëmarrësit;
 - g) dëmet e shkaktuara nga mosushtrimi i përgjegjësisë së pjesëmarrësve për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje.

KREU III

FUNKSIONET E SISTEMIT AIPS DHE TARIFIMI

Neni 9

Objekti i sistemit

AIPS është një sistem i shlyerjes bruto në kohë reale, i cili mundëson shkëmbimin e urdhërtransfertave të *cash*-it ndërmjet pjesëmarrësve, shlyerjen e vazhdueshme, përfundimtare dhe të parevokueshme të fondeve të transferuara transaksion mbas transaksioni, shlyerjen përfundimtare dhe të parevokueshme të pozicioneve neto të llogaritura nga sistemet e shlyerjes neto, si dhe transferimin e fondeve të lidhura me veprime me instrumente financiare.

Neni 10

Pranimi për shlyerje

1. Në sistemin AIPS pranohen për shlyerje urdhërpagesat:
 - a) vetëm në monedhën kombëtare Lek;
 - b) vetëm midis pjesëmarrësve në sistem;
 - c) në çdo shumë.
2. Në sistemin AIPS pranohen për shlyerje tipet e mëposhtme të veprimeve:
 - a) transaksione të politikës monetare;
 - b) kërkesa për shlyerje nga sisteme vartëse;
 - c) urdhërpagesa ndërbankare dhe pagesa të urdhëruara nga klientë të pjesëmarrësve;
 - d) urdhërpagesa që lidhen me aktivitetin operacional të Bankës së Shqipërisë;
 - e) urdhërpagesa nga/për pjesëmarrës për të cilët Banka e Shqipërisë luan rolin e agjentit shlyerës.

Neni 11

Lista e sanksioneve dhe filtrat

1. Në sistemin AIPS implementohet lista e sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
2. Lista përditësohet çdo ditë në sistemin AIPS, sipas listës së publikuar në formatin elektronik nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
3. Transaksionet e filtruara si rezultat i përputhjes së të dhënave me ato të përcaktuara në listën e sanksioneve, kalojnë automatikisht në status: "pezull për çështje përputhshmërie me listën e sanksioneve".
4. Në rast të filtrimit të një transaksioni dhe kalimit të tij në status "pezull për çështje përputhshmërie me listën e sanksioneve", pjesëmarrësi urdhërues duhet të marrë masat për sqarimin e rastiit dhe trajtimin e tij, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore, përpara përfundimit të afateve kohore ditore të aktivitetit operacional në sistem sipas orareve të operimit të sistemit AIPS në lidhje me procesimin e transaksioneve.
5. Në rast se në përfundim të afateve kohore ditore të aktivitetit

- operacional në sistem sipas orareve të operimit të sistemit AIPS në lidhje me procesimin e transaksioneve, ka ende transaksione në statusin "pezull për çështje përputhshmërie me listën e sanksioneve", për të cilat pjesëmarrësi urdhërues nuk ka marrë masat për qartësimin e statusit dhe nuk ka kryer anulimin ose finalizimin e tyre në sistemin AIPS, Banka e Shqipërisë kryen anulimin e këtyre transaksioneve.
6. Për çdo rast ku evidentohet një transaksion i filtruar në sistemin AIPS si rezultat i përputhjes së të dhënave me ato të përcaktuara në listën e sanksioneve, njoftohet pjesëmarrësi urdhërues, si dhe njësi përkatëse mbikëqyrëse në Bankën e Shqipërisë dhe/ose autoriteti kompetent.

Neni 12 **Rakordimi, kontrolli dhe raportimi**

1. Të dhënat e sistemit AIPS janë drejtpërdrejt të aksesueshme në sistem nga pjesëmarrësit, për një periudhë prej të paktën 1 viti nga data e krijimit të këtyre të dhënave.
2. Përtej kësaj periudhe, Banka e Shqipërisë mund të kryejë arkivimin e të dhënave, duke i bërë të paaksesueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë nga pjesëmarrësit.
3. Për të dhëna të paaksesueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në sistemin AIPS nga pjesëmarrësi, Banka e Shqipërisë, në vijim të kërkesës zyrtare me shkrim të pjesëmarrësit, harton brenda 5 (pesë) ditëve pune, një raport informues për të dhënat e kërkuara nga pjesëmarrësi.
4. Sistemi AIPS prodhon raporte përmbledhëse për rakordim, në fund të çdo dite pune.
5. Sistemi AIPS ofron raporte operacionale gjatë gjithë ditës së punës, të cilat mund të përdoren për qëllime kontrolli nga Banka e Shqipërisë dhe pjesëmarrësit e tjerë.
6. Banka e Shqipërisë prodhon raporte nga informacioni/të dhënat e regjistruara në sistemin AIPS në çdo kohë dhe për këtë qëllim, ajo ka akses në të gjitha të dhënat për pjesëmarrësit.

Neni 13 **Tarifimi dhe faturimi**

1. Banka e Shqipërisë përcakton nëpërmjet modulit të faturimit të sistemit AIPS, tarifin për përdorimin e këtij sistemi, që lejojnë llogaritjen e kostove në bazë të:
 - a) llojit të instruksionit;
 - b) numrit total të pagesave gjatë periudhës së faturimit.
2. Banka e Shqipërisë, në përputhje me Shtojcën J bashkëlidhur kësaj rregulloreje:
 - a) llogarit tarifin e pagueshme për çdo pjesëmarrës në sistemin AIPS;
 - b) faturon pjesëmarrësit për detyrimet e tyre në sistemin AIPS në bazë mujore dhe në bazë vjetore;

- c) i dërgon pjesëmarrësit faturën;
- d) debiton llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësit për shumat e detyrimeve mujore, ditën e parë të punës së muajit pasardhës.
3. Çdo pjesëmarrës i drejtpërdrejtë duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme në llogarinë e tij të shlyerjes, me qëllim shlyerjen e detyrimeve ndaj Bankës së Shqipërisë për tarifën e sistemit AIPS për atë pjesëmarrës, si dhe për pjesëmarrësit operatorë me të cilët ka nënshkruar një mandat debitimi për pagesën e detyrimeve.
4. Pjesëmarrësit duhet të shlyejnë brenda muajit janar tarifën për mirëmbajtjen vjetore të sistemit AIPS për vitin në vijim.
5. Pjesëmarrësit e rinj, të cilët anëtarësohen në sistemin AIPS, duhet të shlyejnë, brenda muajit të parë të anëtarësimit, tarifën për mirëmbajtjen vjetore, në përpjesëtim me kohën e mbetur të vitit ushtrimor.
6. Pjesëmarrësit, të cilët përjashtohen nga sistemi AIPS dhe u mbyllën llogaritë e tyre në këtë sistem, duhet të shlyejnë të plotë tarifën e mirëmbajtjes vjetore të sistemit AIPS për vitin kalendarik në të cilin mbyllën llogaritë e tyre, pavarësisht nga data në të cilën mbyllën këto llogari.
7. Për pjesëmarrësit që nuk regjistrojnë në kohë urdhërtransferitën për tarifën për mirëmbajtjen vjetore të sistemit AIPS, Banka e Shqipërisë e regjistron atë manualisht në ditën e fundit të punës së muajit janar, duke debituar llogarinë përkatëse të shlyerjes së pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë, ose në rastin e operatorëve, llogarinë e pjesëmarrësit të përcaktuar në mandatin për pagesën e detyrimeve të operatorit sipas Shtojcës I.
8. Mosshlyerja e detyrimit të tarifave në sistemin AIPS, konsiderohet shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 14 Komisionet

1. Çmimi i komisioneve të aplikuara nga pjesëmarrësit për klientët e tyre për të gjitha urdhërpagesat në nisje në AIPS, nuk duhet të jetë më i lartë se 1,500 (njëmijë e pesëqind) lekë.
2. Komisionet e aplikuara nga pjesëmarrësit ndaj klientëve të tyre për investigimin e instruksioneve të pasakta të urdhërpagesave të transmetuara nëpërmjet AIPS, duhet të jenë transparente, të arsyeshme dhe të bazuara në kosto.
3. Për pagesat e urdhëruara nga klientë të pjesëmarrësve dhe që transferohen nëpërmjet sistemit AIPS, në asnjë rast, nuk duhet të aplikohen komisione për fondet në mbërritje.
4. Për pagesat në nisje të urdhëruara nga klientë të pjesëmarrësve dhe që transferohen nëpërmjet sistemit AIPS, por që janë të iniciuara në formë elektronike, me vlerë më të vogël ose të barabartë me 20 000 (njëzet mijë) lekë, nuk duhet të aplikohen komisione.
5. Për pagesat në nisje të urdhëruara nga klientë të pjesëmarrësve dhe që transferohen nëpërmjet sistemit AIPS, por që janë të iniciuara në formë elektronike, me vlerë më të madhe se 20 000 (njëzet mijë) lekë, komisionet nuk duhet të jenë më të mëdha se 50% e komisioneve të aplikuara për pagesat e iniciuara në formë joelektronike.

KREU IV PJESËMARRJA NË SISTEMIN AIPS

Neni 15 Kategoritë e pjesëmarrësve në sistemin AIPS

1. Pjesëmarrësit në sistemin AIPS kategorizohen në:
 - a) pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, të cilët kryejnë pagesat direkt nga llogaritë e tyre të shlyerjes. Në këtë kategori përfshihen nënkategoritë:
 - i. Banka e Shqipërisë,
 - ii. bankat;
 - b) pjesëmarrës të tërthortë, të cilët shlyejnë nëpërmjet llogarive të administruara nga Banka e Shqipërisë. Në këtë kategori përfshihen nënkategoritë:
 - i. Ministria e Financave dhe Ekonomisë,
 - ii. FMN (Fondi Monetar Ndërkombëtar), IBRD (Banka Botërore),
 - iii. ASD (Agjencia e Sigurimit të Depozitave) etj., që e kanë këtë të drejtë nga ligjet e organizimit të tyre.
Banka e Shqipërisë, në rolin e saj si agjent shlyerës për klientët e saj, kryen pagesa për pjesëmarrësit e tërthortë, duke administruar llogari të posaçme për ta;
 - c) pjesëmarrës operatorë, të cilët shlyejnë pozicionet e tyre nëpërmjet llogarive të shlyerjes së pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë në sistemin AIPS mbi bazë të autorizimit të dhënë për ta nga këta të fundit. Në këtë kategori përfshihen nënkategoritë:
 - i. operatorë të sistemeve të shlyerjes së titujve, operatorë të sistemeve të pagesave, operatorë të shtëpive të klerimit, operatorë të skemave kombëtare të pagesave me kartë, si dhe elementë të tjerë të rëndësishëm të sistemit kombëtar të pagesave të licencuar sipas ligjit "Për sistemin e pagesave",
 - ii. operatorë të skemave ndërkombëtare të pagesave me kartë.

Detyrimet e përcaktuara për pjesëmarrësit operatorë sipas neneve të kësaj rregulloreje nuk zbatohen për Bankën e Shqipërisë kur ajo është në rolin e operatorit.

Neni 16 Kushtet për pjesëmarrje në sistemin AIPS

1. Bankat që kërkojnë të anëtarësohen si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në sistemin AIPS duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - a) të kenë hartuar rregulla të brendshme operimi për sistemin AIPS, sipas udhëzimeve të Bankës së Shqipërisë;
 - b) të kenë hartuar rregulla dhe procedura në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e informacionit që shkëmbehet ndërmjet sistemeve të tyre të brendshme dhe sistemit AIPS, aty ku është e aplikueshme;
 - c) të kenë hartuar plane të emergjencës në lidhje me operimin në

- sistemin AIPS dhe ndërfaqësimin (aty ku është e aplikueshme) me të;
- d) të kenë personel të kualifikuar dhe të trajnuar për operimin në sistemin AIPS;
 - e) të kenë ndjekur fazat e kalendarit të anëtarësimit sipas instruksioneve të Bankës së Shqipërisë;
 - f) të marrin pjesë në sistemin AIPS vetëm nëpërmjet drejtorive qendrore të tyre;
 - g) të kenë nënshkruar marrëveshjen tip të pjesëmarrjes në sistemin AIPS me Bankën e Shqipërisë;
 - h) çdo kandidat për pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në sistemin AIPS duhet të jetë paraprakisht anëtar i AIPS CUG dhe anëtarësimi mund të kryhet pas plotësimit paraprak të kushteve të mëposhtme:
 - i. të ketë një kod BIC aktiv nga kompania SWIFT,
 - ii. të zotërojë një infrastrukturë për përdorimin e SWIFT.
2. Banka e Shqipërisë çel dhe mban llogari, si dhe pranon për shlyerje urdhërpagesat për pjesëmarrësit e tërthortë. Subjektet që kërkojnë të anëtarësohen si pjesëmarrës të tërthortë në sistemin AIPS, dhe që do të aksesojnë/kryejnë aktivitetet operacional në sistemin AIPS, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
- a) të kenë hartuar rregulla të brendshme operimi për sistemin AIPS, sipas udhëzimeve të Bankës së Shqipërisë;
 - b) të kenë hartuar rregulla dhe procedura në lidhje me sigurinë e transmetimit të informacionit/instruksioneve nga sistemet e tyre të brendshme për në sistemin AIPS, aty ku është e aplikueshme;
 - c) të kenë hartuar plane të emergjencës në lidhje me operimin në sistemin AIPS dhe ndërfaqësimin (aty ku është e aplikueshme) me të;
 - d) të kenë personel të kualifikuar dhe të trajnuar për operimin në sistemin AIPS;
 - e) të marrin pjesë në sistemin AIPS vetëm nëpërmjet drejtorive qendrore të tyre;
 - f) të kenë nënshkruar një marrëveshje të posaçme të pjesëmarrjes në sistemin AIPS me Bankën e Shqipërisë.
3. Subjektet që kërkojnë të anëtarësohen si pjesëmarrës operatorë në sistemin AIPS duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
- a) të kenë hartuar rregulla të brendshme operimi për sistemin AIPS, sipas udhëzimeve të Bankës së Shqipërisë;
 - b) të kenë hartuar rregulla dhe procedura në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e informacionit që shkëmbehet ndërmjet sistemeve të tyre të brendshme dhe sistemit AIPS, aty ku është e aplikueshme;
 - c) të kenë hartuar plane të emergjencës në lidhje me operimin në sistemin AIPS dhe ndërfaqësimin (aty ku është e aplikueshme) me të;
 - d) të kenë personel të kualifikuar dhe të trajnuar për operimin në lidhje me sistemin AIPS;
 - e) të kenë ndjekur fazat e kalendarit të anëtarësimit sipas

- instruksioneve të Bankës së Shqipërisë;
- f) të kenë nënshkruar marrëveshjen tip të pjesëmarrjes në sistemin AIPS ose, në rastin e skemave ndërkombëtare të pagesave me kartë, një marrëveshje të posaçme me Bankën e Shqipërisë;
 - g) të kenë një kod BIC aktiv nga kompania SWIFT dhe mundësinë për të komunikuar me AIPS nëpërmjet një shërbimi SWIFT të dakorduar me Bankën e Shqipërisë.

Neni 17 Anëtarësimi në AIPS

Procedura për anëtarësim si pjesëmarrës në sistemin AIPS kalon në hapat e mëposhtëm.

1. Kandidati për pjesëmarrës paraqet pranë Bankës së Shqipërisë një kërkesë me shkrim për anëtarësimin e tij në sistemin AIPS.
2. Banka e Shqipërisë shqyrton kërkesën e kandidatit për anëtarësim dhe i kthen përgjigje të argumentuar për miratimin ose jo të kërkesës, brenda 10 ditëve pune nga marrja e kërkesës.
3. Në rast miratimi të kërkesës, Banka e Shqipërisë, brenda një jave nga miratimi, informon kandidatin për përmbajtjen e kësaj rregulloreje, tarifat e pjesëmarrjes në sistemin AIPS, si dhe kërkesat teknike që ai duhet të përmbushë.
4. Banka e Shqipërisë dhe kandidati, në bashkëpunim, zbatojnë kalendarin e anëtarësimit të njoftuar nga Banka e Shqipërisë.
5. Banka e Shqipërisë, aty ku është e aplikueshme, trajnon përdoruesit e ardhshëm të kandidatit dhe drejton testimet me kandidatin.
6. Pas përfundimit me sukses të provave dhe pasi sigurohet për përputhshmërinë e rregullave të brendshme të kandidatit me këtë rregullore, Banka e Shqipërisë mundëson fillimin e veprimtarisë së kandidatit në sistemin AIPS.
7. Në rastin e pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë banka ose pjesëmarrësve operatorë të nënkategorisë "i", kandidati për pjesëmarrës nënshkruan marrëveshjen tip të pjesëmarrjes në sistemin AIPS me Bankën e Shqipërisë, sipas Shtojcës B bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
8. Kandidatët për pjesëmarrës të tërthortë në sistemin AIPS që do të aksesojnë/kryejnë aktivitetet operacional në sistemin AIPS, si dhe kandidatët për pjesëmarrës operator të nënkategorisë "ii". nënshkruajnë një marrëveshje të posaçme të pjesëmarrjes në sistemin AIPS me Bankën e Shqipërisë.
9. Në rastin kur pjesëmarrësi do të aksesojë sistemin AIPS nëpërmjet përdoruesve të tij:
 - a) kandidati për pjesëmarrës plotëson formularët në Shtojcën C dhe Shtojcën D bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
 - b) Banka e Shqipërisë kryen veprimet e saj për krijimin e përdoruesve në sistemin AIPS, VPN, si dhe shkruan certifikatat e sigurisë dhe i dorëzon pajisjet e sigurisë pjesëmarrësit.
10. Në rastin e pjesëmarrësve operatorë të nënkategorisë "i":
 - a) kandidati për pjesëmarrës plotëson formularët në Shtojcën G, Shtojcën H dhe Shtojcën I bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

- b) pas marrjes së formularëve me nënshkrimet e autorizimet përkatëse, Banka e Shqipërisë merr masat për konfigurimet e duhura.
11. Banka e Shqipërisë njofton të gjithë pjesëmarrësit e sistemit AIPS për emrin dhe adresën e saktë të pjesëmarrësit të ri, si dhe për datën në të cilën pjesëmarrësit do t'i jepet akses apo do të operojë në sistemin AIPS, të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara kësaj date.

Neni 18

Detyrimet e pjesëmarrësve në sistemin AIPS

1. Pjesëmarrësi në sistemin AIPS ka detyrimet e mëposhtme:
 - a) të zbatojë rregullat dhe procedurat e sistemit AIPS;
 - b) të kryejë aktivitetin e tij operacional në lidhje me sistemin AIPS në çdo kohë gjatë ditës së operimit, duke respektuar oraret e operimit të sistemit AIPS, sipas Shtojcës A bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
2. Në rastet kur pjesëmarrësi akseson sistemin AIPS nëpërmjet përdoruesve të tij:
 - a) të sigurojë personel të kualifikuar për operim në sistemin AIPS;
 - b) për caktimin e personelit që do të operojë në sistemin AIPS, të ndjekë e zbatojë rregulla të brendshme të bazuara në garantimin e sigurisë së informacionit në sistem;
 - c) të njoftojë pa vonesa Bankën e Shqipërisë, në rast të lëvizjes së personelit që ka operuar në sistemin AIPS, për marrjen e masave në lidhje me përdoruesin në sistem;
 - d) të raportojë në Bankën e Shqipërisë për çdo shkelje të vërejtur apo të dyshuar të sigurisë në sistemin AIPS, sipas Shtojcës F bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
3. Në rastet kur ka ndërfaqësim apo komunikim elektronik ndërmjet sistemeve të pjesëmarrësit dhe sistemit AIPS, si dhe në rastet kur pjesëmarrësi ka akses në sistemin AIPS:
 - a) të hartojë procedura të brendshme për sigurinë dhe për mbrojtjen e informacionit që shkëmbehet ndërmjet sistemeve të tij të brendshme dhe sistemit AIPS, duke përfshirë procedurat organizative (burimet njerëzore dhe pajisjet) dhe ato informatike (elementet *hardware* dhe *software*), në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje;
 - b) të administrojë sistemet e tij lokale për të garantuar vazhdimësinë dhe dërgimin e instruksioneve të pagesave në sistemin AIPS;
 - c) të sigurojë integritet të transaksioneve dhe akses të kontrolluar të përdoruesve brenda institucionit përkatës duke:
 - i. lokalizuar çdo pikëlidhje primare apo *backup* në sistemin AIPS vetëm aty ku ka akses të përshtatshëm për mjetet dixhitale të telekomunikimit, për konfigurimet e duhura të autenticitetit dhe të mjeteve të sigurisë, si dhe të garantohet që aksesit apo ndërfaqësimi me sistemin AIPS nuk do të jetë subjekt i ndërprerjeve apo i ndërhyrjeve të shkaktuara nga faktorë të brendshëm apo të jashtëm,

- ii. zbatuar parimin e "katër syve" për autorizimin e urdhërpagesës, duke caktuar përdorues të ndryshëm për regjistrim dhe aprovim të të dhënave,
 - iii. kryer ekzekutimin e instruksioneve të pagesës, sipas procedurave që respektojnë të drejtat minimale, në përputhje me rolin dhe përgjegjësitë e kategorive të ndryshme të personelit,
 - iv. kryer procedura identifikuese në çdo hallkë të komunikimit midis sistemeve të brendshme të tij dhe shërbimit SWIFT, nëpërmjet të cilit komunikon me sistemin AIPS,
 - v. audituar çdo refuzim, korigjim apo anulim të instruksioneve të pagesave,
 - vi. regjistruar të gjitha komunikimet elektronike që lidhen me instruksionet e pagesave dhe duke shënuar kohën e transmetimit.
4. Të transmetojë pagesat në sistemin AIPS vetëm mbi bazën e një dokumenti të vlefshëm justifikues.
 5. Të kryejë njoftimin e nënshkrimeve të autorizuara në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
 6. Të kryejë kontrollin dhe filtrimin e pagesave që do të procesojë/autorizojë për në sistemin AIPS kundrejt listës së sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, në përputhje me dispozitat ligjore dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje.
 7. Të ruajë regjistrimet e transaksioneve në kopje letër dhe në format elektronik për një periudhë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet, sipas standardeve dhe rregullave kontabël në fuqi.
 8. Të hartojë një plan emergjence, i cili garanton përbushjen në kohë të veprimeve ditore të pjesëmarrësit nëpërmjet sistemit AIPS në rrethana të paparashikuara.
 9. Të kryejë vlerësime periodike të integritetit dhe të qëndrueshmërisë së pajisjeve dhe sistemeve të tij të brendshme që lidhen me sistemin AIPS. Këto vlerësime kryhen sipas Shtojcës E bashkëlidhur kësaj rregulloreje, dhe dërgohen zyrtarisht në Bankën e Shqipërisë, çdo muaj janar.
 10. Në rast shkeljeje të detyrimeve të mësipërme, Banka e Shqipërisë i dërgon shkresë zyrtare pjesëmarrësit, si dhe informohet njësisë përkatëse mbikëqyrëse në Bankën e Shqipërisë.

Neni 19

Detyrimet e pjesëmarrësit që luan rolin e pjesëmarrësit shlyerës për palë të tjera

Pjesëmarrësi në sistemin AIPS i cili luan rolin e pjesëmarrësit shlyerës për palë të tjera, veç detyrimeve të përcaktuara për të gjithë pjesëmarrësit, ka edhe detyrimet si më poshtë.

1. Duhet të ofrojë të njëjtat mundësi në mënyrë objektive, proporcionale dhe jodiskriminuese për pjesëmarrësit e tregut, përfshirë subjektet financiare jobanka të përfshira në aktivitetin e pagesave, transfertave dhe emetimit të parasë elektronike.

2. Të japë informacion pranë Bankës së Shqipërisë, mbi nënpjesëmarrësit për të cilët luan rolin e pjesëmarrësit shlyerës dhe/ose agjentit shlyerës.
3. Të ketë nënshkruar një marrëveshje me palën për të cilën luan rolin e pjesëmarrësit shlyerës dhe për këtë të njoftojë zyrtarisht Bankën e Shqipërisë.
4. Marrëveshja të ketë të përcaktuar qartë detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve në lidhje me shlyerjen dhe përmbushjen e detyrimeve të pjesëmarrësit shlyerës në AIPS, me qëllim që të garantohet përmbushja e detyrimeve të pjesëmarrësit (që nuk ka llogari shlyerje) në sistemin origjinues.
5. Të përfshijë në marrëveshje përcaktime të tilla të cilat të mbrojnë sistemin kundrejt rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional dhe rrezikut të përgjithshëm të biznesit, si dhe të mbrojnë qëndrueshmërinë financiare dhe operationale të sistemit.
6. Të njoftojë zyrtarisht pa vonesa operatorin në rast zgjidhje ose çdo ndryshimi në marrëveshjen me palën për të cilën luan rolin e pjesëmarrësit shlyerës.
7. Të sigurojë në llogarinë e tij të shlyerjes fonde të mjaftueshme për shlyerjen e transaksioneve me origjinë nga sisteme të tjera dhe të urdhëruara nga pjesëmarrës të atyre sistemeve për të cilat ky pjesëmarrës është shlyerës në sistemin AIPS.
8. Komisionet e aplikuara nga pjesëmarrësi shlyerës duhet të jenë transparente, të artikuluara qartë dhe të bazuara në kosto.
9. Në rast shkeljeje të detyrimeve të mësipërme, i dërgohet shkresë zyrtare pjesëmarrësit, si dhe informohet njësia përkatëse mbikëqyrëse në Bankën e Shqipërisë.

Neni 20

Detyrimet e pjesëmarrësit operator në sistemin AIPS

1. Pjesëmarrësi në sistemin AIPS i cili përfshihet në kategorinë e pjesëmarrësve operatorë, veç detyrimeve të përcaktuara për të gjithë pjesëmarrësit, ka edhe detyrimet si më poshtë:
 - a) të ketë nënshkruar marrëveshje me secilën nga palët (banka/ pjesëmarrës shlyerës) për llogari të të cilëve do të urdhërojë instruksione pagesash për shlyerje në sistemin AIPS, dhe mbi këtë të njoftojë zyrtarisht Bankën e Shqipërisë:
 - i. marrëveshja të ketë të përcaktuara qartësisht detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve në lidhje me shlyerjen dhe përmbushjen e detyrimeve të pjesëmarrësit shlyerës në AIPS, me qëllim që të sigurohet shlyerja e instruksioneve të pagesave pa vonesa në sistemin AIPS,
 - ii. marrëveshja të përfshijë përcaktime të cilat të mbrojnë sistemin kundrejt rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional dhe rrezikut të përgjithshëm të biznesit, si dhe të mbrojnë qëndrueshmërinë financiare dhe operationale të sistemit;
 - b) të dërgojë për shlyerje në sistemin AIPS vetëm instruksione që përfshijnë pjesëmarrës të sistemit AIPS me të cilët operatori ka

- marrëveshje, siç përcaktohet në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, për të urdhëruar instruksione të tilla.
2. Pjesëmarrësi në sistemin AIPS i cili përfshihet në kategorinë e pjesëmarrësve operatorë, nënkategoria "i", veç detyrimeve të përcaktuara në pikën 1 për të gjithë pjesëmarrësit operatorë, ka edhe detyrimet si më poshtë:
 - a) të ketë përcaktuar listën e bankave/pjesëmarrësve shlyerës, duke e paraqitur pranë Bankës së Shqipërisë këtë informacion, nëpërmjet formularit në Shtojcën G;
 - b) të plotësojë së bashku me secilën bankë/pjesëmarrës shlyerës dhe të dorëzojë pranë Bankës së Shqipërisë mandatet e debitimit sipas Shtojcës H;
 - c) të njoftojë zyrtarisht pa asnjë vonesë Bankën e Shqipërisë në rast zgjidhje ose çdo ndryshimi në marrëveshjen me palën për llogari të së cilës do të urdhërojë instruksione pagesash për shlyerje në sistemin AIPS, e për rrjedhojë për çdo ndryshim në listën e bankave/pjesëmarrësve shlyerës, duke plotësuar dhe dorëzuar një formular të ri sipas Shtojcës G, si dhe formularët përkatës sipas Shtojcës H për çdo fshirje, modifikim, apo shtim të një banke/pjesëmarrësi shlyerës të ri për pjesëmarrësin operator;
 - d) të plotësojë së bashku me një nga pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë të sistemit AIPS dhe të dorëzojë pranë Bankës së Shqipërisë mandatin e debitimit për pagesën e detyrimeve sipas Shtojcës I. Çdo ndryshim në mandatin e debitimit për pagesën e detyrimeve duhet të shoqërohet me plotësimin e formularëve përkatës sipas Shtojcës I;
 - e) kur autoriteti kompetent përkatës i kërkon pjesëmarrësit operator të mbajë një fond garancie për qëllime të administrimit të rrezikut në lidhje me shlyerjen e transaksioneve të tyre në sistemin AIPS, pjesëmarrësi operator nënshkruan një marrëveshje me bankat e përfshira në këtë kuadër, ku të përcaktohen termat e mbajtjes, përdorimit dhe administrimit të fondit të garancisë.
 3. Në rast shkeljeje të detyrimeve të mësipërme, i dërgohet shkresë zyrtare pjesëmarrësit, si dhe informohet njësia përkatëse mbikëqyrëse në Bankën e Shqipërisë.

Neni 21 Njoftimi i nënshkrimeve të autorizuara

1. Çdo vit, brenda muajit janar, pjesëmarrësit duhet të dërgojnë pranë Bankës së Shqipërisë listën më të fundit të nënshkrimeve të autorizuara (të shoqëruar me kategoritë dhe limitet përkatëse), të cilat pjesëmarrësit mund t'i përdorin:
 - a) për nënshkrimin e formularëve shtojca të kësaj rregulloreje;
 - b) në raste të ngjarjeve të paparashikuara për të instruktuar Bankën e Shqipërisë për ekzekutimin e instruksioneve të pagesave në sistemin AIPS, në pamundësi të vetë pjesëmarrësit, siç parashikohet në dispozitat e kësaj rregulloreje.

- Limitet e përcaktuara duhet të konsiderohen si kufi për vlerën e instruksionit të pagesës që kërkohet të ekzekutohet.
2. Kjo listë duhet të përmbajë vetëm nënshkrimet e autorizuara, të cilat mund të përdoren për qëllimet e listuara në pikën 1 të këtij neni dhe jo nënshkrime të tjera.
 3. Çdo ndryshim në listën e nënshkrimeve të autorizuar që mund të përdoren për qëllimet e listuara në pikën 1 të këtij neni, i njoftohet menjëherë Bankës së Shqipërisë.

Neni 22

Kufizimi i përkohshëm i pjesëmarrësit në sistemin AIPS

1. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kufizojë përkohësisht një pjesëmarrës në sistemin AIPS, në rast se plotësohet të paktën një nga rrethanat e mëposhtme:
 - a) kufiri i përkohshëm gjë kërkohet zyrtarisht nga vetë pjesëmarrësi;
 - b) paaftësi e pjesëmarrësit për ekzekutimin e një kërkesë për shlyerje të regjistruar nga një operator sistemi;
 - c) paaftësi e pjesëmarrësit për të kthyer fondet e përdorura të kredisë njëditore bashkë me interesin, brenda ditës pasardhëse të punës;
 - d) vëren se operimi në sistem i pjesëmarrësit mund të përbëjë kërcënim të ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar.
2. Një pjesëmarrës i kufizuar përkohësisht në sistemin AIPS ka të drejtë të aksesojë sistemin AIPS për qëllime monitorimi, por nuk mund të shlyejë pagesa nga/për pjesëmarrësit e tjerë.
3. Banka e Shqipërisë njofton menjëherë për vendimin për kufizim të përkohshëm të një pjesëmarrësi në sistemin AIPS:
 - a) me shkresë zyrtare, pjesëmarrësin subjekt të vendimit të lartpërmendur;
 - b) me mesazh SWIFT tekst dhe/ose shkresë zyrtare, pjesëmarrësit e sistemit AIPS.
4. Banka e Shqipërisë vendos për heqjen e kufizimit të përkohshëm të pjesëmarrësit atëherë kur:
 - a) kërkohet riaktivizimi i aksesit në sistem nga ana e pjesëmarrësit, pas kufizimit të përkohshëm të kryer me kërkesë të tij;
 - b) pjesëmarrësi siguron në llogarinë e tij të shlyerjes fonde të mjaftueshme për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të tij korrente në sistemin AIPS;
 - c) si dhe nuk përbën kërcënim të ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar.
5. Banka e Shqipërisë njofton menjëherë për heqjen e kufizimit të përkohshëm të pjesëmarrësit në sistemin AIPS:
 - a) me shkresë zyrtare, pjesëmarrësin subjekt të vendimit të lartpërmendur;
 - b) me mesazh SWIFT tekst dhe/ose shkresë zyrtare, pjesëmarrësit e sistemit AIPS.

Neni 23 Përfundimi i një pjesëmarrësi nga sistemi AIPS

1. Banka e Shqipërisë vendos për përfundimin e një pjesëmarrësi nga sistemi AIPS, kur plotësohet të paktën njëra nga rrethanat e mëposhtme:
 - a) me kërkesë zyrtare me shkrim të vetë pjesëmarrësit, dhe menjëherë pas miratimit nga Banka e Shqipërisë;
 - b) pjesëmarrësi bashkohet/përthithet me/nga një/disa bankë/a në një të vetme;
 - c) pjesëmarrësi, i cili është kufizuar përkohësisht në sistemin AIPS, nuk siguron fonde të mjaftueshme në llogarinë e tij të shlyerjes brenda ditës pasardhëse nga dita e kufizimit të përkohshëm;
 - d) pjesëmarrësi shkel në mënyrë të përsëritur dispozitat e kësaj rregulloreje;
 - e) pjesëmarrësi vendoset në proces likuidimi/falimentimi dhe i revokohet (shfuqizohet) licenca nga Banka e Shqipërisë dhe/ose nga autoritetet përgjegjëse të përfshira në rastin e operatorëve.
2. Banka e Shqipërisë njofton menjëherë për vendimin e përfundimit të një pjesëmarrësi nga sistemi AIPS:
 - a) me shkresë zyrtare, pjesëmarrësin subjekt të vendimit të lartpërmendur;
 - b) me mesazh SWIFT tekst dhe/ose shkresë zyrtare, pjesëmarrësit e sistemit AIPS.
3. Në rastin e përfundimit të një pjesëmarrësi nga sistemi AIPS, Banka e Shqipërisë ndjek hapat e mëposhtëm:
 - a) në përputhje me afatin e parashikuar në vendimin për përfundimin e pjesëmarrësit, bllokon aksesin e pjesëmarrësit të përfunduar në sistemin AIPS;
 - b) në përputhje me afatin e parashikuar në vendimin për përfundimin e pjesëmarrësit, kryen procedurat teknike në sistemin AIPS për të garantuar bllokimin e instruksioneve të pagesave ndërmjet pjesëmarrësve që prekin llogarinë e pjesëmarrësit subjekt i përfundimit;
 - c) kryen procedurat e përcaktuara nga SWIFT-i për përfundimin e pjesëmarrësit nga AIPS CUG, në rastin e pjesëmarrësve anëtarë të CUG;
 - d) për qëllime të regjistrimit/gjenerimit të veprimeve të lidhura me detyrime të pjesëmarrësit të cilat administrohen në sistemin AIPS, si dhe administrimit të rezervës së detyruar ose elemente të ngjashme, krijon teknikisht mundësitë për realizimin e tyre, duke e mbajtur llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësit të përdorshme nga Banka e Shqipërisë, deri në afatin e përcaktuar për realizimin e këtyre veprimtarive;
 - e) në rastin e përfundimit të pjesëmarrësit për arsye të bashkimit/përthithjes me/nga një/disa bankë/a, mund të vijojë të mbajë aktive llogarinë e shlyerjes, si dhe të lejojë operimin e pjesëmarrësit subjekt i përfundimit për një periudhë të kufizuar kohe, me qëllim realizimin e bashkimit/përthithjes

- operacionale në vijim të atij/asaj juridik/e, bazuar në afatin e përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;
- f) detyrimi për shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit AIPS për pjesëmarrësin që përjashtohet, llogaritet si tarifë fikse e mirëmbajtjes vjetore të sistemit AIPS, dhe paguhet i plotë, pavarësisht nga koha (brenda atij viti ushtrimor) në të cilën ndodh realisht ndërprerja e operimit të pjesëmarrësit në sistemin AIPS;
 - g) pas gjenerimit/regjistrimit të të gjitha detyrimeve të pjesëmarrësit, mbyll llogarinë e pjesëmarrësit të përjashtuar në sistemin AIPS.

Neni 24 Ankimi

1. Çdo pjesëmarrës ndaj të cilit Banka e Shqipërisë ka marrë vendim për kufizim të përkohshëm dhe/ose përjashtim nga sistemi AIPS, ka të drejtë të kërkojë shfuqizimin ose ndryshimin e këtij akti nga Guvernatori, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për aktin.
2. Pas realizimit të ankimit administrativ tek Guvernatori, pjesëmarrësi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës së Apelit.
3. Ankimi administrativ nuk e pezullon zbatimin e aktit administrativ të nxjerrë nga Banka, në rastet kur kjo e fundit çmon se stabiliteti i sistemit financiar në tërësi, mund të cenohet apo të rrezikohet nga efekti pezullues i ankimit.
4. Paraqitja dhe shqyrtimi i ankimit administrativ bëhet sipas formës, procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

KREU V SHLYERJA NË SISTEMIN AIPS

Neni 25 Ditët dhe oraret e operimit të sistemit

1. Sistemi AIPS operon në ditët e punës sipas kalendarit zyrtar në Republikën e Shqipërisë.
2. Me orë të punës së sistemit, nënkuptohen orët e operimit në sistem siç specifikohet në Shtojcën A, pra koha gjatë së cilës sistemi është në dispozicion të pjesëmarrësve për ta aksesuar dhe për të kryer aktivitetet në të.
3. Banka e Shqipërisë ka të drejtën të ndryshojë oraret në situata të paparashikuara emergjence, për nevoja të lidhura me shlyerjen e instruksioneve të sistemeve vartëse, ose pasi vlerëson një kërkesë individuale nga një pjesëmarrës.
4. Pjesëmarrësit njoftohen për çdo ndryshim si më sipër të orarit nëpërmjet njoftimeve automatike të sistemit AIPS dhe/ose me mesazh SWIFT tekst, dhe/ose e-mail.

Neni 26

Karakteri përfundimtar i pagesës dhe shlyerjes

1. Shlyerja e një instruksioni pagese konsiderohet përfundimtare për pjesëmarrësit urdhërues dhe përfitues që nga momenti i debitimit dhe kreditimit të llogarive përkatëse të shlyerjeve.
2. Një instruksion pagese është i parevokueshëm nga pjesëmarrësi apo administratori i sistemit, nga momenti i ekzekutimit të shlyerjes në sistemin AIPS.
3. Shlyerja e një urdhërpagese kryhet menjëherë pas hyrjes së saj në sistemin AIPS, në rast se pjesëmarrësi/t sigurojnë një tepricë të mjaftueshme fondesh për të mbuluar shlyerjen.
4. Tërheqja e urdhërpagesës nuk mund të kryhet pas shlyerjes së saj, por mund të kthehet me kah të kundërt, iniciuar nga pala tjetër.

Neni 27

Pranimi i transaksioneve të urdhërpagesave

1. Transaksionet e pranuar nga sistemi AIPS ekzekutohen në datën e valutës.
2. Sistemi AIPS pranon instruksione pagese me datëvalutë të ardhme deri në 5 (pesë) ditë pune nga data e punës e sistemit.
3. Transaksionet e pranuar nga sistemi AIPS ruhen deri sa dita e punës e sistemit të përputhet me datëvalutën e përcaktuar nga pjesëmarrësi.
4. Transaksionet me datëvalutë të ardhme të pranuar nga sistemi AIPS mund të fshihen nga vetë pjesëmarrësit, për sa kohë dita e punës e sistemit nuk është përputhur ende me datëvalutën e përcaktuar nga pjesëmarrësi.
5. Transaksionet me datëvalutë më të largët se 5 (pesë) ditë pune nga data e punës e sistemit, ose me datëvalutë që nuk përkon me një ditë pune të sistemit, refuzohen nga sistemi AIPS.

Neni 28

Kontrolli për mjaftueshmërinë e fondeve

1. Çdo transaksion ekzekutohet vetëm në rast se ka fonde të mjaftueshme në llogarinë/llogaritë që debitohet/debitohen.
2. Mjaftueshmëria e fondeve në llogarinë e pjesëmarrësit përcaktohet nga teprica e llogarisë, si dhe nga minimumi i rezervës së detyruar, në rastin e pjesëmarrësve për të cilët aplikohet rezerva e detyruar.
3. Në përlllogaritjen e mjaftueshmërisë së fondeve për ekzekutimin e një transaksioni, merren parasysh edhe rezervat e ndryshme të krijuara për qëllime të dedikuara.
4. Pjesëmarrësit monitorojnë tepricën e llogarisë përkatëse dhe marrin masa për sigurimin e likuiditeteve të nevojshme për shlyerjen e urdhërpagesave.

Neni 29 Radha e pagesave

1. Radhitja për ekzekutim dhe kontrolli i urdhërpagesave kryhet mbi bazën e parimit *First-In-First-Out* (FIFO) dhe mbi bazën e përparësisë së dhënë urdhërpagesave nga pjesëmarrësit.
2. Urdhërpagesat të cilat nuk mund të ekzekutohen për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve në llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësit, vendosen nga sistemi AIPS në radhë pritjeje dhe rikontrollohen nga sistemi sa herë që ndryshojnë të dhënat mbi fondet në llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësit.
3. Kontrolli nga sistemi AIPS për mjaftueshmërinë e fondeve në llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësit bëhet vetëm për urdhërpagesën e parë të radhës së këtij pjesëmarrësi.
4. Ndryshimi i kësaj radhitjeje mund të bëhet vetëm në rastet e parashikuara në këtë rregullore.

Neni 30 Administrimi i përparësisë së transaksioneve

1. Përparësia e transaksioneve përcaktohet në vlerë numerike të plotë. Sa më e vogël vlera e përparësisë së një transaksioni, aq më prioritar është ai transaksion në radhën për ekzekutim.
2. Për çdo tip transaksioni në sistemin AIPS paracaktohet një vlerë përparësie nga Banka e Shqipërisë.
3. Në momentin e vendosjes në radhë, transaksioni merr si përparësi vlerën e paracaktuar të atij tipi transaksioni. Përparësia e transaksionit në radhë mund të ndryshohet më pas nga pjesëmarrësi siç parashikohet në këtë rregullore, duke respektuar kufijtë e paracaktuar të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar për atë transaksion.
4. Përparësi më e lartë i jepet instruksionit të kthimit të kredisë njëditore.
5. Pas instruksionit të kthimit të kredisë njëditore, përparësi më e lartë i jepet instruksionit të shlyerjes neto (NSI).
6. Pas instruksionit të shlyerjes neto (NSI), përparësi më e lartë i jepet urdhërpagesave të iniciuara nga Banka e Shqipërisë.
7. Pas urdhërpagesave të iniciuara nga Banka e Shqipërisë, përparësi më e lartë i jepet mesazheve SWIFT të dërguara me prioritet urgjent nga pjesëmarrësit, me përjashtim të Bankës së Shqipërisë.
8. Pas mesazheve SWIFT të dërguara me prioritet urgjent nga pjesëmarrësit, përparësi më e lartë i jepet mesazheve SWIFT të dërguara me prioritet normal nga pjesëmarrësit, me përjashtim të Bankës së Shqipërisë.

Neni 31 Ndryshimi i radhitjes së urdhërpagesave

1. Me përjashtim të instruksioneve për kthimin e kredisë njëditore, të shlyerjes neto (NSI) dhe urdhërpagesave të iniciuara nga Banka e Shqipërisë, çdo pjesëmarrës që ka të drejta të mjaftueshme

- dhe akseson sistemin AIPS, mund të ndryshojë radhitjen e urdhërpagesave të veta, duke ndryshuar vlerën e përparësisë.
2. Çdo pjesëmarrës i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni mund të ndryshojë radhitjen e urdhërpagesave të veta, të cilat janë ende të pushlyera në radhë, brenda intervalit të përparësisë për atë tip transaksioni.
 3. Ndryshimi i radhitjes së urdhërpagesave mund të kryhet gjithashtu nga Banka e Shqipërisë, kur kërkohet nga pjesëmarrësi.

Neni 32 **Fshirja e një pagese në radhë**

1. Instruksionet e pagesave të pushlyera në radhë, mund të fshihen nga vetë pjesëmarrësi që i ka iniciuar.
2. Instruksionet e pagesave të pushlyera në radhë, mund të fshihen në çdo kohë nga Banka e Shqipërisë në cilësinë e administratorit të sistemit:
 - a) me kërkesë të pjesëmarrësit;
 - b) kur lind e nevojshme dhe Banka e Shqipërisë çmon se pjesëmarrësi, për shkak të problemeve teknike, nuk mund ta administrojë radhën përkatëse.
3. Gjatë mbylljes së ditës, nëse ka instruksione pagese të pushlyera në radhën e një pjesëmarrësi, ato fshihen automatikisht nga sistemi AIPS.

Neni 33 **Pagesat e refuzuara gjatë ditës**

Refuzohen automatikisht nga sistemi AIPS:

- a) urdhërpagesat për llogari të klientëve të pjesëmarrësve, të cilat hyjnë në këtë sistem pas *cut-off* paraprak;
- b) urdhërpagesat ndërbankare, të cilat hyjnë në sistem pas *cut-off* përfundimtar;
- c) urdhërpagesat të cilat sistemi i vlerëson si të pasakta.

Neni 34 **Shlyerjet neto**

1. Instruksionet për shlyerjet neto që ekzekutohen në sistemin AIPS rrjedhin nga:
 - a) sistemet vartëse, të cilat gjenerojnë transaksione në formë neto;
 - b) klerimi i çeqeve.
2. Pozicionet shumëpalëshe neto shlyhen në llogaritë e shlyerjes së pjesëmarrësve në sistemin AIPS.
3. Shlyerja e instruksioneve neto realizohet vetëm në rast se të gjithë pjesëmarrësit me pozicione neto debitore, kanë fonde të mjaftueshme në llogaritë e tyre të shlyerjes.
4. Instruksionet neto të pagesave shlyhen në mënyrë të njëhershme, të vetme e të parevokueshme.

5. Pjesëmarrësit marrin masa për sigurimin e fondeve të mjaftueshme në llogaritë e tyre përkatëse të shlyerjes, për shlyerjen e menjëhershme të detyrimeve të tyre neto.

Neni 35

Transaksionet e regjistruara nga Banka e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë kryen në sistemin AIPS transaksionet e mëposhtme:

- a) pagesat e Bankës së Shqipërisë si pjesëmarrëse në sistemin AIPS, të cilat burojnë nga veprimtaria e saj operacionale;
- b) transaksionet e politikës monetare;
- c) pagesat për pjesëmarrësit e tërthortë për të cilët luan rolin e agjentit shlyerës;
- d) pagesat e interesave dhe të gjobave të aplikueshme sipas dispozitave nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë;
- e) pasqyrimin e rezultateve neto nga shlyerja e kartave si dhe ato të kleringut të çeqeve në Lek;
- f) pasqyrimin e tarifave të përdorimit të sistemeve apo shërbimeve të ofruara nga Banka e Shqipërisë;
- g) regjistrimin e instruksioneve të shlyerjes neto për pjesëmarrës operatorë, në raste të ngjarjeve të paparashikuara, në pamundësi të kryerjes së atyre veprimeve nga vetë pjesëmarrësi, me urdhër të pjesëmarrësit me shkresë zyrtare të nënshkruar nga nënshkrimet e autorizuara sipas rregullit dhe klasifikimit të njoftuara zyrtarisht nga pjesëmarrësi, në përputhje me këtë rregullore.
- h) Regjistrimin e transaksioneve ndërbankare të iniciuara prej pjesëmarrësit, në rast pamundësie komunikimi, teknike apo aksesit në sistem nga vetë pjesëmarrësi, ose të përfundimit të afateve kohore sipas orareve të operimit të sistemit AIPS në lidhje me procesimin e transaksioneve, por gjithmonë nëse nuk ka përfunduar afati i fundit i operimit në ditën e punës në sistemin AIPS nga Banka e Shqipërisë, dhe me urdhër të pjesëmarrësit në një nga format e mëposhtme:
 - i. shkresë zyrtare të nënshkruar nga nënshkrimet e autorizuara sipas rregullit dhe klasifikimit të njoftuara zyrtarisht nga pjesëmarrësi, në përputhje me këtë rregullore,
 - ii. urdhër të dërguar me mesazh SWIFT të autentikuar.

Neni 36

Kredia brenda ditës dhe kredia njëditore

1. Banka e Shqipërisë ofron kredi brenda ditës për pjesëmarrësit, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse në fuqi, me qëllim krijimin e mundësive për pjesëmarrësit për përmbushjen e detyrimit të tyre në mbajtjen e likuiditetit në sistemin AIPS.
2. Në rast të pamundësisë për shlyerje të kredisë brenda ditës, Banka e Shqipërisë ofron mundësinë për kredi njëditore për pjesëmarrësin, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse në fuqi.

Neni 37 Rezervat

1. Me qëllim garantimin e shlyerjes së pozicioneve debitore me rëndësi, Sistemi AIPS ofron mundësinë për të përcaktuar rezerva të veçanta për shlyerjen e sistemeve vartëse apo për qëllime të tjera të veçanta, të tilla si rezervë për tërheqjet në para fizike, rezervë për shlyerjen për sisteme me finalitet shlyerjeje etj.
2. Rezervat u mundësojnë pjesëmarrësve dhe/ose Bankës së Shqipërisë që të lëvizin fonde nga llogaria e shlyerjes së pjesëmarrësit në një nga llogaritë rezervë për një qëllim të caktuar.
3. Tipet e rezervave përcaktohen dhe krijohen në sistemin AIPS nga Banka e Shqipërisë. Parametrat e vendosura nga Banka e Shqipërisë për çdo rezervë, përcaktojnë mënyrën se si fondet mund të zhvendosen për/nga rezerva dhe se si ato përdoren nga vetë rezerva.
4. Lëvizjet e rezervave, varësisht nga konfigurimi i tyre, mund të realizohen nga vetë pjesëmarrësi dhe/ose nga Banka e Shqipërisë, në cilësinë e administratorit të sistemit, me kërkesë të specifikuar të pjesëmarrësit.

Neni 38 Rezerva e detyruar

1. Pjesëmarrësit e sistemit AIPS, të cilët janë subjekte që kanë detyrimin e mbajtjes së rezervës së detyruar, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore në fuqi, duhet të sigurojnë fonde të mjaftueshme në llogarinë e tyre të shlyerjes deri në mbyllje të ditës së punës përpara datës së regjistrimit të rezervës së detyruar, për të siguruar regjistrimin e rezervës së detyruar në datën e caktuar.
2. Transaksionet që reduktojnë fondet në llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësit nën minimumin e miratuar për rezervën e detyruar, sipas akteve nënligjore në fuqi, nuk ekzekutohen dhe mbahen në radhë nga sistemi për rikontroll të mëvonshëm, kundrejt krijimit të fondeve të mjaftueshme.
3. Banka e Shqipërisë, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, shlyen në sistemin AIPS pagesat që lidhen me:
 - a) interesat mbi rezervën e detyruar;
 - b) gjokat për mosplotësimin e nivelit të rezervës së detyruar.

KREU VI NGJARJET E PAPANASHIKUARA DHE PROCEDURAT E EMERGJENCËS

Neni 39 Ngjarjet e paparashikuara

Ngjarjet e paparashikuara klasifikohen si më poshtë:

- a) ngjarje të paparashikuara në infrastrukturën pranë pjesëmarrësit;

- b) ngjarje të paparashikuara në infrastrukturën pranë Bankës së Shqipërisë.

Neni 40

Ngjarje të paparashikuara në infrastrukturën pranë pjesëmarrësit

1. Nëse një pjesëmarrës ndeshet me vështirësi teknike/sigurie, të cilat pengojnë:
 - a) procesimin e urdhërpagesave në sistemin AIPS; dhe/ose
 - b) monitorimin e sistemit AIPS; dhe/ose
 - c) transferimin e instruksioneve për në sistemin AIPS;ai njofton Bankën e Shqipërisë brenda 30 minutave nga momenti i konstatimit të këtyre vështirësive.
2. Banka e Shqipërisë, me marrjen e njoftimit nga pjesëmarrësi, bashkëpunon me të për të identifikuar problemin dhe udhëzon atë për mundësi alternative.
3. Pjesëmarrësit njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim në rrethanat apo në kushtet e operimit.
4. Në rastin kur vështirësi teknike pranë pjesëmarrësit pengojnë regjistrimin e transaksioneve brenda orareve të përcaktuara në sistemin AIPS, pjesëmarrësi mund të kërkojë me shkresë zyrtare ose mesazh SWIFT të autentifikuar, regjistrimin nga Banka e Shqipërisë të transaksioneve ndërbankare, për llogari të tij.
5. Në rastin e pjesëmarrësve operatorë, kur vështirësi teknike pranë pjesëmarrësit pengojnë transmetimin e instruksioneve brenda orareve të përcaktuara në sistemin AIPS, pjesëmarrësi mund të kërkojë me shkresë zyrtare regjistrimin e instruksioneve të shlyerjes neto.
6. Kur vështirësitë teknike pranë pjesëmarrësit vazhdojnë për një kohë të gjatë, nëse gjykohet e nevojshme nga pjesëmarrësi, apo nga Banka e Shqipërisë, në varësi të situatës, nga pjesëmarrësi ose nga Banka e Shqipërisë, mund të kërkojë kufizimi i përkohshëm i atij pjesëmarrësi në sistemin AIPS.
7. Banka e Shqipërisë njofton pjesëmarrësit e tjerë, në rastet kur ajo gjykon se problemi i një pjesëmarrësi mund të shkaktojë shqetësime të tjera në funksionimin e përgjithshëm të sistemit AIPS.

Neni 41

Ngjarje të paparashikuara në infrastrukturën pranë Bankës së Shqipërisë

1. Në rast të një mosfunksionimi në infrastrukturën pranë Bankës së Shqipërisë, kjo e fundit njofton pjesëmarrësit me e-mail ose telefon, konsultohet me mbështetjen teknike në varësi të sistemit/eve të përfshira dhe problematikës së krijuar, si dhe mban kontakte të vazhdueshme me pjesëmarrësit, nëpërmjet personave të kontaktit.
2. Varësisht nga problematika dhe sistemi/et e përfshirë nga mosfunksionimi, në qoftë se është e nevojshme, Banka e Shqipërisë merr masa për zhvendosje në sistemin *backup*, si dhe njofton pjesëmarrësit për këtë.

3. Sistemet të cilët mund të përfshihen në procese zhvendosje në site *backup* mund të jenë:
 - a) AIPS;
 - b) SWIFT;
 - c) linjat në përdorim për VPN.
4. Banka e Shqipërisë mund të pezullojë pjesërisht ose tërësisht funksionimin e sistemit, në rrethanat kur vazhdimi i funksionimit të tij do të kishte ndikim negativ mbi stabilitetin e sistemit, duke njoftuar menjëherë për këtë pjesëmarrësit.
5. Në rastet kur e gjykon të nevojshme, Banka e Shqipërisë i dërgon kompanisë SWIFT një kërkesë emergjence, për të ndryshuar statusin e grupit të mbyllur (CUG) AIPS në "mbyllur". Pas aplikimit të këtij ndryshimi, sistemi SWIFT në Bankën e Shqipërisë refuzon çdo instruksion të ardhshëm pagese të pjesëmarrësve me një njoftim mosekzekutimi.

Pas ndryshimit të statusit të grupit të mbyllur (CUG) AIPS si më sipër, kur Banka e Shqipërisë e gjykon të arsyeshme, ajo i dërgon kompanisë SWIFT një kërkesë emergjence për të ndryshuar statusin e grupit të mbyllur (CUG) AIPS, në "hapur".
6. Në rast se është e pamundur që infrastruktura të vendoset në funksionim për operim në sistemin AIPS, atëherë Banka e Shqipërisë instrukturon pjesëmarrësit mbi mjetet/mënyrat alternative sipas mundësive për të kapërcyer vështirësinë e krijuar.
7. Në rast se gjykohet e arsyeshme nga Banka e Shqipërisë, kjo e fundit mund të udhëzojë pjesëmarrësit të dërgojnë me shkresë zyrtare pagesat e ditës së punës, në mënyrë që të regjistrohen manualisht në sistemin AIPS, nga Banka e Shqipërisë.
8. Rikthimi i normalitetit në funksionim në infrastrukturën pranë Bankës së Shqipërisë, gjithashtu iu njoftohet pjesëmarrësve në sistem, nëpërmjet personave të kontaktit.

Neni 42 **Regjistrimi i ngjarjeve të paparashikuara**

1. Çdo pjesëmarrës regjistron menjëherë të gjitha ngjarjet e paparashikuara dhe problemet e vërejtura në sistemin AIPS, si dhe çdo ngjarje në sistemet apo infrastrukturën e tij të brendshme informatike, të cilat ndikojnë në përdorimin e sistemit AIPS nga ana e pjesëmarrësit.
2. Ngjarjet e evidentuara sipas pikës 1 të këtij neni që kanë pasur një kohëzgjatje më të gjatë se 30 minuta, pjesëmarrësi i raporton, duke njoftuar me e-mail pranë Bankës së Shqipërisë, brenda ditës së punës.
3. Me rifillimin e aktivitetit të pjesëmarrësit në sistem dhe/ose normalizimin e situatës, ai duhet të raportojë pranë Bankës së Shqipërisë brenda 2 (dy) ditëve pune, sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën F bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Raportimi duhet të kryhet si në rastin e zgjidhjes së përkohshme të situatës/incidentit, ashtu edhe në vazhdimësi, deri në zgjidhjen përfundimtare.

Neni 43

Testimi i procedurave *Fallback Recovery* në sistemin AIPS

1. Banka e Shqipërisë kryen çdo 6 muaj testimin e procedurave të *Fallback Recovery* për ngjarjet e paparashikuara, në bashkëpunim dhe me pjesëmarrësit e tjerë të sistemit AIPS.
2. Banka e Shqipërisë njofton pjesëmarrësit për kalimin e operacioneve të sistemit AIPS primar në sistemin AIPS *backup*, për zhvillimin e testimit të procedurave të *Fallback Recovery*, si dhe për çdo veprim që ata duhet të ndërmarrin, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune përpara datës së testimit.
3. Gjatë testimit të procedurave *Fallback Recovery* nga Banka e Shqipërisë, pjesëmarrësit aksesojnë sistemin nëpërmjet adresës së sistemit AIPS *backup* në Bankën e Shqipërisë.
4. Pjesëmarrësit, kur është e nevojshme, kryejnë vetë testimin e procedurave të *Fallback Recovery* për mjediset e tyre. Pjesëmarrësi njofton Bankën e Shqipërisë për çdo testim dhe ndryshim infrastrukturor që mund të ndikojë në aftësinë e tij për të operuar në sistemin AIPS.
5. Nëse paraqitet nevoja që një pjesëmarrës të kalojë në mjedisin e tij *backup*, ai duhet ta bëjë këtë pa pasur ndikim tek pjesëmarrësit e tjerë apo tek Banka e Shqipërisë.
6. Në çdo rast, pjesëmarrësi njofton Bankën e Shqipërisë për qëllimin e tij për të kaluar në sistemin *backup* dhe më pas për kryerjen e suksesshme të kalimit.

KREU VII

ASPEKTE TEKNIKE TË ADMINISTRIMIT TË SISTEMIT AIPS

Neni 44

Administrimi i ndryshimeve në sistemin AIPS

1. Ndryshimet në sistemin AIPS janë si më poshtë:
 - a) ndryshime funksionale dhe teknike të sistemit AIPS;
 - b) ndryshime në shërbimet e SWIFT të lidhura me sistemin AIPS;
 - c) ndryshime në VPN.
2. Banka e Shqipërisë njofton dhe udhëzon pjesëmarrësit përpara zbatimit të ndryshimeve të planifikuara të sistemit AIPS, kur këto ndryshime ndikojnë tek pjesëmarrësi.
3. Ndryshimet apo korrigjimet e nevojshme në procedurat, si dhe në dokumentacionin plotësues të sistemit AIPS, në raste ndryshimi, u njoftohen pjesëmarrësve.
4. Çdo ndryshim testohet në sistemin test përpara se të implementohet në sistemin primar AIPS.
5. Në rast ndryshimesh në operimin e sistemit AIPS, lajmërohen paraprakisht të gjithë pjesëmarrësit, duke u dhënë kohën e nevojshme për t'u përgatitur, si dhe për krijimin e kushteve të nevojshme për testimin e lidhjes së sistemeve të tyre me sistemin AIPS.

6. Banka e Shqipërisë, me iniciativë të saj ose me kërkesë të argumentuar të pjesëmarrësit, mund të bëjë ndryshime në sistemin AIPS, me qëllim sigurimin e funksionimit normal, apo përmirësime të tij. Në rastet kur ndryshimet e propozuara kanë ndikime tek pjesëmarrësit e sistemit AIPS, Banka e Shqipërisë këshillohet paraprakisht me këta të fundit.
7. Banka e Shqipërisë, pas shqyrtimit të kërkesës së argumentuar të pjesëmarrësit, e njofton atë për pranimin ose refuzimin e saj, duke e shoqëruar këtë njoftim me argumentet përkatëse.
8. Në rast se ndryshimet e lartpërmendura iniciohen nga:
 - a) Banka e Shqipërisë, kostot e ndryshimeve mbulohen nga kjo e fundit;
 - b) një pjesëmarrës, atëherë kostot e ndryshimeve mbulohen nga të gjithë pjesëmarrësit e sistemit AIPS, të cilët përfitojnë nga zgjidhja e ofruar, në mënyrë të barabartë;
 - c) një pjesëmarrës dhe ndryshimi në fjalë sjell përfitim vetëm për atë pjesëmarrës, atëherë kostot e ndryshimeve mbulohen nga vetë ai.
9. Banka e Shqipërisë nuk është e detyruar të këshillohet me pjesëmarrësit në rastet kur nevoja për ndërhyrje në sistemin AIPS është urgjente dhe çdo vonesë mund të shkaktojë vështirësi për pjesëmarrësit e sistemit AIPS.

Neni 45 **Ndryshimet tek pjesëmarrësit**

1. Çdo ndryshim i propozuar nga një pjesëmarrës që lidhet me mjedisin operues të tij lidhur me AIPS, duhet fillimisht të testohet dhe më pas të zbatohet në mjedisin primar të pjesëmarrësit.
2. Në çdo rast ndryshimi adresash të rrjetit internet ose të përdoruesve VPN, pjesëmarrësit plotësojnë formularin sipas Shtojcës D bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 46 **Personat e kontaktit**

1. Çdo pjesëmarrës dorëzon informacionin mbi personat e kontaktit sipas Shtojcës C në Bankën e Shqipërisë, e cila mban dhe përditëson listën e të gjithë personave të kontaktit të pjesëmarrësve.
2. Çdo pjesëmarrës duhet të përcaktojë të paktën dy persona kontakti për pagesat dhe të paktën dy persona kontakti për IT.
3. Pjesëmarrësit në sistemin AIPS njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim në listën e personave të kontaktit.

Neni 47 **Asistenca për përdoruesit e sistemit AIPS**

1. Banka e Shqipërisë iu ofron pjesëmarrësve shërbimin e ndihmës përmes të cilit ata mund të kërkojnë asistencë mbi të gjitha aspektet

- dhe problematikat e lidhura me funksionimin e sistemit AIPS.
2. Për shërbimin e ndihmës, Banka e Shqipërisë vë në dispozicion të pjesëmarrësve një adresë e-mail ku ata duhet të adresojnë kërkesat e tyre për asistencë.
 3. Banka e Shqipërisë iu komunikon me e-mail pjesëmarrësve informacionin për personat e saj të kontaktit, si dhe adresën e-mail të shërbimit të ndihmës.
 4. Për çdo kërkesë për pajisje sigurie, pjesëmarrësi paraqet pranë Bankës së Shqipërisë, formularin në Shtojcën D bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
 5. Në rast pamundësie të krijimit/fshirjes/modifikimit të një përdoruesi, pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë paraqet formularin në Shtojcën D, pranë Bankës së Shqipërisë, e cila e krijon/fshin/modifikon këtë përdorues në sistem.
 6. Në rast fshirjeje të një përdoruesi, pjesëmarrësi duhet të sjellë certifikatën e tij të sigurisë për anulim pranë Bankës së Shqipërisë, shoqëruar me formularin në Shtojcën D.
 7. Banka e Shqipërisë, çdo vit, rinovon certifikatat dixhitale të përdoruesve të pjesëmarrësve në sistem. Këto certifikata duhet të paraqiten nga pjesëmarrësi në Bankën e Shqipërisë, në përfundim të afatit të skadencës, shoqëruar me formularin në Shtojcën D.
 8. Për çdo modifikim të pjesëmarrësit ose të kontakteve të tij për sistemin AIPS, pjesëmarrësi sjell pa vonesa pranë Bankës së Shqipërisë formularin e paraqitur në Shtojcën C bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 48 Ndryshime të rregullores

1. Banka e Shqipërisë informon pjesëmarrësit në sistem për çdo ndryshim të dispozitave të kësaj rregulloreje.
2. Pjesëmarrësit mund të paraqesin drejtpërdrejt pranë Bankës së Shqipërisë, propozime për ndryshime të dispozitave të rregullores apo të vetë sistemit AIPS.
3. Propozimet sipas pikës 2 të këtij neni, paraqiten me shkrim dhe përmbajnë një përshkrim të plotë të qëllimit dhe të përfitimeve të mundshme të ndryshimit që propozohet.
4. Banka e Shqipërisë shqyrton këto propozime, duke ruajtur të drejtën e vendimit përfundimtar lidhur me miratimin/zbatimin ose jo të ndonjë ndryshimi të propozuar në dispozitat e rregullores apo të vetë sistemit AIPS.
5. Banka e Shqipërisë njofton me shkrim propozuesin, në rast se propozimet e tij për ndryshime refuzohen, duke paraqitur edhe arsyet e refuzimit.

Neni 49 Bëgatimi pa shkak

1. Një pjesëmarrës përfitues është subjekt i një pretendimi për bëgatim pa shkak nga një pjesëmarrës urdhërues:
 - a) nëse përfituesi nuk krediton llogarinë e klientit dhe të bëjë të disponueshme fondet brenda së njëjtës datëvalute, kur instruksionet e urdhërpagesës janë të sakta;
 - b) nëse përfituesi nuk kthen/kompenson brenda afateve të përcaktuara më poshtë fondet të cilat nuk është në gjendje t'i transferojë në llogarinë e klientit të tij për shkak të:
 - i. instruksioneve të pasakta ose kontradiktore të llogarisë, dhe/ose
 - ii. mbylljes së llogarisë për të cilën janë destinuar këto fonde.
2. Përfituesi kryen kompensimin e urdhërpagesës së parashikuar në pikën 1/b) të këtij neni tek urdhëruesi, brenda ditës pasardhëse të punës së datëvalutës së përcaktuar në instruksionin e pagesës.
3. Kompensimi i urdhërpagesës bëhet nëpërmjet inicimit të një urdhërpagese nga përfituesi subjekt i pretendimit për bëgatim pa shkak, e cila ka kah të kundërt me urdhërpagesën fillestare, minus komisionin e pjesëmarrësit të bëgatuar pa shkak dhe tarifën e përcaktuar për përdorimin e sistemit, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.
4. Për çdo ditë vonesë në kthimin e fondeve sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, përfituesi sanksionohet nga urdhëruesi, i cili pretendon bëgatim pa shkak të përfituesit me normën repo 1-javore + 2 pikë përqindje.
5. Mosshyerja e detyrimeve nga përfituesi subjekt i pretendimit për bëgatim pa shkak, në shumën dhe afatet e përcaktuara në këtë nen, përbën shkelje të kësaj rregulloreje.

Neni 50 Përgjegjësia në rastin e forcave madhore

1. Banka e Shqipërisë, në cilësinë e operatorit të sistemit AIPS, si dhe pjesëmarrësit në sistem, nuk mbajnë përgjegjësi për dëmet që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore, që vijnë si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme, luftërave, turbullirave të tjera civile, fatkeqësive natyrore dhe për çdo rrethanë tjetër jashtë kontrollit të tyre, si dhe si pasojë e çdo force tjetër madhore.
2. Pjesëmarrësi që nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e veta për shkaqet e përcaktuara në pikën 1, duhet:
 - a) të njoftojë operatorin e sistemit me shkrim mbi shkakun dhe shkallën që ka penguar atë në përmbushjen e detyrimeve;
 - b) të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të rifilluar përmbushjen e detyrimeve sa më shpejt që të jetë e mundur dhe njëkohësisht, të përpiqet të minimizojë efektet negative të shkaqeve të përcaktuara në pikën 1.

Neni 51 **Mbrojtja e Sistemit AIPS**

1. Një instruksion pagese konsiderohet që ka hyrë në Sistemin AIPS kur të ketë marrë statusin "Received" prej tij dhe nga ky moment konsiderohet i përvokueshëm.
2. Në rastet e procedurave për paafësi paguese të pjesëmarrësve, çështjet që lidhen me finalitetin e shlyerjes dhe realizimin e kolateralit financiar rregullohen nga dispozitat e ligjit për sistemin e pagesave.

Neni 52 **Konfidencialiteti**

1. Pjesëmarrësit zbatojnë rregullat dhe normat e konfidencialitetit të informacionit mbi të gjitha instruksionet e pagesave të hyra në sistemin AIPS.
2. Pjesëmarrësit e sistemit AIPS mund të shkëmbejnë informacione me çdo pjesëmarrës tjetër, në lidhje me çdo aspekt të funksionimit apo administrimit të këtij sistemi.
3. Secili nga pjesëmarrësit instrukton personelin përkatës, i cili ka të drejta për përdorimin e informacionit mbi instruksionet e pagesave të hyra në sistemin AIPS, për ruajtjen e konfidencialitetit mbi këtë informacion, në përputhje me rregullat dhe normat e konfidencialitetit dhe me dispozitat e kësaj rregulloreje.
4. Pjesëmarrësit dhe Banka e Shqipërisë ushtrojnë të njëjtin nivel përkujdesjeje për mbrojtjen e konfidencialitetit të informacionit të klasifikuar si konfidencial nga një palë tjetër, si ai që ushtrohet për mbrojtjen e informacionit të vet, të klasifikuar konfidencial.
5. Dispozitat e këtij neni zbatohen nga pjesëmarrësit dhe Banka e Shqipërisë, edhe pas mbylljes së llogarisë së shlyerjes së pjesëmarrësit ose përjashtimit nga pjesëmarrja në sistem.

Neni 53 **Organizimi i brendshëm**

Organizimi i brendshëm i punës brenda njësive të Bankës së Shqipërisë për realizimin e detyrave të mësipërme, përcaktohet me rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Neni 54 **Hyrja në fuqi**

Rregullorja hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

GENT SEJKO

SHTOJCA A. ORARET OPERUESE TË SISTEMIT AIPS

Ora	Ngjarja	Operacionet
08:15 – 8:30	Fillimi i procedurave të hapjes së ditës	Intervali gjatë të cilit kryhet hapja e ditës (<i>Start Of Day</i>) në sistemin AIPS. <i>Start of day</i> duhet të jetë kryer brenda orës 8:30.
08:15 – 08:35	Fillimi i operimit	Intervali gjatë të cilit kryhet hapja e ditës së punës (<i>Open For Business</i>) në sistemin AIPS. <i>Open For Business</i> kryhet pasi të jetë kryer <i>Start Of Day</i> . Pjesëmarrësit mund të dërgojnë dhe të marrin pagesa.
15:30	<i>Cut-off</i> paraprak	Sistemi AIPS nuk pranon më pagesa për klientët. Sistemi AIPS pranon vetëm pagesa ndërbankare. Sistemi AIPS lejon regjistrimin e transaksioneve manualisht nga Banka e Shqipërisë.
16:00	<i>Cut-off</i> përfundimtar Fund i operimit në sistem	Sistemi AIPS nuk pranon transaksionet e ardhura me mesazhe pagese ndërbankare. Sistemi AIPS lejon regjistrimin e transaksioneve manualisht nga Banka e Shqipërisë.
16:30 – 16:45	Mbyllja e ditës së punës	Kryhen procedurat e mbylljes së sistemit, gjenerohen raportet e fundit të ditës, dërgohen gjendjet e llogarive me mesazhe konfirmimi SWIFT.

SHTOJCA B. MARRËVESHJA TIP

MARRËVESHJE NDËRMJET BANKËS SË SHQIPËRISË DHE PËR PJESËMARRJE NË SISTEMIN E PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE AIPS

E lidhur më datë: __/__/____

Palët:

Banka e Shqipërisë (si më poshtë "Banka"), me adresë: _____,
Tiranë, përfaqësuar ligjërisht në këtë marrëveshje nga Drejtori në Bankën
e Shqipërisë që mbulon fushën e sistemeve të pagesave,

dhe

_____ (si më poshtë "Pjesëmarrësi"), me adresë:
_____ Tiranë, përfaqësuar ligjërisht në këtë marrëveshje
nga Drejtori z./zj. _____,
bien dakord të lidhin këtë marrëveshje sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i marrëveshjes është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve, të cilat lindin në kuadër të ofrimit nga ana e Bankës të shërbimeve të shlyerjes së pagesave ndërbankare me vlerë të madhe në Sistemin AIPS, i cili operohet dhe administrohet nga kjo e fundit.

Neni 2 Baza ligjore

Marrëveshja hartohet në bazë të:

- a) Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
- b) ligjit "Për Bankën e Shqipërisë";
- c) ligjit "Për sistemin e pagesave";
- d) ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";
- e) ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë";
- f) rregulloreve të Bankës për sistemet AIPS dhe AECH;
- g) akteve të tjera nënligjore të Bankës.

Neni 3 Zbatimi

1. Për zbatimin e marrëveshjes, palët bazohen kryesisht në rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për funksionimin e sistemit të pagesave

- ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS" dhe çdo ndryshim të saj (rregullorja për sistemin AIPS).
2. Të drejtat dhe detyrimet e palëve janë ato të përcaktuara në rregulloren për sistemin AIPS, si dhe në çdo ndryshim të mëvonshëm të saj.
 3. Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë rregullore, zbatohen dispozitat ligjore dhe nënligjore të cituara në bazën ligjore të marrëveshjes.
 4. Çdo kusht ose formulim i marrëveshjes apo rregullores së sistemit AIPS që mund të sjellë paqartësi, interpretohet në kontekstin e tërësisë së rregullave të sistemit AIPS dhe në këndvështrimin e qëllimit për të cilin lidhet marrëveshja.

Neni 4 Njoftimet

1. Çdo njoftim, kërkesë ose çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve, bëhet me postë zyrtare të regjistruar, faks, e-mail, mesazh SWIFT - dhe në rastet kur komunikimi me mjetet e cituara është i pamundur, me telefon - në adresat, numrat telefonikë dhe personat e kontaktit përkatës të palëve.
2. Secila palë është e detyruar të njoftojë palën tjetër për ndryshimet e mundshme të adresave, numrave telefonikë dhe të personave të kontaktit, brenda 5 (pesë) ditësh pune nga ndryshimi i tyre.
3. Në rast se njoftimi ose kërkesa mbërrin tek i adresuari pas orës 16:30 të ditës së punës, ai konsiderohet i marrë në orën 08:30 të ditës pasardhëse të punës.

Neni 5 Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga ana e palëve dhe i shtrin efektet për një kohë të papërcaktuar.

Neni 6 Ndryshimi i marrëveshjes

Marrëveshja mund të ndryshohet nga palët vetëm me shkrim.

Neni 7 Zgjidhja e marrëveshjes

1. Palët mund të zgjidhin Marrëveshjen në mënyrë të njëanshme, duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune përpara datës që ata dëshirojnë ta zgjidhin, duke kërkuar plotësimin e detyrimeve financiare.
2. Në rast se kërkesa (njoftimi) bëhet nga Pjesëmarrësi, Banka, brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga marrja e kërkesës, i dërgon pjesëmarrësit përgjigje, duke përcaktuar hapat që duhet të ndiqen deri në përfundimin e pjesëmarrjes së tij në sistemin AIPS.

3. Në rast se kërkesa e Pjesëmarrësit miratohet:
 - a) Banka informon të gjithë pjesëmarrësit e sistemit AIPS mbi datën e përjashtimit të pjesëmarrësit nga sistemi AIPS;
 - b) pjesëmarrësi nuk lejohet të iniciojë instruksione të reja pagese me datëvalutë pas datës së përcaktuar në vendimin për miratimin e përjashtimit të tij nga sistemi AIPS.
4. Gjendja debitore e llogarisë së shlyerjes në momentin e mbylljes së saj është detyrim i pagueshëm ndaj pjesëmarrësve në sistemin AIPS dhe/ose ndaj Bankës.

Neni 8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve nga zbatimi i Marrëveshjes, dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, zgjidhen në gjykatën kompetente.

Marrëveshja, pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur në 4 (katër) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, dhe secila nga palët mban 2 (dy) kopje.

Për Bankën e Shqipërisë

Drejtor i Departamentit _____


Për _____

Drejtor

SHTOJCA C. FORMULAR PËR PJESËMARRJE NË AIPS

Pjesëmarrësi	
Kodi BIC	
Adresa	
KËRKESA PËR SISTEMIN	
Konfirmim gjendjeje:	<input type="checkbox"/>
Konfirmim debitimi:	<input type="checkbox"/>
Shuma minimale për dërgimin e konfirmimit të debitimit	<input type="checkbox"/>
Konfirmim kreditimi:	<input type="checkbox"/>
Shuma minimale për dërgimin e konfirmimit të kreditimit	<input type="checkbox"/>
Njoftim për dërguesin:	<input type="checkbox"/>
KONTAKTET PËR ÇËSHTJE/PROBLEME TË OPERIMIT TË SISTEMIT	
<i>Persona kontakti për pagesat</i>	
Emër, Mbiemër	
Detyra që mbulon	
Telefon	
Celular	
e-mail	
<i>Persona kontakti për IT</i>	
Emër, Mbiemër	
Detyra që mbulon	
Telefon	
Celular	
e-mail	
Data _/_/___	Personi i autorizuar për pjesëmarrësin Emri Mbiemri / Nënshkrimi / Vula _____

SHTOJCA D. FORMULAR PËR AKSESIN NË SISTEM

KONFIDENCIAL			
			
BANKA E SHQIPËRISË SISTEMI AIPS			
FORMULARI I KËRKESËS PËR PËRDORUES NË VPN, PAJISJE SIGURIE, CERTIFIKATË DIXHITALE DHE PËRDORUES TË LIDHUR ME SISTEMIN AIPS			
Të plotësohet ky formular për të administruar kredencialet e një përdoruesi në rrjetin VPN, në pajisjen e sigurisë dhe certifikatën dixhitale, në FTP, si dhe në sistemin AIPS			
Për:	Banka e Shqipërisë Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës		
Nga Pjesëmarrësi:	Data e kërkesës: <u> </u> / <u> </u> / <u> </u> (dd/mm/vvvv)		
1- KËRKESË PËR NDRYSHIM NË VPN			
Nr.	Emri/Mbiemri i përdoruesit	Veprimi	
1		<input type="checkbox"/> Krijim përdoruesi të ri <input type="checkbox"/> Rivendosje fjalëkalimi të përdoruesit <input type="checkbox"/> Fshirje përdoruesi ekzistues	
2- KËRKESË PËR PAJISJE SIGURIE			
Nr.	Emri/Mbiemri i përdoruesit	Lloji i pajisjes	Copë
1			
2			
3			
3- KËRKESË PËR CERTIFIKATA DIXHITALE			
Nr.	Emri/Mbiemri i përdoruesit	Veprimi	
1		<input type="checkbox"/> Gjenerim certifikatë e re <input type="checkbox"/> Rigjenerim certifikate <input type="checkbox"/> Zhblokim pajisje sigurie <input type="checkbox"/> Rivendosje fjalëkalimi i pajisjes së sigurisë <input type="checkbox"/> Revokim certifikate	

4- VEPRIME NË LLOGARINË E PËRDORUESIT NË AIPS			
Nr.	Emri/Mbiemri i përdoruesit	Veprimi	Profili i përdoruesit
1		<input type="checkbox"/> Krijim përdoruesi	
		<input type="checkbox"/> Aprovim përdoruesi	
		<input type="checkbox"/> Rivendosje fjalëkalimi	
		<input type="checkbox"/> Aprovim rivendosje fjalëkalimi	
		<input type="checkbox"/> Aktivizim llogarie	
		<input type="checkbox"/> Aprovim aktivizim llogarie	
		<input type="checkbox"/> çaktivizim llogarie	
		<input type="checkbox"/> Aprovim çaktivizim llogarie	
		<input type="checkbox"/> Modifikim profil përdoruesi	
		<input type="checkbox"/> Aprovim profil përdoruesi	
		<input type="checkbox"/> Mbyllje llogarie	
		<input type="checkbox"/> Aprovim mbyllje llogarie	
		Arsyeja (e detyrueshme për t'u plotësuar):	
Shënim:			
Për Pjesëmarrësin Autorizuesi (Emri Mbiemri / Nënshkrimi / Vula)			Për Bankën e Shqipërisë Autorizuesi (Emri Mbiemri / Nënshkrimi)


SHTOJCA E. VETËVLERËSIM I OPERIMIT NË AIPS

Emri i Pjesëmarrësit	Personi i autorizuar për lëshimin e raportit	Nënshkrimi	Vula		
Viti					
A	Veprimtaria kriminale lidhur me sistemin AIPS		PO	JO	N/A
1	A keni hasur ndonjë veprimtari kriminale apo përpjekje për veprimtari të tillë në kuadrin e sistemit AIPS, gjatë vitit?		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2	Nëse po, a është kryer raportimi pranë Bankës së Shqipërisë, në përputhje me rregullat dhe procedurat e sistemit AIPS?		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3	A u identifikua metoda e përdorur dhe a u krye korrigjimi i duhur?		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4	A rezultoi kjo veprimtari në humbje financiare për institucionin apo për klientët tuaj?		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5	Nëse po, a po punohet ende për kompensimin e këtyre humbjeve?		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
B	Planifikimi i ngjarjeve të paparashikuara dhe i lehtësive përkatëse		PO	JO	N/A
1	A ka institucioni juaj një plan të dokumentuar për ngjarjet e paparashikuara lidhur me operacionet në sistemin AIPS?		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2	A mbulon plani mjaftueshëm skenarë të mundshëm të ngjarjeve të paparashikuara?		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3	A mban institucioni juaj mjete <i>backup</i> kompjuterike dhe/apo për ndërfaqen SWIFT që shfrytëzohet për ndërlidhjen me sistemin AIPS?		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4	Nëse po, a janë këto lehtësi fizikisht të ndara nga vendndodhja kryesore e stacionit SWIFT?		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5	A ka testuar institucioni juaj plane për ngjarje të paparashikuara për komunikime mbështetëse në rast të humbjes së lidhjeve të VNP?		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6	A mendoni se rreziqet e mundshme për operimin në sistemin AIPS janë adresuar dhe janë analizuar në mënyrë të kënaqshme?		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
C	Periudha e ndërprerjes së operimit dhe qëndrueshmëria e sistemit		PO	JO	N/A
1	A kanë qenë operacionet tuaja në sistemin AIPS subjekt i ndërprerjeve të rëndësishme të funksionimit?		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2	Nëse po, a janë raportuar tek Banka e Shqipërisë dhe a janë regjistruar në regjistrin e ngjarjeve të paparashikuara, në përputhje me procedurat e sistemit AIPS?		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3	A mendoni se sistemet tuaja të lidhura me sistemin AIPS kanë kapacitet dhe qëndrueshmëri të mjaftueshme për të mbuluar trafikun tuaj të pagesave në sistemin AIPS, në kohë dhe në mënyrë të sigurt?		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shënime					


SHTOJCA F. RAPORT INCIDENTI

Emri i Bankës	Personi i autorizuar për lëshimin e raportit	Nënshkrimi	Vula
Tipi i raportit:	Data e raportit (dd/mm/yyyy)	Numër (yyyymmdd-nr)	Sistemet e përfshira/ndikuara
	__/__/__	_____:	
Personat e kontaktit:			
I lidhur me incident/e të tjerë: (lista e numrave të incidenteve):			
PËRSHKRIMI I INCIDENTIT DHE EFEKTET			
Fillimi i incidentit (dd/mm/yyyy hh:mm)	Fundi i incidentit (dd/mm/yyyy hh:mm)	Koha e evidentimit (dd/mm/yyyy hh:mm)	Koha e raportimit / njoftimit pranë BSH (dd/mm/yyyy hh:mm)
__/__/__ :__	__/__/__ :__	__/__/__ :__	__/__/__ :__
Përshkrimi i incidentit:			
PASOJAT E INCIDENTIT			
<input type="checkbox"/> Ndërprerje e rrjetit SWIFT	<input type="checkbox"/> Vonesa	<input type="checkbox"/> Mbyllje e vonuar	
<input type="checkbox"/> Sistemi nuk përgjigjet	<input type="checkbox"/> Vonesë në procesimin e pagesave	<input type="checkbox"/> Hapje e vonuar	
<input type="checkbox"/> "Site Recovery"	<input type="checkbox"/> Pagesa të paprocesuara	<input type="checkbox"/> Të tjera	
<input type="checkbox"/> Shpallje emergjence	<input type="checkbox"/> Cënim i integritetit të të dhënave		
Masa të marra dhe ndryshime të kryera për zgjidhjen e incidentit:			
Data e implementimit të masave/ndryshimeve (dd/mm/yyyy)	__/__/__		
PLANI I MASAVE PËR ZGJIDHJEN PËRFUNDIMTARE TË INCIDENTIT			
Masa të marra dhe ndryshime të kryera ose të planifikuara për realizim për zgjidhjen e incidentit			
Data e planifikuar (dd/mm/yyyy)	Data e implementimit (dd/mm/yyyy)	<input checked="" type="radio"/> Zgjidhur me sukses <input type="radio"/> Pa zgjidhur	
__/__/__	__/__/__		


SHTOJCA G. FORMULAR PËR SISTEMET VARTËSE

 BANKA E SHQIPËRISË SISTEMI AIPS FORMULAR PËR SISTEMET VARTËSE			
Sistemi vartës			
Adresa:			
BIC (live)		BIC (test)	
<input checked="" type="radio"/> I ri <input type="radio"/> Modifikim <input type="radio"/> Fshirje			
Qëllimi i aplikimit		<input type="checkbox"/> Operim live <input type="checkbox"/> Test dhe trajnim <input type="checkbox"/> Ndryshim në listën e bankave shlyerëse	
Data e aplikimit		__/__/__	
Data e aktivizimit		__/__/__	
Tipi i sistemit vartës		<input type="checkbox"/> Sistem pagesash me vlerë të vogël <input type="checkbox"/> Shtëpi klerimi <input type="checkbox"/> Sistem i shlyerjes së titujve <input type="checkbox"/> Tjetër _____	
Lista e bankave shlyerëse			
BIC i bankës shlyerëse		Referenca e marrëveshjes së lidhur me sistemin vartës	
Për sistemin vartës Autorizuesi (Emri Mbiemri / Nënshkrimi / Vula)			

SHTOJCA H. MANDAT DEBITIMI PËR SHLYERJEN PËR SISTEMET VARTËSE

 <p>BANKA E SHQIPËRISË SISTEMI AIPS MANDAT DEBITIMI PËR SHLYERJEN PËR SISTEMET VARTËSE</p>		
<input checked="" type="radio"/> I ri	<input type="radio"/> Modifikim	<input type="radio"/> Fshirje
Qëllimi i aplikimit	<input type="checkbox"/> Operim live	<input type="checkbox"/> Test dhe trajnim
Data e aplikimit	_/_/___	
Data e aktivizimit	_/_/___	
(1) Pjesëmarrësi shlyerës		
BIC i pjesëmarrësit		
Emri i pjesëmarrësit		
(2) Sistemi vartës		
BIC i Sistemit vartës		
Emri i Sistemit vartës		
<p>Palët konfirmojnë se bien dakord në caktimin e pjesëmarrësit (1) si pjesëmarrës shlyerës për sistemin vartës (2) për shlyerjen e instruksioneve të dërguara nga sistemi vartës, nëpërmjet ndërfaqes me sistemin AIPS.</p>		
Për pjesëmarrësin shlyerës Autorizuesi (Emri Mbiemri / Nënshkrimi / Vula) _____		Për sistemin vartës Autorizuesi (Emri Mbiemri / Nënshkrimi / Vula) _____

SHTOJCA I. MANDAT PËR PAGESËN E DETYRIMEVE PËR SISTEMET VARTËSE

		
BANKA E SHQIPËRISË SISTEMI AIPS MANDAT PËR PAGESËN E DETYRIMEVE PËR SISTEMET VARTËSE		
<input checked="" type="radio"/> I ri <input type="radio"/> Modifikim <input type="radio"/> Fshirje		
Data e aplikimit	_/_/___	
Data e aktivizimit	_/_/___	
<i>(1) Sistemi vartës që faturohet</i>		
BIC i Sistemit vartës		
Emri i Sistemit vartës		
<i>(2) Pjesëmarrësi llogaria e të cilit debitohet</i>		
BIC i pjesëmarrësit		
Emri i pjesëmarrësit		
<p>Palët konfirmojnë se shumat e faturuara ndaj sistemit vartës (1) për përdorimin e shërbimeve të sistemit AIPS, do të debitohen nga llogaria e pjesëmarrësit të shënuar në fushën (2).</p>		
<i>Për pjesëmarrësin llogaria e të cilit debitohet</i> Autorizuesi <i>(Emri Mbiemri / Nënshkrimi / Vula)</i> _____		<i>Për sistemin vartës që faturohet</i> Autorizuesi <i>(Emri Mbiemri / Nënshkrimi / Vula)</i> _____

SHTOJCA J. TARIFAT E PËRDORIMIT TË SISTEMIT AIPS

Komponenti	Përshkrim	Tarifa në Lek
Tarifë për mirëmbajtje vjetore të sistemit	E pagueshme në fillim të çdo viti. Për pjesëmarrësit e rinj, aplikohet mbi periudhën e mbetur.	250,000
Tarife për transaksion	E pagueshme çdo fund muaji	
	Autorizim pagese	150
	NSI të operatorëve Për çdo debitim/kreditim pjesëmarrësi shlyerës brenda NSI.	150
	Konfirmim debitimi/kreditimi	70
	Transaksionet e pjesëmarrësve të dërguara në Bankën e Shqipërisë me shkresë zyrtare.	1,000
Shërbime të tjera	E pagueshme pas çdo shërbimi	
	Kufizimi i përkohshëm i pjesëmarrësit	50,000
	Dorëzim pajisje sigurie	me koston e blerjes për njësi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 37, datë 3.6.2020

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË
FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË
VOGËL – AECH”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 4, shkronja “dh”, si dhe neneve 14, 21, dhe 43, shkronja “f” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 13 të ligjit nr. 133/2013 “Për sistemin e pagesave”; nenit 129, pika 6, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për organizimin e brendshëm të funksionimit të sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me zbatimin e këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 56, datë 26.9.2007, “Për miratimin e rregullores “Mbi rregullat e brendshëm të funksionimit të sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH”.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

RREGULLORE
“PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT
TË KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL - AECH”

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave të brendshme për administrimin, operimin dhe organizimin e sistemit AECH nga Banka e Shqipërisë.
2. Subjekte të kësaj rregulloreje janë njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë të përcaktuara në të.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të:

- a) ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”;
- b) ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;
- c) ligjit “Për sistemin e pagesave”;
- d) rregullores “Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)”;
- e) akteve të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë që lidhen, por nuk kufizohen me: funksionimin e sistemeve të pagesave, minimumin e rezervës së detyruar, instrumentet e pagesave elektronike, kredinë brenda ditës për bankat, kredinë njëditore për bankat, sigurinë e informacionit, administrimin e rrezikut operacional etj.

Neni 3
Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të rregullores, termat e përkufizuar në rregulloren “Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH” kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore.
2. Përveç sa parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të rregullores, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) DM – është Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë;
 - b) DSPKF – është Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës në Bankën e Shqipërisë, i cili, në cilësinë e Përgjegjës të sistemit, përcakton kriteret për trajtimin, administrimin dhe aksesimin e sistemit, si dhe pranon dhe miraton ndryshimet apo përmirësimet e mundshme në lidhje me sistemin;

- c) DTI – është Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në Bankën e Shqipërisë, i cili, në cilësinë e Kujdestarit të sistemit, kujdeset për sistemin, duke e administruar teknikisht atë dhe infrastrukturën mbështetëse të tij, si dhe duke zbatuar dhe mbrojtur rregullat e përcaktuara nga përgjegjësi i sistemit;
- d) Ministria – është ministria përgjegjëse për financat;
- e) Rregullorja për sistemin AECH – është rregullorja e Bankës së Shqipërisë “Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël - AECH” dhe çdo ndryshim i saj.

KREU II

FUNKSIONET E DEPARTAMENTEVE NË SISTEMIN AECH

Neni 4

Funksionet e DSPKF-së

DSPKF-ja ushtron funksionet e mëposhtme në sistemin AECH:

1. është përgjegjës i sistemit AECH;
2. administron nga ana operacionale sistemin AECH;
3. zbaton politikën e sigurisë në sistemin AECH në cilësinë e përgjegjësit të sistemit;
4. faturon detyrimet e pjesëmarrësve për shërbimet e sistemit AECH dhe ndjek shlyerjen e tyre në sistemin AIPS; dërgon zyrtarisht faturat pranë pjesëmarrësve të sistemit AECH;
5. kryen procedurat për kufizimin e përkohshëm dhe/ose përjashtimin e pjesëmarrësit në sistemin AECH, si dhe njofton për këtë pjesëmarrësit e sistemit;
6. përfaqëson Bankën e Shqipërisë si pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë në sistemin AECH, duke pasqyruar, procesuar dhe monitoruar transaksionet e regjistruara për qëllime të aktivitetit të saj;
7. me kërkesë zyrtare të pjesëmarrësit të nënshkruar nga nënshkrimet e autorizuara sipas rregullit dhe klasifikimit, të njoftuara zyrtarisht nga pjesëmarrësi, ose mesazh SWIFT të autentifikuar, në raste të lidhura me mosfunksionime në infrastrukturën pranë pjesëmarrësit, kryen aprovimin e instruksioneve të pagesave të pjesëmarrësit në sistemin AECH;
8. përgatit dhe publikon statistika mbi veprimtarinë në sistemin AECH;
9. bashkëpunon me departamentet e tjerë në lidhje me zbatimin e rregulloreve të sistemit AECH;
10. mban dhe përditëson listën e personave të kontaktit të çdo pjesëmarrësi për sistemin AECH, si dhe njofton pjesëmarrësit për listën e përditësuar të personave të kontaktit të Bankës së Shqipërisë për sistemin AECH;
11. mban dhe përditëson listën e nënshkrimeve të autorizuara (të shoqëruar me kategoritë dhe limitet përkatëse) të pjesëmarrësve, të cilat përdoren për sistemin AECH;
12. për çdo shkresë zyrtare, formular apo raport që adresohet në Bankën e Shqipërisë në lidhje me sistemin AECH, kryen verifikimin

- e firmave të autorizuar, aty ku është e aplikueshme, përpara se të kryhen veprime të mëtejshme nga njësitë e tjera apo vetë DSPKF-ja. Pas verifikimit me sukses të firmave të autorizuar, përcjell shkresën e mbërritur me korrespondencë zyrtare për në njësinë përgjegjëse të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e veprimeve të mëtejshme;
13. i dërgon shkresë zyrtare pjesëmarrësit, për çdo rast shkeljeje të detyrimeve të pjesëmarrësit në sistemin AECH;
 14. informon dhe bashkëpunon me DM-në për raste kur pjesëmarrësit në sistemin AECH paraqesin problematika në sistemin e pagesave me ndikim në sistemin bankar apo financiar në tërësi;
 15. raporton pranë njësisë përgjegjëse për administrimin e rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë, mbi ngjarjet e rrezikut operacional të lidhura me sistemin AECH në këndvështrimin operacional.

Neni 5 Funksionet e DTI-së

DTI-ja ushtron funksionet e mëposhtme në sistemin AECH:

1. është kujdestar i sistemit AECH;
2. administron dhe mirëmban teknikisht sistemin AECH dhe infrastrukturën mbështetëse të tij, përfshirë shërbimet përkatëse të SWIFT në funksion të sistemit AECH;
3. zbaton politikën e sigurisë në sistemin AECH, në cilësinë e kujdestarit të sistemit, dhe ndërton mekanizma të sigurt për:
 - i. mbrojtjen e aksesit ndaj tij,
 - ii. autentifikimin e dërguesit të instruksionit të pagesës,
 - iii. mbrojtjen e besueshmërisë dhe të konfidencialitetit të informacionit të marrë dhe të ruajtur nga sistemi AECH;
4. shqyrton kërkesat nga përdoruesit për zhvillime të reja në sistemin AECH dhe, pas vlerësimit të mundësive të realizimit, ndërmerr hapat e nevojshëm sipas rastit në bashkëpunim me DSPKF-në, për implementimin e tyre në sistem;
5. ndërton mekanizma për evidentimin e incidenteve dhe problemeve lidhur me funksionimin e sistemit AECH dhe infrastrukturës që e mbështet;
6. mban regjistrin e anomalive/problematikave të identifikuar ose të sinjalizuara në lidhje me sistemin AECH, si dhe merr masa për zgjidhjen e tyre. Në rast se zgjidhja e anomalisë është jashtë mundësive teknike dhe kompetencave të DTI-së, atëherë ajo njofton kompaninë kontraktore që ka ofruar sistemin AECH dhe shërbimin e mirëmbajtjes së tij, për të asistuar në zgjidhjen e saj;
7. zbaton në sistem procedurat për vendosjen e versioneve të reja, si dhe kryen përditësimet, në përpunime me instruksionet e dhëna nga kompania kontraktore që ka ofruar sistemin AECH;
8. administron teknikisht përdoruesit dhe të drejtat në sistem;
9. administron formularët/kërkesat për përdorues në VPN, pajisje sigurie, certifikata dixhitale dhe përdorues të lidhur me sistemin AECH, të paraqitura nga DSPKF-ja si përgjegjës i sistemit;

10. harton dhe zbaton procedurat e *Fallback-Recovery* dhe *Backup-Restore* në funksion të vazhdimësisë së veprimtarisë, i teston periodikisht ato, si dhe informon DSPKF-në mbi rezultatet;
11. shqyrton njoftimin e pjesëmarrësit për raste kur ai pjesëmarrës raporton për teste ose ndryshime infrastrukturore, të cilat mund të ndikojnë aftësinë e tij për të operuar në sistemin AECH dhe e udhëzon atë sipas rastit;
12. informon DSPKF-në për çdo rast të evidentuar shkeljeje detyrimesh teknike të pjesëmarrësve në sistemin AECH, me qëllim që DSPKF-ja të vijojë me njoftimin e DM-së, sipas akteve nënligjore në fuqi;
13. raporton pranë njësisë përgjegjëse për administrimin e rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë, mbi ngjarjet e rrezikut operacional të lidhura me sistemin AECH në këndvështrimin teknik.

Neni 6

Funksione të përbashkëta mes DSPKF-së dhe DTI-së

DSPKF-ja dhe DTI-ja, në sistemin AECH, ushtrojnë funksione të përbashkëta si më poshtë:

1. zbatojnë rregullat për sigurinë e informacionit, në funksion të garantimit të parimeve të sigurisë: disponueshmërisë, konfidencialitetit, integritetit, aksesit të kontrolluar në sistem;
2. ndjekin procedurat për anëtarësimin e pjesëmarrësve të rinj në sistemin AECH;
3. ndjekin procedurat për administrimin e AECH CUG dhe shërbimit përkatës të SWIFT;
4. mbajnë kontaktet dhe mbështesin pjesëmarrësit në operimin në sistemin AECH, përkatësisht DSPKF-ja për çështjet operationale dhe DTI-ja për çështjet teknike e infrastrukturore;
5. administrojnë ngjarjet e paparashikuara dhe situatat e emergjencës në sistemin AECH, si dhe mbajnë kontakt me pjesëmarrësit për t'i informuar dhe asistuar ata, në përputhje me përcaktimet në këtë rregullore;
6. janë pikë kontakti me kompaninë kontraktore që ka ofruar sistemin AECH dhe ofron shërbimin e mirëmbajtjes së tij, si dhe ndjekin zbatimin e kontratave me të;
7. shqyrtojnë raportimet e pjesëmarrësve të sistemit AECH në lidhje me ngjarjet e paparashikuara të regjistruara pranë pjesëmarrësit dhe ecurinë e tyre deri në zgjidhje, raportet e incidentit, si dhe raportin e vetëvlerësimit të pjesëmarrësit për operimin në AECH. Nëse DTI-ja konstaton elemente teknike të cilët mund të kenë ndikim në operationet në sistemin AECH ose në aftësinë e pjesëmarrësit për të operuar në sistemin AECH, ia vë në vëmendje ato DSPKF-së;
8. bashkëpunojnë gjatë proceseve të testeve në sistemin AECH në ambientin e dedikuar për këtë qëllim;
9. bashkëpunojnë për përcaktimin e matricës së korrespondencës së funksionaliteteve të sistemit AECH që i përkasin roleve për të drejtat e përdoruesve në sistemin AECH;

10. bashkëpunojnë gjatë procesit të testimit të procedurave Fallback-Recovery;
11. bashkëpunojnë për hartimin e raporteve mbi incidente apo ngjarje të paparashikuara në infrastrukturën pranë Bankës së Shqipërisë, që ndikojnë në disponueshmërinë e shërbimit të sistemit AECH për pjesëmarrësit;
12. raportojnë, në përputhje me aktet e miratuara në fuqi, në lidhje me mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë, pranë njësisë përgjegjëse në Bankën e Shqipërisë që kryen këtë funksion;
13. bashkëpunojnë për formulimin e njoftimeve për pjesëmarrësit, në rastet e ngjarjeve të paparashikuara, situatave të emergjencës, apo aplikimit të ndryshimeve në sistem, kur këto ndryshime kanë ndikim në veprimtarinë operationale të pjesëmarrësve. Nëse shihet e nevojshme të jepen instruksione të mëtejshme, ato dërgohen përkatësisht nga DSPKF-ja për detajet operationale dhe nga DTI-ja për detajet teknike e infrastrukture;
14. në rastet kur kërkohet zyrtarisht nga një pjesëmarrës informacion mbi të dhëna të arkivuara dhe të paaksesueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në sistemin AECH, DTI-aj siguron informacionin e kërkuar në një format të përshtatshëm, dhe DSPKF-ja harton raportin informues për pjesëmarrësin, brenda afatit të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi;
15. hartojnë akte nënligjore të nevojshme për mirëfunksionimin dhe sigurinë e sistemit.

Neni 7 Funksionet e DM-së

Në lidhje me sistemin AECH, DM-ja ushtron funksionet e mëposhtme:

1. nëse gjatë proceseve të inspektimit të ushtruara nga DM-ja tek subjektet pjesëmarrëse në sistemin AECH dhe që mbikëqyren prej saj, verifikohet se komisionet bankare të aplikuara nga ato subjekte ndaj klientëve të tyre për urdhërpagesa në nisje dhe në mbërritje në sistemin AECH, janë mbi kufijtë e përcaktuar në rregullat e funksionimit të sistemit AECH, atëherë DM-ja njofton me shkresë zyrtare DSPKF-në për rastin e verifikuar të shkeljes së dispozitave të rregullores për funksionimin e sistemit AECH në fuqi;
2. në përfundim të inspektimit të plotë ose të pjesshëm të subjekteve bankare të kryer prej saj, i përcjell DSPKF-së rezultatet e inspektimit lidhur me sistemet e pagesave që operohen nga Banka e Shqipërisë. Përcjellja e rezultateve mund të bëhet me shkresë zyrtare ose në format elektronik nga/për punonjësit e përcaktuar nga Drejtuesi i njësisë përkatëse;
3. njofton pa vonesë DSPKF-në në raste kur nga DM-ja evidentohet se një subjekt pjesëmarrës në sistemin AECH paraqet vështirësi financiare, apo është vendosur në një status të caktuar me ndikim në sistemin e pagesave, është në proces likuidimi/falimentimi, si

- dhe kur evidentohen zhvillime në sektorin bankar me ndikim në sistemin e pagesave;
4. njofton pa vonesë DSPKF-në në çdo rast kur nis një proces bashkimi/përthithje e një banke me/nga një/disa bankë/a në një të vetme, në çdo rast kur nis një vendosje në proces likuidimi/falimentimi, si dhe kur nis një proces pezullimi apo revokimi (shfuqizimi) licence të një subjekti, i cili mbikëqyret nga DM-ja dhe është pjesëmarrës në sistemet e pagesave.

KREU III

PJESËMARRJA NË SISTEMIN AECH

Neni 8

Procedurat e anëtarësimit

Procedurat e anëtarësimit si pjesëmarrës në AECH ndiqen nga DSPKF-ja dhe DTI-ja, në bashkëpunim me kandidatin për pjesëmarrës, dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Këto procedura kalojnë në hapat e mëposhtëm.

1. DSPKF-ja merr në shqyrtim kërkesën zyrtare të kandidatit për anëtarësim në sistemin AECH, dhe informon kandidatin për miratimin ose jo të kërkesës së tij. Nëse kërkesa e kandidatit miratohet, atëherë vijohet me hapat e tjerë.
2. Informimi dhe asistenca teknike për kandidatin në procesin e anëtarësimit
 - a) DSPKF-ja informon kandidatin mbi të drejtat dhe detyrimet që lindin me anëtarësimin e tij si pjesëmarrës në sistemin AECH, duke i vënë në dispozicion aktet nënligjore në fuqi lidhur me sistemin AECH, si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.
 - b) DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë për hartimin, rast pas rasti, të kalendarit të detajuar me hapat teknike të anëtarësimit, si dhe DSPKF ia komunikon atë kandidatit.
 - c) DTI-ja informon kandidatin mbi infrastrukturën teknike që duhet të ketë në dispozicion dhe për detaje të tjera lidhur me parametrat dhe kushtet teknike që infrastruktura duhet të plotësojë, si dhe e asiston teknikisht atë.
 - d) DTI-ja vë në dispozicion të kandidatit mjetet e duhura, aty ku është e aplikueshme, si dhe dokumentacionin teknik të nevojshëm për kryerjen e instalimeve dhe implementimin e infrastrukturës së duhur për operimin e kandidatit në sistemin AECH.
 - e) DTI-ja dhe DSPKF-ja udhëzojnë dhe ndjekin procesin e anëtarësimit të kandidatit në AECH CUG dhe shërbimin përkatës të SWIFT.
3. Testimi dhe trajnimi i kandidatit
 - a) DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë për trajnimin e përdoruesve të ardhshëm të kandidatit për funksionet e sistemit AECH.
 - b) DTI-ja dhe DSPKF-ja, në bashkëpunim me kandidatin, kryejnë testimet e nevojshme në sistemin AECH.

- c) DTI-ja, në bashkëpunim me kandidatin, kryen testimet për elementet teknike të infrastrukturës që do të mbështesë operimin e kandidatit në sistemin AECH.
- 4. Aksesimi i sistemit TEST
 - a) DTI-ja pajis kandidatin me certifikatat dhe pajisjet e sigurisë, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AECH.
 - b) DTI-ja krijon përdoruesit e kandidatit në VPN, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AECH.
 - c) DTI-ja krijon dy oficerët e sigurisë së kandidatit në sistemin TEST, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AECH.
- 5. Përgatitja e dokumentacionit
 - a) DSPKF-ja dhe DTI-ja këshillojnë kandidatin gjatë procesit të hartimit të dokumentacionit dhe bazës rregullative mbi:
 - i. operimin në sistemin AECH;
 - ii. sigurinë e transmetimit të informacionit/instrukcioneve nga sistemet e tij për në sistemin AECH;
 - iii. planet e emergjencës.
- 6. Pranimi në anëtarësim
 - a) DTI-ja dhe DSPKF-ja shqyrtojnë plotësimin e dokumentacionit dhe bazës rregullative, si dhe plotësimin e të gjitha kushteve për pjesëmarrje në sistemin AECH nga ana e kandidatit dhe, nëse e vlerësojnë të plotë dokumentacionin dhe vlerësojnë se kandidati i plotëson të gjitha kushtet, vijojnë me hapat e tjerë.
 - b) DSPKF-ja ruan dokumentacionin e anëtarësimit të kandidatit, përfshirë marrëveshjen tip të pjesëmarrjes së kandidatit.
- 7. Aktivizimi i pjesëmarrësit
 - a) DSPKF-ja krijon pjesëmarrësin në sistemin AECH pas nënshkrimit të marrëveshjes tip të pjesëmarrjes në sistemin AECH.
 - b) DSPKF-ja njofton pjesëmarrësit e tjerë për anëtarësimin e pjesëmarrësit të ri 10 (dhjetë) ditë pune përpara datës në të cilën ky pjesëmarrës fillon veprimtarinë live në sistemin AECH.
 - c) DTI-ja pajis pjesëmarrësin me certifikatat dhe pajisjet e sigurisë, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AECH.
 - d) DTI-ja krijon përdoruesit e pjesëmarrësit në VPN, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AECH.
 - e) DTI-ja krijon dy oficerët e sigurisë së pjesëmarrësit në sistemin LIVE, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AECH.

Neni 9 Kufizimi i përkohshëm dhe përjashtimi

Kufizimi i përkohshëm apo përjashtimi i një pjesëmarrësi në sistemin AECH, kryhet në bashkëpunim të ngushtë të DSPKF-së dhe DM-së, dhe miratohet nga Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës së Shqipërisë.

KREU IV ADMINISTRIMI I SISTEMIT AECH

Neni 10 Administrimi i pjesëmarrësit

Në drejtim të administrimit të pjesëmarrësit në sistemin AECH, DSPKF-ja kryen funksionet e mëposhtme:

1. krijon pjesëmarrësin në sistemin AECH dhe kryen njoftimet përkatëse, siç është përcaktuar në procedurat e anëtarësimit;
2. me kërkesë/njoftim të pjesëmarrësit, modifikon/përditëson detaje të pjesëmarrësit, si adresa, personat e kontaktit etj.;
3. bazuar në vendime për ndryshime në lidhje me subjektin pjesëmarrës, kryen modifikimin/përditësimin e pjesëmarrësit dhe/ose llogarisë teknike të pjesëmarrësit në sistemin AECH;
4. kufizon përkohësisht aksesin e pjesëmarrësit në sistemin AECH dhe/ose përjashton pjesëmarrësin nga sistemi AECH, si dhe kryen njoftimet përkatëse, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi;
5. në rastin e kufizimit të përkohshëm apo të përjashtimit të një pjesëmarrësi nga sistemi AECH, diskuton paraprakisht dhe koordinon me DM-në procedurat që do të ndiqen;
6. në raste të përjashtimit të një pjesëmarrësi nga sistemi AECH:
 - a) njofton me shkresë zyrtare DM-në për ekzekutimin e mbylljes së llogarisë teknike të pjesëmarrësit,
 - b) njofton me shkresë zyrtare DTI-në për të kryer fshirjen/bllokimin e përdoruesve të pjesëmarrësit nga sistemi AECH, dhe marrë masat e nevojshme në lidhje me AECH CUG dhe shërbimin përkatës të SWIFT-it për këtë pjesëmarrës.

Neni 11 Administrimi i përdoruesve

1. DSPKF-ja, në cilësinë e përgjegjësit të sistemit AECH, në bashkëpunim me DTI-në, përcakton matricën e korrespondencës së funksionaliteteve të sistemit AECH që i përkasin roleve për të drejtat e përdoruesve, bazuar në aktivitetin operacional që duhet të kryejnë, duke pasur në vëmendje parimet bazë të "katër syve" dhe të të drejtave minimale në sistemin AECH.
2. DTI-ja, në cilësinë e kujdestarit të sistemit, realizon veprimet e mëposhtme në lidhje me administrimin e përdoruesve të sistemit AECH:
 - a) krijon teknikisht rolet për të drejtat e përdoruesve në sistemin AECH, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni;
 - b) krijon përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në sistemin AECH test, pas miratimit me e-mail të drejtuesit të DSPKF-së;
 - c) krijon, modifikon ose fshin përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në sistemin AECH primar, sipas kërkesës së nënshkruar nga drejtuesi i Departamentit kërkues, dhe të miratuar nga drejtuesit

- e DSPKF-së dhe DTI-së, sipas Shtojcës A bashkëlidhur;
- d) administron certifikatat dixhitale për përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në lidhje me sistemin AECH, sipas kërkesës së nënshkruar nga drejtuesi i Departamentit kërkuar, dhe të miratuar nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së, sipas Shtojcës B bashkëlidhur;
 - e) bazuar në aktet nënligjore në fuqi për përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në sistemin AECH, modifikon statusin e llogarisë së përdoruesit dhe/ose rivendos fjalëkalimin e tij, në përputhje me kërkesën për ndryshim në llogarinë e përdoruesit nga drejtuesi i Departamentit përkatës, si dhe zotëruesi i llogarisë në rastin e rivendosjes së fjalëkalimit;
 - f) krijon, modifikon ose fshin përdorues të një pjesëmarrësi, si dhe rivendos fjalëkalim të përdoruesit të pjesëmarrësit, në rast pamundësie të kryerjes së kësaj procedure nga vetë pjesëmarrësi, sipas përcaktimeve në rregulloren për sistemin AECH;
 - g) rinovon çdo vit certifikatat dixhitale të përdoruesve të pjesëmarrësve në sistemin AECH, të paraqitura prej tyre në Bankën e Shqipërisë në përfundim të afatit të skadencës, sipas përcaktimeve në rregulloren për sistemin AECH.

Neni 12 **Administrimi i kalendarit**

Në bazë të njoftimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë mbi kalendarin e festave zyrtare, DSPKF-ja:

- a) plotëson kalendarin për vitin pasardhës para fillimit të vitit të ri ushtrimor;
- b) ndryshon kalendarin dhe njofton pjesëmarrësit, në çdo rast kur është e mundur jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e kryerjes së këtyre ndryshimeve.

Neni 13 **Administrimi i orareve të operimit**

1. DSPKF-ja ndryshon oraret e operimit në sistemin AECH, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe pasi vlerëson rrethanat në të cilat lind nevoja për ndryshim të orareve, duke përfshirë këtu:
 - a) ngjarje të paparashikuara dhe situata emergjence;
 - b) kërkesë nga një njësi e Bankës së Shqipërisë;
 - c) kërkesë nga një pjesëmarrës.
2. DSPKF-ja ndryshon numrin e seancave të klerimit, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe pasi vlerëson rrethanat në të cilat lind nevoja, duke përfshirë këtu:
 - a) ngjarje të paparashikuara dhe situata emergjence;
 - b) kërkesë individuale nga një pjesëmarrës brenda një afati të përshtatshëm kohor.

3. DSPKF-ja lajmëron pjesëmarrësit e sistemit AECH për ndryshimin e orareve apo të seancave të klerimit me e-mail ose mesazh SWIFT.

Neni 14 **Testimi dhe ndryshimet në sistem**

1. Çdo kërkesë për ndryshim në sistemin AECH vlerësohet nga DSPKF-ja dhe DTI-ja, përkatësisht në cilësinë e përgjegjësimit të sistemit dhe kujdestarit të sistemit, dhe miratohet prej tyre për t'u zbatuar kur çmohet e arsyeshme.
2. Në rastet kur ndryshimet e propozuara kanë ndikime tek pjesëmarrësit e tjerë të sistemit AECH, DSPKF-ja dhe DTI-ja këshillohen paraprakisht me këta të fundit.
3. DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë në kryerjen e testeve në raste kur lind nevoja të shqyrtohen sjellje funksionale të sistemit, ndërveprime të tij me sisteme të tjera, përditësime të ofruara nga kompania kontraktore që kryen mirëmbajtjen e sistemit AECH, si dhe kur evidentohen problematika në funksionim.
4. Çdo ndryshim duhet të aplikohet në sistemin AECH vetëm pasi të jetë testuar në ambientin e dedikuar për testim, dhe pas miratimit nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së. DTI-ja kujdeset që aplikimi i ndryshimeve në sistemin AECH të kryhet në të dy ambientet, primar dhe backup.
5. Në lidhje me ndryshime të rëndësishme, të cilat prekin aspekte të caktuara të sistemit AECH, siç është përcaktuar në aktet në fuqi në lidhje me mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë, DTI-ja dhe DSPKF-ja njoftojnë njësinë përgjegjëse në Bankën e Shqipërisë që kryen këtë funksion.
6. DTI-ja dhe DSPKF-ja konsultohen me njësinë përgjegjëse në Bankën e Shqipërisë që kryen funksionin e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë për të shqyrtuar ndikimet e mundshme që mund të kenë ndryshimet në lidhje me përputhshmërinë e sistemeve me parimet mbikëqyrëse.

KREU V **VEPRIMTARIA OPERACIONALE NË AECH**

Neni 15 **Hapja e ditës së punës**

1. DTI-ja kujdeset për të gjithë komponentët e infrastrukturës teknike për të garantuar disponueshmërinë e sistemit AECH gjatë gjithë kohës së operimit.
2. Hapja e ditës së punës në sistemin AECH mund të realizohet në formë automatike ose me ndërveprim të përdoruesit (manuale). DSPKF-ja vlerëson formën më të përshtatshme për realizimin e hapjes së ditës së punës dhe konfiguron sistemin në njërin prej dy formave, e cila mbahet e pandryshuar deri në një vlerësim të ndryshëm nga ky i fundit.

3. Nëse forma e hapjes së ditës së punës në sistemin AECH është automatike, atëherë DSPKF-ja monitoron në çdo orar hapjeje të ditës së punës, statusin e realizimit të këtij procesi.
4. Nëse forma e hapjes së ditës së punës në sistemin AECH është manuale, atëherë DSPKF-ja, në përputhje me oraret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi, ekzekuton procesin e hapjes së ditës së punës në sistemin AECH dhe monitoron ecurinë dhe statusin e realizimit të këtij procesi.

Neni 16 **Mbyllja e ditës së punës**

1. Mbyllja e ditës së punës në sistemin AECH mund të realizohet në formë automatike ose me ndërveprim të përdoruesit (manuale). DSPKF-ja vlerëson formën më të përshtatshme për realizimin e mbylljes së ditës së punës dhe konfiguron sistemin në njërin prej dy formave, e cila mbahet e pa ndryshuar deri në një vlerësim të ndryshëm nga ky i fundit.
2. Nëse forma e mbylljes së ditës së punës në sistemin AECH është automatike, atëherë DSPKF-ja monitoron në çdo orar mbylljeje të ditës së punës, statusin e realizimit të këtij procesi.
3. Nëse forma e mbylljes së ditës së punës në sistemin AECH është manuale, atëherë DSPKF-ja, në përputhje me oraret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi, ekzekuton procesin e mbylljes së ditës së punës në sistemin AECH dhe monitoron ecurinë dhe statusin e realizimit të këtij procesi.
4. DTI-ja kujdeset për realizimin e procedurave teknike të përcaktuara në funksion të vazhdimësisë së biznesit për sistemin AECH.

Neni 17 **Monitorimi i sistemit**

Monitorimi i sistemit AECH kryhet bashkërisht nga DSPKF-ja dhe DTI-ja.

1. DSPKF-ja monitoron gjendjen e sistemit gjatë gjithë ditës së punës dhe në veçanti:
 - a) hapjen dhe mbylljen e ditës së punës;
 - b) klerimin e instruksioneve të pagesave në sistem;
 - c) ekzekutimin e seancave të kleringut;
 - d) shlyerjen e rezultatit të kleringut në sistemin AIPS në oraret e përcaktuara;
 - e) statusin e instruksioneve të pagesave.
2. DTI-ja monitoron gjendjen teknike të sistemit gjatë gjithë ditës së punës dhe në veçanti:
 - a) hapjen dhe mbylljen e ditës së punës;
 - b) gjendjen e shërbimeve në funksion të sistemit AECH;
 - c) gjendjen e infrastrukturës që ofron shërbimin e AECH ndaj pjesëmarrësve;
 - d) gjurmët e aktivitetit të sistemit në drejtim të evidentimit të

- problematikave të mundshme.
3. DSPKF-ja ndjek rastet me pasaktësi në instruksionet e pagesave të iniciuara dhe/ose të mbërritura në favor të Bankës së Shqipërisë.
 4. Në rast se, gjatë monitorimit të aktivitetit ditor, DSPKF-ja vë re anomali në funksionimin e sistemit, njofton menjëherë DTI-në me e-mail ose mjete të tjera komunikimi.
 5. Në rast se, gjatë monitorimit të aktivitetit ditor të sistemeve që administron, DTI-ja vë re anomali të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndikojnë elemente të mirëfunksionimit të sistemit AECH, njofton menjëherë me e-mail DSPKF-në.

Neni 18

Veprimet e Bankës së Shqipërisë si pjesëmarrëse e sistemit AECH

1. Veprimet e iniciuara nga Banka e Shqipërisë si pjesëmarrëse e sistemit AECH përfshijnë:
 - a) instruksione të pagesave të gjeneruara automatikisht në sistemin AECH nga ndërfaqësimi me sistemin e Financës së Bankës së Shqipërisë;
 - b) instruksione të pagesave të regjistruara nga DSPKF-ja me urdhër të njësisë së Financës së Bankës së Shqipërisë, në rastet kur këto instruksione nuk mund të gjenerohen automatikisht në sistemin AECH.
2. Krahas veprimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ekzekutohen edhe veprimet e mbërritura në sistemin AECH nga pjesëmarrësit në favor të Bankës së Shqipërisë.
3. DSPKF-ja ndjek ecurinë e plotë të procesimit të instruksioneve të pagesave të iniciuara nga Banka e Shqipërisë dhe të mbërritura në favor të saj, që përfshin:
 - a) transmetimin e instruksioneve të pagesave në sistemin AECH;
 - b) ekzekutimin e seancës së kleringut dhe shlyerjen e instruksioneve të pagesave;
 - c) dokumentimin e veprimeve në llogaritë përkatëse.

Neni 19

Veprimet për Ministrinë

Në zbatim të rolit të Bankës së Shqipërisë bazuar në marrëveshjen e posaçme të lidhur midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë:

1. DTI-ja është përgjegjëse për:
 - a) mbarëvajtjen e infrastrukturës dhe proceseve teknike të lidhura me Ministrinë në funksion të sistemit AECH;
 - b) integritetin e transmetimit të informacionit në infrastrukturën për të cilën është përgjegjëse Banka e Shqipërisë;
 - c) dërgimin e raporteve elektronike të gjeneruara nga sistemi AECH drejt Ministrisë.
2. DSPKF-ja është përgjegjëse për:
 - a) procesimin e instruksioneve të pagesave të Ministrisë;

- b) ndjekjen e procesit të klerimit të instruksioneve të pagesave të Ministrisë;
- c) ndjekjen e procesit të shlyerjes së instruksioneve të pagesave të Ministrisë.

KREU VI

NGJARJET E PAPANASHIKUARA DHE SITUATAT E EMERGJENCËS

Neni 20

Administrimi i ngjarjeve të paparashikuara dhe situatave të emergjencës

1. Ngjarje e paparashikuar, në kuptimin e sistemit AECH, konsiderohet çdo mosfunksionim në:
 - a) infrastrukturën e sistemit AECH;
 - b) komponente të infrastrukturës IT që ka ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në mirëfunksionimin e sistemit AECH.
2. Situatë emergjence, në kuptimin e sistemit AECH, konsiderohet çdo ndërprerje e rëndësishme e funksionimit të shërbimit të sistemit AECH.
3. Shpallja e situatës së emergjencës kryhet nga DSPKF-ja dhe DTI-ja, në bashkëpunim.
4. Ngjarjet e paparashikuara dhe situatat e emergjencës administrohen nga DTI-ja dhe DSPKF-ja, në bashkëpunim dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.
5. Në çdo rast kur DTI-ja konstaton një ngjarje të paparashikuar apo situatë emergjence në kuptimin e sistemit AECH, njofton menjëherë DSPKF-në.
6. Në çdo rast kur DSPKF-ja konstaton një mosfunksionim në sistemin AECH, njofton menjëherë DTI-në.
7. Menjëherë pas konstatimit të një ngjarjeje të paparashikuar apo të një situatë emergjence në kuptimin e sistemit AECH, DTI-ja merr masa për zgjidhjen e saj.
8. DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë për formulimin e njoftimit për pjesëmarrësit, në rast se është e nevojshme.
9. Në rast se brenda 30 minutave nga konstatimi i ngjarjes së paparashikuar apo situatës së emergjencës, problematika nuk është zgjidhur dhe mosfunksionimi ndikon operacionet e pjesëmarrësve në sistemin AECH, DSPKF-ja dërgon me mesazh SWIFT dhe/ose e-mail njoftimin për pjesëmarrësit e sistemit, sipas formulimit të përbashkët me DTI-në.
10. Në rast se, për shkak të ngjarjes së paparashikuar apo situatës së emergjencës, rivënia në punë e sistemit AECH primar është e pamundur, DTI-ja realizon procedurat për kalimin në sistemin backup.
11. DTI-ja, në bashkëpunim me DSPKF-në, udhëzon pjesëmarrësit për hapat që duhet të ndjekin për kalimin në sistemin backup dhe vazhdimin e veprimeve operacionale.
12. Me rikthimin e situatës në normalitet dhe kalimin në sistemin AECH primar, DTI-ja, në bashkëpunim me DSPKF, udhëzon pjesëmarrësit.

13. Menjëherë pas zgjidhjes së situatës, DSPKF-ja njofton pjesëmarrësit me mesazh SWIFT dhe/ose e-mail.
14. Ngjarjet e paparashikuara dhe situatat e emergjencës të lidhura me sistemin AECH raportohen në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Neni 21 **Forca madhore**

1. Në rastin e situatave që krijohen si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme, luftërave, turbullirave të tjera civile, fatkeqësive natyrore dhe për çdo rrethanë tjetër jashtë kontrollit të Bankës së Shqipërisë si operator i sistemit dhe pjesëmarrësve në sistem, si dhe si pasojë e çdo force tjetër madhore, drejtuesit e DTI-së dhe DSPKF-së, kur është e mundur, vendosin për ndërprerjen e menjëhershme të operimit të sistemit AECH, me qëllim mbrojtjen e pajisjeve, të dhënave dhe komponentëve të tjerë mbështetës të tij.
2. Me përfundimin e ngjarjeve që përbëjnë forcë madhore, DTI-ja dhe DSPKF-ja ndërmarrin hapat e nevojshëm për rifillimin e operimit të sistemit AECH, duke monitoruar dhe kontrolluar në mënyrë të hollësishme transaksionet në sistemin AECH.
3. DTI-ja dhe DSPKF-ja kryejnë analiza mbi aktivitetin dhe bashkëveprimin e njësive të Bankës së Shqipërisë gjatë rasteve të forcave madhore, si dhe mbi përpjekjet e bëra për të mundësuar kthimin e aktivitetit operacional në sistem. Kur shihet e nevojshme, propozohen masa për përmirësime të procedurave dhe/ose të konfigurimeve të sistemeve dhe pajisjeve.

KREU VII **DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 22 **Organizimi i brendshëm**

1. Organizimi i brendshëm i punës brenda njësive organizative të Bankës së Shqipërisë të përmendura në këtë rregullore, për ushtrimin e funksioneve dhe zbatimin e detyrave të përcaktuara nga dispozitat e saj, përcaktohet nëpërmjet manualeve përkatëse të veprimtarisë për çdo njësi organizative përbërëse, si dhe në përshkrimet e vendeve të punës së punonjësve.
2. Manualet dhe përshkrimet e vendeve të punës të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, hartohen në përputhje me manualet e përdorimit të sistemit AECH dhe me dispozitat e rregulloreve të organizimit dhe funksionimit të departamenteve përkatëse.
3. Matrica e korrespondencës së funksionaliteteve të sistemit AECH që i përkasin roleve të përcaktuara për dhënien e aksesit përdoruesve në funksion të kryerjes së detyrave të tyre operationale në sistemin AECH, miratohet nga drejtuesit e DTI-së dhe DSPKF-së.
4. Kalendarit i anëtarësisë të pjesëmarrësit në sistemin AECH është

subjekt i specifikave që lidhen me ndryshimet teknologjike dhe përditësimet e herëpashershme, të cilave i nënshtrohet sistemi AECH, dhe hartohet rast pas rasti nga DSPKF-ja dhe DTI-ja në bashkëpunim, si dhe miratohet nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së.

Neni 23 **Hyrja në fuqi**

Rregullorja hyn në fuqi pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

GENT SEJKO

SHTOJCA A



**BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE DHE I KONTABILITETIT DHE FINANCËS
KËRKESË PËR APROVIM PROFILI PËRDORUESI NË AECH**

Drejtori i
Departamentit kërkues

(_____)

Tiranë, më

____ / ____ / ____

Departamenti:	_____
---------------	-------

Sektori:	_____
----------	-------

Drejtori i DSPKF

(_____)


Punonjësit: _____ me detyrë: _____ t'i jepen
të drejtat si më poshtë:

Nr.	Aplikacioni AECH	Përdorues
1	Aprovues Execute AECH	<input type="checkbox"/>
2	Operator Execute AECH	<input type="checkbox"/>
3	Operator AECH	<input type="checkbox"/>
4	Back Office Export	<input type="checkbox"/>
5	Operator Back Office	<input type="checkbox"/>
6	Monitorues	<input type="checkbox"/>
7	Monitorues MF	<input type="checkbox"/>
8	BOA_Security_Officer	<input type="checkbox"/>

Nr.	Aplikacioni PO	Përdorues
1	Operator AECH	<input type="checkbox"/>
2	Aprovues AECH	<input type="checkbox"/>
3	Operator Enter (AIPS & AECH)	<input type="checkbox"/>
4	Operator Approve (AIPS & AECH)	<input type="checkbox"/>
5	Operator MF	<input type="checkbox"/>
6	Aprovues MF	<input type="checkbox"/>
7	BOA_Security_Officer	<input type="checkbox"/>

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit		Drejtori i DTI
Punonjësi	_____	(_____)
Username	_____	Data Nënshkrimi (Firma)
Krijoi	_____	_____
Kontrolloi	_____	_____

SHTOJCA B

KONFIDENCIAL		
		
BANKA E SHQIPËRISË DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT		
FORMULARI I KËRKESËS PËR CERTIFIKATË DIXHITALE AECH		
Të plotësohet ky formular për të administruar certifikatat dixhitale të përdoruesve të Bankës së Shqipërisë lidhur me sistemin AECH		
Departamenti Kërkues		
Drejtori i Departamentit Kërkues (Emri Mbiemri / Nënshkrimi)	Data e kërkesës: (dd/mm/vvv)	
KËRKESË PËR CERTIFIKATË DIXHITALE		
Nr.	Emri/Mbiemri i përdoruesit	Veprimi
1		<input type="checkbox"/> Gjenerim certifikatë e re
		<input type="checkbox"/> Rigjenerim certifikate
		<input type="checkbox"/> Zhbllokim pajisje sigurie
		<input type="checkbox"/> Rivendosje fjalëkalimi i pajisjes së sigurisë
		<input type="checkbox"/> Revokim certifikate
Shënim:		
Drejtori i DSPKF (Emri Mbiemri / Nënshkrimi)		Drejtori i DTI (Emri Mbiemri / Nënshkrimi)
Departamenti i Teknologjisë së Informacionit		
Punonjësi		
Username		Data Nënshkrimi (Firma)
Krijoi		
Kontrolloi		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 38, datë 3.6.2020

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË
FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË
MADHE – AIPS”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 4, shkronja “dh”, si dhe neneve 14, 21, dhe 43, shkronja “f” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 13 të ligjit nr. 133/2013 “Për sistemin e pagesave”; nenit 129, pika 6, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për organizimin e brendshëm të funksionimit të sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Emisionit, Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme me zbatimin e këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 54, datë 26.9.2007, “Për miratimin e rregullores “Mbi rregullat e brendshëm të funksionimit të sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS”, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

RREGULLORE
“PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT
TË PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE - AIPS”

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave të brendshme për administrimin, operimin dhe organizimin e sistemit AIPS nga Banka e Shqipërisë.
2. Subjekte të kësaj rregulloreje janë njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë të përcaktuara në të.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të:

- a) ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”;
- b) ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;
- c) ligjit “Për sistemin e pagesave”;
- d) ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”;
- e) rregullores “Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS”;
- f) akteve të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë që lidhen, por nuk kufizohen me: funksionimin e sistemeve të pagesave, minimumin e rezervës së detyruar, instrumentet e pagesave elektronike, kredinë brenda ditës për bankat, kredinë njëditore për bankat, sigurinë e informacionit, administrimin e rrezikut operacional etj.

Neni 3
Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të rregullores, termat e përkufizuar në rregulloren “Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS” kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore.
2. Përveç sa parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të rregullores, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) DE – është Departamenti i Emissionit në Bankën e Shqipërisë;
 - b) DM – është Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë;
 - c) DNJ – është Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë;
 - d) DOM – është Departamenti i Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë;

- e) DSPKF – është Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës në Bankën e Shqipërisë, i cili, në cilësinë e Përgjegjës të sistemit, përcakton kriteret për trajtimin, administrimin dhe aksesimin e sistemit, si dhe pranon dhe miraton ndryshimet apo përmirësimet e mundshme në lidhje me sistemin;
- f) DTI – është Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në Bankën e Shqipërisë, i cili, në cilësinë e Kujdestarit të sistemit, kujdeset për sistemin, duke e administruar teknikisht atë dhe infrastrukturën mbështetëse të tij, si dhe duke zbatuar dhe mbrojtur rregullat e përcaktuara nga përgjegjësi i sistemit;
- g) File Importi – është skedar elektronik me instruksione pagesash i gatshëm për t’u importuar;
- h) Ministria – është ministria përgjegjëse për financat;
- i) Rregullorja për sistemin AIPS – Rregullorja e Bankës së Shqipërisë “Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS” dhe çdo ndryshim i saj.

KREU II FUNKSIONET E DEPARTAMENTEVE NË SISTEMIN AIPS

Neni 4 Funksionet e DSPKF-së

DSPKF-ja ushtron funksionet e mëposhtme në sistemin AIPS:

1. është përgjegjës i sistemit AIPS;
2. administron operacionalisht sistemin AIPS;
3. zbaton politikën e sigurisë në sistemin AIPS, në cilësinë e përgjegjës të sistemit;
4. faturon detyrimet e pjesëmarrësve për shërbimet e sistemit AIPS dhe shërbimin e shlyerjes së kartave të kryer nga Banka e Shqipërisë. Ekzekuton dhe ndjek shlyerjen e tyre në sistemin AIPS. Dërgon zyrtarisht faturat pranë pjesëmarrësve të sistemit AIPS;
5. kryen procedurat për kufizimin e përkohshëm, dhe/ose përjashtimin e pjesëmarrësit në sistemin AIPS, si dhe njofton për këtë pjesëmarrësit e sistemit;
6. përfaqëson Bankën e Shqipërisë si agjent shlyerës, duke ekzekutuar në sistem instruksionet për shlyerje neto, si dhe urdhërpagesat e pjesëmarrësve të tërthortë;
7. përfaqëson Bankën e Shqipërisë si pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë në sistemin AIPS, duke pasqyruar, procesuar dhe monitoruar transaksionet e regjistruara për qëllime të aktivitetit të saj;
8. ndjek/monitoron shlyerjen në sistemin AIPS të instruksioneve të pagesave të transferuara nga sisteme vartëse;
9. në raste të pamundësive teknike për transferimin e instruksioneve të pagesave nga sistemet vartëse të operuara nga Banka e Shqipërisë për në sistemin AIPS, kryen regjistrimin e tyre në sistemin AIPS bazuar në dokumentacionin përkatës të dërguar me e-mail ose shkresë zyrtare të departamentit iniciues, siç është përcaktuar në këtë rregullore;

10. për pjesëmarrës operatorë, në raste të ngjarjeve të paparashikuara dhe sipas shkresës zyrtare të pjesëmarrësit, të nënshkruar nga nënshkrimet e autorizuar sipas rregullit dhe klasifikimit, të njoftuara zyrtarisht nga pjesëmarrësi, kryen regjistrimin e instruksioneve të shlyerjes neto përkatëse;
11. për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë, me shkresë zyrtare të pjesëmarrësit, të nënshkruar nga nënshkrimet e autorizuar sipas rregullit dhe klasifikimit, të njoftuara zyrtarisht nga pjesëmarrësi, ose urdhër të dërguar me mesazh SWIFT të autentifikuar, në raste të lidhura me mosfunksionime në infrastrukturë apo për arsye të përfundimit të afateve kohore sipas orareve të operimit të sistemit AIPS në lidhje me procesimin e transaksioneve, kryen regjistrimin e transaksioneve ndërbankare të pjesëmarrësit;
12. kryen ndryshimin e radhitjes së urdhërpagesave me kërkesë të pjesëmarrësve ose kur e çmon të domosdoshme, për qëllime të efektivitetit në operimin e sistemit dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi;
13. ndërhyt për fshirjen e një urdhërpagese të pashlyera në radhë, nëse kjo gjë kërkohet nga pjesëmarrësi, ose kur lind nevoja dhe çmon se pjesëmarrësi, për shkak të problemeve teknike, nuk mund ta administrojë radhën përkatëse;
14. ndërhyt për anulimin e transaksionit të mbetur në gjendje pezull për çështje përputhshmërie me listën e sanksioneve, në rastin kur pjesëmarrësi nuk është në gjendje të kryejë vetë anulimin e transaksionit të tij, dhe/ose ky transaksion pengon ecurinë normale të operimit të sistemit AIPS;
15. përgatit dhe publikon statistika mbi veprimtarinë në sistemin AIPS;
16. bashkëpunon me departamentet e tjera për zbatimin e rregulloreve të sistemit AIPS;
17. mban dhe përditëson listën e personave të kontaktit të çdo pjesëmarrësi për sistemin AIPS, si dhe njofton pjesëmarrësit për listën e përditësuar të personave të kontaktit të Bankës së Shqipërisë për sistemin;
18. mban dhe përditëson listën e nënshkrimeve të autorizuar (të shoqëruar me kategoritë dhe limitet përkatëse) të pjesëmarrësve, të cilat përdoren për sistemin AIPS;
19. për çdo shkresë zyrtare, formular apo raport që adresohet në Bankën e Shqipërisë në lidhje me sistemin AIPS, kryen verifikimin e firmave të autorizuar aty ku është e aplikueshme, përpara se të kryhen veprime të mëtejshme nga njësitë e tjera apo vetë DSPKF-ja. Pas verifikimit me sukses të firmave të autorizuar, përcjell shkresën e mbërritur me korrespondencë zyrtare për në njësinë përgjegjëse të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e veprimeve të mëtejshme;
20. i dërgon shkresë zyrtare pjesëmarrësit për çdo rast të shkeljes së detyrimeve të pjesëmarrësit në sistemin AIPS;
21. informon DM-në për çdo rast të evidentuar shkeljeje të detyrimeve të pjesëmarrësve në sistemin AIPS, sipas akteve nënligjore në fuqi;
22. informon në çdo rast me shkresë zyrtare DM-në mbi transaksionet e filtruar në sistemin AIPS, sipas listës së sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;

23. informon dhe bashkëpunon me DOM-in, DM-në dhe DNJ-në për raste ku pjesëmarrësit në sistemin AIPS paraqesin problematika në sistemin e pagesave me ndikim në sistemin bankar apo financiar në tërësi;
24. bashkëpunon dhe shkëmben informacione me DOM-in, DM-në dhe DNJ-në për krijimin e mjeteve dhe procedurave, në kuadër të ruajtjes së sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të pagesave;
25. informon dhe bashkëpunon me njësinë përgjegjëse për mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve të pagesave, për raste kur pjesëmarrës operatorë në sistemin AIPS paraqesin problematika me ndikim në infrastrukturën e tregut financiar;
26. raporton pranë njësisë përgjegjëse për administrimin e rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë, mbi ngjarjet e rrezikut operacional të lidhura me sistemin AIPS, në këndvështrimin operacional.

Neni 5 Funksionet e DTI-së

DTI-ja ushtron funksionet e mëposhtme në sistemin AIPS:

1. është kujdestar i sistemit AIPS;
2. administron dhe mirëmban teknikisht sistemin AIPS dhe infrastrukturën mbështetëse të tij, përfshirë shërbimet përkatëse të SWIFT-it në funksion të sistemit AIPS;
3. zbaton politikën e sigurisë në sistemin AIPS, në cilësinë e kujdestarit të sistemit, dhe ndërton mekanizma të sigurt për:
 - i. mbrojtjen e aksesit ndaj tij,
 - ii. autentifikimin e dërguesit të instruksionit të pagesës,
 - iii. mbrojtjen e besueshmërisë dhe të konfidencialitetit të informacionit të marrë dhe të ruajtur nga sistemi AIPS;
4. shqyrton kërkesat nga përdoruesit për zhvillime të reja në sistemin AIPS dhe, pas vlerësimit të mundësive të realizimit, ndërmer hapat e nevojshëm sipas rastit, në bashkëpunim me DSPKF-në, për implementimin e tyre në sistem;
5. ndërton mekanizma për evidentimin e incidenteve dhe problemeve lidhur me funksionimin e sistemit AIPS dhe infrastrukturës që e mbështet atë;
6. mban regjistrin e anomalive/problematikave të identifikuara ose të sinjalizuara në lidhje me sistemin AIPS, si dhe merr masa për zgjidhjen e tyre. Në rast se zgjidhja e anomalisë është jashtë mundësive teknike dhe kompetencave të DTI-së, atëherë njofton kompaninë kontraktore që ka ofruar sistemin AIPS dhe shërbimin e mirëmbajtjes së tij, për të asistuar në zgjidhjen e saj;
7. zbaton në sistem procedurat për vendosjen e versioneve të reja, si dhe kryerjen e përditësimeve, në përputhje me instruksionet e dhëna nga kompania kontraktore që ka ofruar sistemin AIPS;
8. administron teknikisht përdoruesit dhe të drejtat në sistem;
9. administron formularët/kërkesat për përdorues në VPN, pajisje sigurie, certifikata dixhitale dhe përdorues të lidhur me sistemin

- AIPS, të paraqitura nga DSPKF-ja si përgjegjës i sistemit;
10. harton dhe zbaton procedurat Fallback-Recovery dhe Backup-Restore në funksion të vazhdimësisë së veprimtarisë, i teston periodikisht ato, si dhe informon DSPKF-në mbi rezultatet;
 11. shqyrton njoftimin e pjesëmarrësit në rastet kur ai raporton për testime ose ndryshime infrastrukturore, të cilat mund të ndikojnë aftësinë e tij për të operuar në sistemin AIPS, si dhe e udhëzon atë sipas rastit;
 12. informon DSPKF-në për çdo rast të evidentuar shkeljeje të detyrimeve teknike të pjesëmarrësve në sistemin AIPS, me qëllim që DSPKF-ja të vijojë me njoftimin e DM-së, sipas akteve nënligjore në fuqi;
 13. raporton pranë njësisë përgjegjëse për administrimin e rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë, mbi ngjarjet e rrezikut operacional të lidhura me sistemin AIPS, në këndvështrimin teknik.

Neni 6 Funksione të përbashkëta mes DSPKF-së dhe DTI-së

DSPKF-ja dhe DTI-ja, në sistemin AIPS, ushtrojnë funksione të përbashkëta si më poshtë:

1. zbatojnë rregullat për sigurinë e informacionit në funksion të garantimit të parimeve të sigurisë: disponueshmërisë, konfidencialitetit, integritetit, aksesit të kontrolluar në sistem;
2. ndjekin procedurat për anëtarësimin e pjesëmarrësve të rinj në sistemin AIPS;
3. ndjekin procedurat për administrimin e AIPS CUG dhe shërbimit përkatës të SWIFT-it;
4. mbajnë kontaktet dhe mbështesin pjesëmarrësit në operimin e sistemit AIPS, përkatësisht DSPKF-ja për çështjet operationale dhe DTI-ja për çështjet teknike e infrastrukturore;
5. administrojnë ngjarjet e paparashikuara dhe situatat e emergjencës në sistemin AIPS, dhe mbajnë kontakt me pjesëmarrësit për t'i informuar dhe asistuar ata në përputhje me përcaktimet në këtë rregullore;
6. janë pikë kontakti me kompaninë kontraktore që ka ofruar sistemin AIPS dhe ofron shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit, si dhe ndjekin zbatimin e kontratave me të;
7. shqyrtojnë raportimet e pjesëmarrësve të sistemit AIPS në lidhje me ngjarjet e paparashikuara të regjistruara pranë pjesëmarrësit dhe ecurinë e tyre deri në zgjidhje, raportet e incidentit, si dhe raportin e vetëvlerësimit të pjesëmarrësit për operimin në AIPS. Nëse DTI-ja konstaton elemente teknike, të cilat mund të kenë ndikim në operationet në sistemin AIPS ose në aftësinë e pjesëmarrësit për të operuar në sistem, ia vë ato në vëmendje DSPKF-së;
8. bashkëpunojnë gjatë proceseve të testimeve në sistemin AIPS, në ambientin e dedikuar për këtë qëllim;
9. bashkëpunojnë për përcaktimin e matricës së korrespondencës së funksionaliteteve të sistemit AIPS që i përkasin roleve për të drejtat e përdoruesve në sistem;
10. bashkëpunojnë gjatë procesit të testimit të procedurave Fallback-

- Recovery;
11. bashkëpunojnë për hartimin e raporteve mbi incidente apo ngjarje të paparashikuara në infrastrukturën pranë Bankës së Shqipërisë, që ndikojnë në disponueshmërinë e shërbimit të sistemit AIPS për pjesëmarrësit;
 12. raportojnë në përputhje me aktet e miratuara në fuqi, në lidhje me mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë, pranë njësisë përgjegjëse në Bankën e Shqipërisë që kryen këtë funksion;
 13. bashkëpunojnë për formulimin e njoftimeve për pjesëmarrësit, në rastet e ngjarjeve të paparashikuara, situatave të emergjencës apo aplikimit të ndryshimeve në sistem, kur këto ndryshime kanë ndikim në veprimtarinë operacionale të pjesëmarrësve. Nëse shihet e nevojshme të jepen instruksione të mëtejshme, ato dërgohen përkatësisht nga DSPKF-ja për detajet operacionale dhe nga DTI-ja për detajet teknike e infrastrukurore;
 14. në rastet kur kërkohet zyrtarisht nga një pjesëmarrës informacion mbi të dhëna të arkivuara dhe të paaksesueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në sistemin AIPS, DTI-ja siguron informacionin e kërkuar në një format të përshtatshëm, dhe DSPKF-ja harton raportin informues për pjesëmarrësin, brenda afatit të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi;
 15. kryejnë procedurën e përditësimit dhe importimit të listës së sanksioneve të publikuar në formatin elektronik nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;
 16. hartojnë akte nënligjore të nevojshme për mirëfunksionimin dhe sigurinë e sistemit.

Neni 7 Funksionet e DOM-it

DOM-i, në lidhje me sistemin AIPS, ushtron funksionet e mëposhtme:

1. informohet mbi gjendjen e likuiditetit;
2. inicion dhe transferon veprime për qëllime të aktivitetit operacional të DOM-it nëpërmjet sistemeve vartëse, shlyerja e cash-it e të cilave realizohet në sistemin AIPS;
3. përcakton rezervat e detyruara për pjesëmarrësit, normat e remunerimit dhe gjobave, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi;
4. bashkëpunon me DSPKF-në në funksion të realizimit të shlyerjes së veprimeve të iniciuara nga DOM-i, si dhe në rrethana të paparashikuara kur lind nevoja, kërkon ndryshimin e orareve të operimit të sistemit AIPS, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, deri në finalizimin e shlyerjes;
5. njofton DSPKF-në në rastet kur ka evidencë se një subjekt pjesëmarrës në sistemin AIPS paraqet vështirësi financiare apo është vendosur në një status të caktuar me ndikim në sistemin e pagesave, si dhe kur evidentohen zhvillime në sektorin bankar me ndikim në sistemin e pagesave. Në situata të tilla, aty ku është e aplikueshme,

- bashkëpunon ngushtësisht me DM-në, DNJ-në dhe DSPKF-në;
6. bashkëpunon dhe shkëmben informacione me DSPKF-në, DM-në dhe DNJ-në për krijimin e mjeteve dhe procedurave, në kuadër të ruajtjes së sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të pagesave.

Neni 8 Funksionet e DE-së

DE-ja, në lidhje me sistemin AIPS, ushtron funksionet e mëposhtme:

1. inicion dhe transferon veprime për qëllime të aktivitetit operacional të DE-së nëpërmjet sistemeve vartëse, shlyerja e cash-it e të cilave realizohet në sistemin AIPS;
2. përdor mjetet që ka në dispozicion për t'u informuar mbi statusin e shlyerjes në AIPS të transaksioneve të iniciuara prej tij;
3. Kryen rakordimin ditor me DSPKF-në për veprimet e iniciuara në sistemet e varura nga DE-ja dhe të shlyera në sistemin AIPS;
4. bashkëpunon me DSPKF-në në funksion të realizimit të shlyerjes së veprimeve të iniciuara nga DE-ja, si dhe, në rrethana të paparashikuara kur lind nevoja, kërkon ndryshimin e orareve të operimit të sistemit AIPS, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, deri në finalizimin e shlyerjes.

Neni 9 Funksionet e DM-së

DM-ja, në lidhje me sistemin AIPS, ushtron funksionet e mëposhtme:

1. nëse gjatë proceseve të inspektimit të ushtruara nga DM-ja tek subjektet pjesëmarrëse në sistemin AIPS dhe që mbikëqyren prej saj, verifikohet se komisionet bankare të aplikuara prej tyre ndaj klientëve për urdhërpagesa në nisje dhe në mbërritje në sistemin AIPS, janë mbi kufijtë e përcaktuar në rregullat e funksionimit të sistemit AIPS, atëherë DM-ja njofton me shkresë zyrtare DSPKF-në për rastin e verifikuar të shkeljes së rregullores për sistemin AIPS në fuqi;
2. në përfundim të inspektimit të plotë ose të pjesshëm, të kryer nga ana e saj pranë subjekteve bankare, i përcjell DSPKF-së rezultatet e inspektimit në lidhje me sistemet e pagesave që operohen nga Banka e Shqipërisë. Përcjellja e rezultateve mund të bëhet me shkresë zyrtare ose në format elektronik nga/për punonjësit e përcaktuar nga Drejtuesi i njësisë përkatëse;
3. njofton pa vonesë DSPKF-në, në raste kur nga DM-ja evidentohet se një subjekt pjesëmarrës në sistemin AIPS paraqet vështirësi financiare, apo është vendosur në një status të caktuar me ndikim në sistemin e pagesave, është në proces likuidimi/falimentimi, si dhe kur evidentohen zhvillime në sektorin bankar me ndikim në sistemin e pagesave. Në situata të tilla, aty ku është e aplikueshme, bashkëpunon ngushtësisht me DOM-in, DNJ-në dhe DSPKF-në;
4. njofton pa vonesë DSPKF-në në çdo rast kur nis një proces bashkimi/

- përthithjeje e një banke me/nga një/disë bankë/a në një të vetme, në çdo rast kur nis një vendosje në proces likuidimi/falimentimi, si dhe kur nis një proces pezullimi apo revokimi (shfuqizimi) i licencës së një subjekti, i cili mbikëqyret nga DM-ja dhe është pjesëmarrës në sistemet e pagesave;
5. bashkëpunon dhe shkëmben informacione me DSPKF-në, DOM-in dhe DNJ-në për krijimin e mjeteve dhe procedurave, në kuadër të ruajtjes së sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të pagesave;
 6. në çdo rast kur njoftohet nga DSPKF-ja mbi transaksione të filtruara në sistemin AIPS sipas listës së sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, kryen njoftimin e nevojshëm pranë autoriteteve kompetente dhe ndjek rastin në rolin e autoritetit mbikëqyrës.

NENI 10 FUNKSIONET E DNJ-SË

DNJ-ja, në lidhje me sistemin AIPS, ushtron funksionet e mëposhtme:

1. në rast konstatimi se për një bankë pjesëmarrëse në sistemin AIPS janë plotësuar kushtet për vendosjen e saj në ndërhyrje të jashtëzakonshme, ia komunikon këtë konstatim pa vonesë DSPKF-së;
2. gjatë zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për një bankë pjesëmarrëse, sigurohet që të ruhet akses i kësaj të fundit në sistemet e pagesave, duke bashkëpunuar me DSPKF-në për masat që duhet të ndërmerren;
3. në kuadër të rasteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për një bankë pjesëmarrëse në sistemin AIPS, bashkëpunon ngushtësisht me DSPKF-në dhe DOM-in;
4. bashkëpunon dhe shkëmben informacione me DSPKF-në, DOM-in dhe DM-në për krijimin e mjeteve dhe procedurave në kuadër të ruajtjes së sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të pagesave.

KREU III PJESËMARRJA NË SISTEMIN AIPS

Neni 11 Procedurat e anëtarësimit

Procedurat e anëtarësimit si pjesëmarrës në AIPS ndiqen nga DSPKF-ja dhe DTI-ja, në bashkëpunim me kandidatin për pjesëmarrës, si dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Këto procedura kalojnë në hapat e mëposhtëm.

1. DSPKF-ja merr në shqyrtim kërkesën zyrtare të kandidatit për anëtarësim në sistemin AIPS, dhe informon kandidatin për miratimin ose jo të kërkesës së tij. Nëse kërkesa e kandidatit miratohet, atëherë vijohet me hapat e tjerë.
2. Informimi dhe asistencë teknike për kandidatin në procesin e anëtarësimit

- a) DSPKF-ja informon kandidatin mbi të drejtat dhe detyrimet që lindin me anëtarësimin e tij si pjesëmarrës në sistemin AIPS, duke i vënë në dispozicion aktet nënligjore në fuqi lidhur me sistemin AIPS, si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.
 - b) DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë për hartimin, rast pas rasti, të kalendarit të detajuar me hapat teknikë të anëtarësimit, dhe DSPKF-ja ia komunikon atë kandidatit.
 - c) DTI-ja informon kandidatin mbi infrastrukturën teknike që duhet të ketë në dispozicion dhe për detaje të tjera të lidhura me parametra dhe kushte teknike që infrastruktura duhet të plotësojë, si dhe e asiston teknikisht atë.
 - d) DTI-ja vë në dispozicion të kandidatit mjetet e duhura, aty ku është e aplikueshme, si dhe dokumentacionin teknik të nevojshëm për kryerjen e instalimeve dhe implementimin e infrastrukturës së duhur për operimin e kandidatit në sistemin AIPS.
 - e) DTI-ja dhe DSPKF-ja udhëzojnë dhe ndjekin procesin e anëtarësimit të kandidatit në AIPS CUG dhe shërbimin përkatës të SWIFT-it.
3. Testimi dhe trajnimi i kandidatit
- a) DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë për trajnimin e përdoruesve të ardhshëm të kandidatit për funksionet e sistemit AIPS.
 - b) DTI-ja dhe DSPKF-ja, në bashkëpunim me kandidatin, kryejnë testimet e nevojshme në sistemin AIPS.
 - c) DTI-ja, në bashkëpunim me kandidatin, kryen testime për elementet teknike të infrastrukturës që do të mbështesë operimin e kandidatit në sistemin AIPS.
4. Aksesimi i sistemit TEST
- a) DTI-ja pajis kandidatin me certifikatat dhe pajisjet e sigurisë, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AIPS.
 - b) DTI-ja krijon përdoruesit e kandidatit në VPN, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AIPS.
 - c) DTI-ja krijon dy oficerët e sigurisë së kandidatit në sistemin TEST, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AIPS.
5. Përgatitja e dokumentacionit
- a) DSPKF-ja dhe DTI-ja këshillojnë kandidatin gjatë procesit të hartimit të dokumentacionit dhe bazës rregullative mbi:
 - i. operimin në sistemin AIPS;
 - ii. sigurinë e transmetimit të informacionit/instrukcioneve nga sistemet e tij për në sistemin AIPS;
 - iii. planet e emergjencës.
6. Pranimi në anëtarësim
- a) DTI-ja dhe DSPKF-ja shqyrtojnë plotësimin e dokumentacionit dhe bazës rregullative, si dhe plotësimin e të gjitha kushteve për pjesëmarrje në sistemin AIPS nga ana e kandidatit, dhe, nëse e vlerësojnë të plotë dokumentacionin dhe vlerësojnë se kandidati i plotëson të gjitha kushtet, vijojnë me hapat e tjerë.

- b) DSPKF-ja ruan dokumentacionin e anëtarësimit të kandidatit, përfshirë marrëveshjen tip të pjesëmarrjes së kandidatit në sistemin AIPS.
7. Aktivizimi i pjesëmarrësit
- a) DSPKF-ja krijon pjesëmarrësin në sistemin AIPS, pas nënshkrimit të marrëveshjes tip të pjesëmarrjes në sistemin AIPS.
 - b) DSPKF-ja njofton pjesëmarrësit e tjerë për anëtarësimin e pjesëmarrësit të ri 5 (pesë) ditë pune përpara datës në të cilën ky pjesëmarrës fillon veprimtarinë live në sistemin AIPS.
 - c) DTI-ja pajis pjesëmarrësin me certifikatat dhe pajisjet e sigurisë, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AIPS.
 - d) DTI-ja krijon përdoruesit e pjesëmarrësit në VPN, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AIPS.
 - e) DTI-ja krijon dy oficerët e sigurisë së pjesëmarrësit në sistemin LIVE, në përputhje me formularin përkatës të rregullores për sistemin AIPS.

Neni 12 Kufizimi i përkohshëm dhe përjashtimi

Kufizimi i përkohshëm apo përjashtimi i një pjesëmarrësi në sistemin AIPS kryhet në bashkëpunim të ngushtë të DSPKF-së, DOM-it, DM-së e DNJ-së, sipas rastit, dhe miratohet nga Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës së Shqipërisë.

KREU IV ADMINISTRIMI I SISTEMIT AIPS

Neni 13 Administrimi i pjesëmarrësit

Në drejtim të administrimit të pjesëmarrësit në sistemin AIPS, DSPKF-ja kryen funksionet e mëposhtme:

1. krijon pjesëmarrësin në sistemin AIPS dhe kryen njoftimet përkatëse, siç është përcaktuar në procedurat e anëtarësimit;
2. krijon dhe administron llogaritë në sistemin AIPS;
3. me kërkesë/njoftim të pjesëmarrësit, modifikon/përditëson detaje të pjesëmarrësit, si adresa, personat e kontaktit etj.;
4. bazuar në vendime për ndryshime në lidhje me subjektin pjesëmarrës, kryen modifikimin/përditësimin e pjesëmarrësit dhe/ose llogarive të shlyerjes së pjesëmarrësit në sistemin AIPS;
5. kufizon përkohësisht aksesin e pjesëmarrësit në sistemin AIPS dhe/ose përjashton pjesëmarrësin nga sistemi AIPS, si dhe kryen njoftimet përkatëse, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi;
6. në rastin e kufizimit të përkohshëm apo të përjashtimit të një pjesëmarrësi nga sistemi AIPS, diskuton paraprakisht dhe koordinon me DOM-in e DM-në, dhe në rastin e plotësimit të kushteve për

ndërhyrjen e jashtëzakonshme, edhe me DNJ-në për procedurat që do të ndiqen;

7. në raste të përjashtimit të një pjesëmarrësi nga sistemi AIPS:
 - a) njofton me shkresë zyrtare DM-në, DOM-in dhe DE-në për ekzekutimin e mbylljes së llogarive të shlyerjes së pjesëmarrësit,
 - b) njofton me shkresë zyrtare DTI-në për kryerjen e fshirjes/bllokimit të përdoruesve të pjesëmarrësit nga sistemi AIPS, si dhe për të marrë masat e nevojshme lidhur me AIPS CUG dhe shërbimin përkatës të SWIFT-it për këtë pjesëmarrës.

Neni 14 **Administrimi i përdoruesve**

1. DSPKF-ja, në cilësinë e përgjegjësit të sistemit AIPS, në bashkëpunim me DTI-në, përcakton matricën e korrespondencës së funksionaliteteve të sistemit AIPS që i përkasin roleve për të drejtat e përdoruesve, bazuar në aktivitetin operacional që duhet të kryejnë, duke pasur në vëmendje parimet bazë "të katër syve" dhe të të drejtave minimale në sistemin AIPS.
2. DTI-ja, në cilësinë e kujdestarit të sistemit, realizon veprimet e mëposhtme, në lidhje me administrimin e përdoruesve të sistemit AIPS:
 - a) krijon teknikisht rolet për të drejtat e përdoruesve në sistemin AIPS, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni;
 - b) krijon përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në sistemin AIPS test, pas miratimit me e-mail të drejtuesit të DSPKF-së;
 - c) krijon, modifikon ose fshin përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në sistemin AIPS primar, sipas kërkesës së nënshkruar nga drejtuesi i Departamentit kërkues, dhe të miratuar nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së, sipas Shtojcës A bashkëlidhur;
 - d) administron certifikatat dixhitale për përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në lidhje me sistemin AIPS, sipas kërkesës së nënshkruar nga drejtuesi i Departamentit kërkues, dhe të miratuar nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së, sipas Shtojcës B bashkëlidhur;
 - e) bazuar në aktet nënligjore në fuqi, për përdoruesit e Bankës së Shqipërisë në sistemin AIPS, modifikon statusin e llogarisë së përdoruesit dhe/ose rivendos fjalëkalimin e tij, në përputhje me kërkesën për ndryshim në llogarinë e përdoruesit nga drejtuesi i Departamentit përkatës dhe zotëruesi i llogarisë, në rastin e rivendosjes së fjalëkalimit;
 - f) krijon, modifikon ose fshin përdorues të një pjesëmarrësi, si dhe rivendos fjalëkalim të përdoruesit të pjesëmarrësit, në rast pamundësie të kryerjes së kësaj procedure nga vetë pjesëmarrësi, sipas përcaktimeve në rregulloren për sistemin AIPS;
 - g) rinovon çdo vit certifikatat dixhitale të përdoruesve të pjesëmarrësve në sistemin AIPS, të paraqitura prej tyre në Bankën e Shqipërisë në përfundim të afatit të skadencës, sipas përcaktimeve në rregulloren për sistemin AIPS.

Neni 15 Administrimi i kalendarit

Në bazë të njoftimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë mbi kalendarin e festave zyrtare, DSPKF-ja:

- a) plotëson kalendarin për vitin pasardhës para fillimit të vitit të ri ushtrimor;
- b) ndryshon kalendarin dhe njofton pjesëmarrësit, në çdo rast kur është e mundur jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e kryerjes së këtyre ndryshimeve.

Neni 16 Administrimi i orareve të operimit

1. DSPKF-ja ndryshon oraret e operimit në sistemin AIPS në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe pasi vlerëson rrethanat në të cilat lind nevoja për ndryshim të orareve, duke përfshirë këtu:
 - a) ngjarje të paparashikuara dhe situata emergjence;
 - b) kërkesë nga një njësi e Bankës së Shqipërisë;
 - c) kërkesë nga një pjesëmarrës.
2. DSPKF-ja lajmëron pjesëmarrësit e sistemit AIPS për ndryshimin e orareve, me e-mail ose mesazh SWIFT.

Neni 17 Testimi dhe ndryshimet në sistem

1. Çdo kërkesë për ndryshim në sistemin AIPS vlerësohet nga DSPKF-ja dhe DTI-ja, dhe miratohet prej tyre për t'u zbatuar kur çmohet e arsyeshme.
2. Në rastet kur ndryshimet e propozuara kanë ndikime tek pjesëmarrësit e tjerë të sistemit AIPS, DSPKF-ja dhe DTI-ja këshillohen paraprakisht me këta të fundit.
3. DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë në kryerjen e testeve, në raste kur lind nevoja të shqyrtohen sjellje funksionale të sistemit, ndërveprime të tij me sisteme të tjerë, përditësime të ofruara nga kompania kontraktore që kryen mirëmbajtjen e sistemit AIPS, si dhe kur evidentohen problematika në funksionim.
4. Çdo ndryshim duhet të aplikohet në sistemin AIPS vetëm pasi të jetë testuar në ambientin e dedikuar për testim, dhe pas miratimit nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së. DTI-ja kujdeset që aplikimi i ndryshimeve në sistemin AIPS të kryhet në të dy ambientet, primar dhe backup.
5. Në lidhje me ndryshime të rëndësishme, të cilat prekin aspekte të caktuara të sistemit AIPS, siç është përcaktuar në aktet në fuqi në lidhje me mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë, DTI-ja dhe DSPKF-ja njoftojnë njësinë përgjegjëse në Bankën e Shqipërisë që kryen këtë funksion.
6. DTI-ja dhe DSPKF-ja konsultohen me njësinë përgjegjëse në

Bankën e Shqipërisë që kryen funksionin e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë për të shqyrtuar ndikimet e mundshme që mund të kenë ndryshimet në përputhshmërinë e sistemeve me parimet mbikëqyrëse.

KREU V **VEPRIMTARIA OPERACIONALE NË AIPS**

Neni 18 **Hapja e ditës së punës**

1. DTI-ja kujdeset për të gjithë komponentët e infrastrukturës teknike për të garantuar disponueshmërinë e sistemit AIPS gjatë gjithë kohës së operimit.
2. DTI-ja kujdeset për mirëfunksionimin e të gjitha elementeve të nevojshme të infrastrukturës për shkarkimin dhe garantimin e sigurisë maksimale në procesin e shkarkimit dhe importimit nga DSPKF-ja në sistemin AIPS, të listës së sanksioneve të publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
3. DSPKF-ja shkarkon dhe importon në sistemin AIPS listën e përditësuar të sanksioneve sipas udhëzimeve të DTI-së.
4. DSPKF-ja dhe DTI-ja duhet të sigurohen që hapat e përcaktuar për përditësimin në sistemin AIPS të listës së sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të jenë realizuar përpara orareve të përcaktuara për hapjen e ditës së punës.
5. Hapja e ditës së punës në sistemin AIPS mund të realizohet në formë automatike ose me ndërveprim të përdoruesit (manuale). DSPKF-ja vlerëson formën më të përshtatshme për realizimin e hapjes së ditës së punës dhe konfiguron sistemin në njërin prej dy formave, e cila mbahet e pandryshuar deri në një vlerësim të ndryshëm nga i fundit.
6. Nëse forma e hapjes së ditës së punës në sistemin AIPS është automatike, atëherë DSPKF-ja monitoron në çdo orar hapjeje të ditës së punës, statusin e realizimit të këtij procesi.
7. Nëse forma e hapjes së ditës së punës në sistemin AIPS është manuale, atëherë DSPKF-ja, në përputhje me oraret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi, ekzekuton procesin e hapjes së ditës së punës në sistemin AIPS dhe monitoron ecurinë dhe statusin e realizimit të këtij procesi.

Neni 19 **Mbyllja e ditës së punës**

1. Në prag të përfundimit të ditës së punës, DSPKF-ja koordinohet me DOM-in dhe DE-në për të evidentuar nëse kanë ende veprime për të cilat është i nevojshëm ndryshimi i orareve të operimit të sistemit AIPS dhe, nëse vlerësohet e përshtatshme, kryen ndryshimin e orareve në përputhje me nevojat e njëjësive të Bankës së Shqipërisë.
2. Në rast se lind nevoja që ndryshimi i orareve të operimit të sistemit AIPS dhe mbyllja e sistemit të shtrihet përtej orarit zyrtar, atëherë

- DSPKF-ja njofton DTI-në. Në këtë rast, DTI-ja kryen shtyrjen e orarit të sistemit SWIFT deri në një orar të përcaktuar sipas komunikimit me DSPKF-në, dhe, sipas rastiit, përcakton një të mundësitë:
- a) të lejohen mesazhe hyrëse dhe dalëse në AIPS;
 - b) të lejohen vetëm mesazhe dalëse nga AIPS.
3. Nëse në fund të ditës së punës, në sistemin AIPS, ka transaksion në gjendje pezull për çështje përputhshmërie me listën e sanksioneve, atëherë DSPKF-ja njofton pjesëmarrësin që të kryejë anulimin e tij. Nëse pjesëmarrësi nuk është në gjendje të anulojë transaksionin, atëherë anulimin e transaksionit e kryen DSPKF-ja. Më pas mund të kryhet mbyllja e ditës së punës në sistemin AIPS.
 4. Sa herë që evidentohen transaksione të filtruara sipas listës së sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, DSPKF-ja informon me shkresë zyrtare DM-në me të dhënat sipas raportit që gjeneron sistemi AIPS.
 5. Mbyllja e ditës së punës në sistemin AIPS mund të realizohet në formë automatike ose me ndërveprim të përdoruesit (manuale). DSPKF-ja vlerëson formën më të përshtatshme për realizimin e mbylljes së ditës së punës dhe konfiguron sistemin në një të prej dy formave, e cila mbahet e pa ndryshuar deri në një vlerësim të ndryshëm nga i fundit.
 6. Nëse forma e mbylljes së ditës së punës në sistemin AIPS është automatike, atëherë DSPKF-ja monitoron në çdo orar mbylljeje të ditës së punës, statusin e realizimit të këtij procesi.
 7. Nëse forma e mbylljes së ditës së punës në sistemin AIPS është manuale, atëherë DSPKF-ja, në përputhje me oraret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi, ekzekuton procesin e mbylljes së ditës së punës në sistemin AIPS dhe monitoron ecurinë dhe statusin e realizimit të këtij procesi.
 8. Nëpërmjet mesazheve SWIFT, sistemi njofton të gjithë pjesëmarrësit për mbylljen e ditës së punës në sistemin AIPS.
 9. DTI-ja kujdeset për realizimin e procedurave teknike të përcaktuara në funksion të vazhdimësisë së biznesit për sistemin AIPS.

Neni 20 **Monitorimi i sistemit**

Monitorimi i sistemit AIPS kryhet bashkërisht nga DSPKF-ja dhe DTI-ja.

1. DSPKF-ja monitoron gjendjen e sistemit gjatë gjithë ditës së punës dhe në veçanti:
 - a) hapjen dhe mbylljen e ditës së punës;
 - b) shlyerjen e instruksioneve të pagesave në sistem;
 - c) shlyerjet neto dhe ato nga sistemet vartëse;
 - d) statusin e pagesave në sistem;
 - e) evidentimin nëse konstatohet se ka transaksione në gjendje pezull për çështje përputhshmërie me listën e sanksioneve;
 - f) gjendjen e llogarive të pastrimit të sistemeve vartëse.
2. DTI-ja monitoron gjendjen teknike të sistemit AIPS gjatë gjithë ditës së punës dhe në veçanti:

- a) hapjen dhe mbylljen e ditës së punës;
 - b) gjendjen e shërbimeve në funksion të sistemit AIPS;
 - c) gjendjen e infrastrukturës që ofron shërbimin e AIPS ndaj pjesëmarrësve;
 - d) gjurmët e aktivitetit të sistemit në drejtim të evidentimit të problematikave të mundshme.
3. DSPKF-ja ndjek rastet me pasaktësi në instruksionet e pagesave të iniciuara dhe/ose të mbërritura në favor të Bankës së Shqipërisë.
 4. Në rast se DSPKF-ja, gjatë monitorimit të aktivitetit ditor, konstaton transaksione në gjendje pezull për çështje përputhshmërie me listën e sanksioneve, menjëherë kontakton me pjesëmarrësin për trajtimin e tij, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore.
 5. Në rast se DSPKF-ja, gjatë monitorimit të aktivitetit ditor, vë re anomali në funksionimin e sistemit, menjëherë njofton DTI-në dhe DOM-in me e-mail ose mjete të tjera komunikimi.
 6. Në rast se DTI-ja, gjatë monitorimit të aktivitetit ditor të sistemeve që administron, vë re anomali, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikojnë elemente të mirëfunksionimit të sistemit AIPS, njofton menjëherë me e-mail DSPKF-në dhe DOM-in.

Neni 21

Veprimet e Bankës së Shqipërisë si pjesëmarrëse e sistemit AIPS

1. Veprimet e iniciuara nga Banka e Shqipërisë si pjesëmarrëse e sistemit AIPS përfshijnë:
 - a) instruksione të pagesave të gjeneruara automatikisht në sistemin AIPS nga ndërfaqësimi me sistemin e Financës së Bankës së Shqipërisë;
 - b) instruksione të pagesave të regjistruara nga DSPKF-ja me urdhër të njësisë së Financës së Bankës së Shqipërisë, në rastet kur këto instruksione nuk mund të gjenerohen automatikisht në sistemin AIPS;
 - c) instruksione të pagesave të regjistruara nga DSPKF-ja për llogari të departamenteve të tjera të Bankës së Shqipërisë.
2. Krahas veprimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ekzekutohen edhe veprimet e mbërritura në sistemin AIPS nga pjesëmarrësit në favor të Bankës së Shqipërisë.
3. DSPKF-ja ndjek ecurinë e plotë të procesimit të instruksioneve të pagesave të iniciuara nga Banka e Shqipërisë dhe të mbërritura në favor të saj, që përfshin:
 - a) transmetimin e instruksioneve të pagesave në sistemin AIPS;
 - b) shlyerjen e instruksioneve të pagesave në sistemin AIPS;
 - c) dokumentimin e veprimeve në llogaritë përkatëse.

Neni 22

Shlyerja në AIPS e veprimeve të sistemeve vartëse

1. Në sistemin AIPS realizohet shlyerja e *cash*-it të veprimeve të iniciuara nga sistemet vartëse.

2. Transaksionet në AIPS, për efekt të shlyerjes së veprimeve të origjinuara nga sistemet vartëse, gjenerohen nëpërmjet ndërfaqeve respektive me këto sisteme.
3. Sistemi AIPS proceson instruksionet me origjinë nga sistemet vartëse dhe, në mungesë të fondeve të mjaftueshme, e vendos instruksionin e pagesës në radhën e pritjes, duke marrë parasysh radhën e përparësisë.
4. DSPKF-ja monitoron në sistemin AIPS transaksionet me origjinë nga sistemet vartëse dhe ndjek shlyerjen e tyre. Në rast mungese fondesh, DSPKF-ja komunikon me departamentet përkatëse në Bankën e Shqipërisë, si dhe pjesëmarrësit.
5. Në rast se pranë *Cut-off*-it përfundimtar evidentohen në radhën e pritjes transaksione të origjinuara nga sistemet vartëse, për të cilat përgjegjës i sistemit është DOM-i, DSPKF-ja e njofton atë për koordinimin dhe zgjidhjen e situatës.
6. Në fund të çdo dite pune, DSPKF-ja dhe DE-ja kryejnë rakordimin e llogarive të cilat preken nga aktiviteti i përbashkët.
7. Në rast pamundësie për të kryer një korrigjim të nevojshëm nga ana e DOM-it në një transaksion të origjinuar nga sistemet vartëse për të cilat ai është përgjegjës i sistemit, atëherë DOM udhëzon me shkresë zyrtare dhe në raste urgjente me e-mail, me miratim nga Drejtori ose në mungesë të tij Zëvendës Drejtori i DOM, për pasqyrimin e veprimit në AIPS manualisht nga DSPKF-ja.
8. Në rast pamundësie për të kryer një korrigjim të nevojshëm nga ana e DE-së në një transaksion të origjinuar nga sistemet vartëse për të cilat ajo është përgjegjëse e sistemit, atëherë DE-ja udhëzon me shkresë zyrtare dhe në raste urgjente me e-mail, duke bashkëngjitur të skanuar dokumentacionin dhe me miratimin nga Drejtori ose në mungesë të tij Zëvendës Drejtori i DE-së, për pasqyrimin e veprimit në AIPS manualisht nga DSPKF-ja.
9. DOM-i dhe DE-ja, pasi kanë përfunduar aktivitetet e lidhura me sistemin AIPS, njoftojnë respektivisht DSPKF-në për të vijuar me mbylljen e ditës së punës.

Neni 23 **Veprimet për Ministrinë**

Në zbatim të rolit të Bankës së Shqipërisë bazuar në marrëveshjen e posaçme të lidhur midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë:

1. DTI-ja është përgjegjëse për:
 - a) mbarëvajtjen e infrastrukturës dhe proceseve teknike të lidhura me Ministrinë në funksion të sistemit AIPS;
 - b) integritetin e transmetimit të informacionit në infrastrukturën për të cilën është përgjegjëse Banka e Shqipërisë;
 - c) dërgimin e raporteve elektronike të gjeneruara nga sistemi AIPS drejt Ministrisë, për gjendjet e llogarive të Ministrisë dhe listës së transaksioneve të iniciuara prej Ministrisë që nuk ka qenë e mundur të shlyhen në sistemin AIPS.

2. DSPKF-ja është përgjegjëse për:
 - a) procesimin e instruksioneve të pagesave të Ministrisë;
 - b) ndjekjen e procesit të shlyerjes së instruksioneve të pagesave të Ministrisë;
 - c) mbajtjen e kontakteve dhe komunikimin me Ministrinë për rastet e pamjaftueshmërisë së fondeve dhe për të gjitha ngjarjet që pengojnë mbarëvajtjen e ndjekjes së procesit të shlyerjes;
 - d) dokumentimin e veprimeve të llogarive të Ministrisë.

Neni 24

Veprimet për pjesëmarrësit e tjerë të tërthortë

Në zbatim të akteve nënligjore apo procedurave nga të cilat buron e drejta për të kryer veprime financiare për pjesëmarrës të tërthortë të nënkategorive ii. dhe iii. sipas kategorizimit të përcaktuar në rregulloren për sistemin AIPS, DSPKF-ja është përgjegjëse për:

- a) procesimin e instruksioneve të pagesave të urdhëruara prej tyre;
- b) monitorimin e aktivitetit të lidhur me llogaritë e tyre;
- c) dokumentimin e veprimeve të këtyre llogarive.

Neni 25

Rezerva e detyruar, interesat dhe gjobat

1. DOM-i paraqet çdo muaj me shkresë zyrtare pranë DSPKF-së, gjendjen e rezervave të detyruara për secilën bankë pjesëmarrëse, si dhe normën e remunerimit dhe të gjobave për mosplotësimin e rezervës së detyruar, minimalisht një ditë pune përpara datës së regjistrimit të rezervës së detyruar në sistemin AIPS.
2. DSPKF-ja realizon regjistrimin në sistemin AIPS të rezervave të detyruara për secilën bankë pjesëmarrëse.
3. DSPKF-ja gjeneron në sistemin AIPS përlllogaritjen e remunerimit dhe gjobave për secilën bankë pjesëmarrëse.
4. Në çdo rast kur verifikohen pasaktësi në llogaritje, DSPKF-ja dhe DOM-i koordinohen për kryerjen e saktësimeve.

KREU VI

NGJARJET E PAPANASHIKUARA DHE SITUATAT E EMERGJENCËS

Neni 26

Administrimi i ngjarjeve të paparashikuara dhe situatave të emergjencës

1. Ngjarje e paparashikuar, në kuptimin e sistemit AIPS, konsiderohet çdo mosfunktionim në:
 - a) infrastrukturën e sistemit AIPS;
 - b) komponentë të infrastrukturës IT që ka ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në mirëfunktionimin e sistemit AIPS.
2. Situatë emergjence, në kuptimin e sistemit AIPS, konsiderohet çdo ndërprerje e rëndësishme e funksionimit të shërbimit të sistemit AIPS.

3. Shpallja e situatës së emergjencës kryhet nga DSPKF-ja dhe DTI-ja, në bashkëpunim.
4. Ngjarjet e paparashikuara dhe situatat e emergjencës administrohen nga DTI-ja dhe DSPKF-ja, në bashkëpunim dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.
5. Në çdo rast kur DTI-ja konstaton një ngjarje të paparashikuar apo situatë emergjence në kuptimin e sistemit AIPS, njofton menjëherë DSPKF-në dhe DOM-in.
6. Në çdo rast kur DSPKF-ja konstaton një mosfunksionim në sistemin AIPS, njofton menjëherë DTI-në.
7. Menjëherë pas konstatimit të një ngjarjeje të paparashikuar apo të një situatë emergjence në kuptimin e sistemit AIPS, DTI-ja merr masa për zgjidhjen e saj.
8. DTI-ja dhe DSPKF-ja bashkëpunojnë për formulimin e njoftimit për pjesëmarrësit, në rast se është e nevojshme.
9. Në rast se brenda 30 minutave nga konstatimi i ngjarjes së paparashikuar apo situatës së emergjencës, problematika nuk është zgjidhur dhe mosfunksionimi ndikon operacionet e pjesëmarrësve në sistemin AIPS, DSPKF-ja dërgon me mesazh SWIFT dhe/ose e-mail njoftimin për pjesëmarrësit e sistemit, sipas formulimit të përbashkët me DTI-në.
10. Në rast se, për shkak të ngjarjes së paparashikuar apo situatës së emergjencës, rivënia në punë e sistemit AIPS primar është e pamundur, DTI-ja realizon procedurat për kalimin në sistemin backup.
11. DTI-ja, në bashkëpunim me DSPKF-në, udhëzon pjesëmarrësit për hapat që duhet të ndjekin për kalimin në sistemin backup dhe vazhdimin e veprimeve operacionale.
12. Me rikthimin e situatës në normalitet dhe kalimin në sistemin AIPS primar, DTI-ja, në bashkëpunim me DSPKF-në, udhëzon pjesëmarrësit.
13. Menjëherë pas zgjidhjes së situatës, DSPKF-ja njofton pjesëmarrësit me mesazh SWIFT dhe/ose e-mail.
14. Ngjarjet e paparashikuara dhe situatat e emergjencës të lidhura me sistemin AIPS raportohen në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Neni 27 **Forca madhore**

1. Në rastin e situatave që krijohen si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme, luftërave, turbullirave të tjera civile, fatkeqësive natyrore dhe për çdo rrethanë tjetër jashtë kontrollit të Bankës së Shqipërisë si operator i sistemit dhe pjesëmarrësve në sistem, si dhe si pasojë e çdo force tjetër madhore, drejtuesit e DTI-së dhe DSPKF-së, kur është e mundur, vendosin për ndërprerjen e menjëhershme të operimit të sistemit AIPS, me qëllim mbrojtjen e pajisjeve, të dhënave dhe komponentëve të tjerë mbështetës të tij.
2. Me përfundimin e ngjarjeve që përbëjnë forcë madhore, DTI-ja dhe DSPKF-ja ndërmarrin hapat e nevojshëm për rifillimin e operimit të sistemit AIPS, duke monitoruar dhe kontrolluar në mënyrë të hollësishme transaksionet në sistemin AIPS.

3. DTI-ja dhe DSPKF-ja kryejnë analiza mbi aktivitetin dhe mbi bashkëveprimin e njërive të Bankës së Shqipërisë gjatë rasteve të forcave madhore, si dhe mbi përpjekjet e bëra për të mundësuar kthimin e aktivitetit operacional në sistem. Kur shihet e nevojshme, propozohen masa për përmirësime të procedurave dhe/ose të konfigurimeve të sistemeve dhe pajisjeve.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 28 Organizimi i brendshëm

1. Organizimi i brendshëm i punës brenda njërive organizative të Bankës së Shqipërisë të përmendura në këtë rregullore, për ushtrimin e funksioneve dhe zbatimin e detyrave të përcaktuara nga dispozitat e saj, përcaktohet nëpërmjet manualeve përkatëse të veprimtarisë për çdo njësi organizative përbërëse, si dhe në përshkrimet e vendeve të punës së punonjësve.
2. Manualët dhe përshkrimet e vendeve të punës të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, hartohen në përputhje me manualët e përdorimit të sistemit AIPS dhe me dispozitat e rregulloreve të organizimit dhe funksionimit të departamenteve përkatëse.
3. Matrica e korrespondencës së funksionaliteteve të sistemit AIPS që i përkasin roleve të përcaktuara për dhënien e aksesit përdoruesve në funksion të kryerjes së detyrave të tyre operacionale në sistemin AIPS, miratohet nga drejtuesit e DTI-së dhe DSPKF-së.
4. Kalendarit i anëtarësimit të pjesëmarrësit në sistemin AIPS është subjekt i specifikave që lidhen me ndryshimet teknologjike dhe përditësimet e herëpashershme të cilave i nënshtrohet sistemi AIPS, dhe hartohet rast pas rasti nga DSPKF-ja dhe DTI-ja, në bashkëpunim, si dhe miratohet nga drejtuesit e DSPKF-së dhe DTI-së.

Neni 29 Hyrja në fuqi

Rregullorja hyn në fuqi pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

GENT SEJKO

SHTOJCA A



**BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE DHE I KONTABILITETIT DHE FINANCËS
KËRKESË PËR APROVIM PROFILI PËRDORUESI NË AIPS**

Drejtori i
Departamentit kërkues

(_____)

Tiranë, më _____ / _____ / _____

Departamenti: _____

Spektori: _____

Drejtori i DSPKF


(_____)

Punonjësit: _____ me detyrë: _____ t'i jepen
të drejtat si më poshtë:

Nr.	Aplikacioni AIPS	Përdorues	Nr.	Aplikacioni PO	Përdorues
1	Aprovues Execute AIPS	<input type="checkbox"/>	1	Operator AIPS	<input type="checkbox"/>
2	Operator Execute AIPS	<input type="checkbox"/>	2	Aprovues AIPS	<input type="checkbox"/>
3	Operator AIPS	<input type="checkbox"/>	3	Operator Enter (AIPS & AECH)	<input type="checkbox"/>
4	Monitorues	<input type="checkbox"/>	4	Operator Approve (AIPS & AECH)	<input type="checkbox"/>
5	Monitorues BSH	<input type="checkbox"/>	5	Operator Back Office	<input type="checkbox"/>
6	Monitorues MF	<input type="checkbox"/>	6	Aprovues Back Office	<input type="checkbox"/>
7	BOA_Security_Officer	<input type="checkbox"/>	7	Monitorues MF	<input type="checkbox"/>

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit		Drejtori i DTI
Punonjësi	_____	(_____)
Username	_____	Data Nënshkrimi (Firma)
Krijoi	_____	_____
Kontrolloi	_____	_____

SHTOJCA B

KONFIDENCIAL	
	
BANKA E SHQIPËRISË DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	
FORMULARI I KËRKESËS PËR CERTIFIKATË DIXHITALE AIPS	
Të plotësohet ky formular për të administruar certifikatat dixhitale të përdoruesve të Bankës së Shqipërisë lidhur me sistemin AIPS	
Departamenti Kërkues	
Drejtori i Departamentit Kërkues (Emri Mbiemri / Nënshkrimi)	Data e kërkesës: (dd/mm/vvvv)
KËRKESË PËR CERTIFIKATË DIXHITALE	
Nr.	Emri/Mbiemri i përdoruesit
1	<input type="checkbox"/> Gjenerim certifikatë e re <input type="checkbox"/> Rigjenerim certifikate <input type="checkbox"/> Zhbllokim pajisje sigurie <input type="checkbox"/> Rivendosje fjalëkalimi i pajisjes së sigurisë <input type="checkbox"/> Revokim certifikate
Shënim:	
Drejtori i DSPKF (Emri Mbiemri / Nënshkrimi)	Drejtori i DTI (Emri Mbiemri / Nënshkrimi)
Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	
Punonjësi	
Username	Data Nënshkrimi (Firma)
Krijoi	
Kontrolloi	

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 22, NUMËR 1, MARS 2020

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 2, datë 17.1.2020 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 3, datë 17.1.2020 "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e kontratës midis Bankës së Shqipërisë, Kompanisë Montran dhe Regjistrisë Shqiptare të Titujve (ALREG) "Mbi implementimin e ndërfaqes ndërmjet Sistemit të Pagesave Ndërbankare me Vlerë të Madhe (aips) dhe Regjistrisë Shqiptare të Titujve (alreg)"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 5, datë 5.2.2020 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 6, datë 5.2.2020 "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kushteve për dhënie të miratimit paraprak për marrëveshjen e mbështetjes financiare brenda grupit bankar"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 7, datë 5.2.2020 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 8, datë 5.2.2020 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të informacionit që mbahet në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë"
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 5.2.2020 "Për dhënie të miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë financiare shtesë nga Banka Tirana sh.a."
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 10, datë 5.2.2020 "Për rishtypjen e monedhave metalike shqiptare, me kurs ligjor, me prerje 5 Lekë, 20 Lekë dhe 50 Lekë"
9. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. prot. 1473, datë 5.3.2020 "Për dhënie të miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë si agjent në sigurime nga subjekti financiar jobankë "Posta Shqiptare" sh.a."

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 22, NUMËR 2, MARS 2020

1. Vendim qarkullues i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 13, datë 12.3.2020 "Për një ndryshim në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja"
2. Vendim qarkullues i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 14, datë 12.3.2020 "Për një ndryshim në rregulloren "Për

- administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”
3. Vendim qarkullues i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 15, datë 12.3.2020 “Për një ndryshim në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”
 4. Urdhër i Kryeministrit nr. prot. 1756 dhe i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. prot. 1650, datë 17.3.2020
 5. Vendim qarkullues i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 18, datë 25.3.2020 “Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë”
 6. Vendim qarkullues i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 19, datë 25.3.2020 “Për miratimin e pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2019”
 7. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. prot. 1714, datë 25.3.2020 “Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit.

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 22, NUMËR 3, PRILL 2020

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 4.3.2020 “Për miratimin e Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2019”
2. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. prot. 1727, datë 26.3.2020 “Për revokimin e licencës të subjektit financiar jobankë “Albanian Factoring Services (AFS)” sh.a.”
3. Vendim qarkullues i Këshillit Mbikëqyrës nr. 21, datë 1.4.2020 “Për miratimin e “Raportit të Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019”
4. Vendim qarkullues i Këshillit Mbikëqyrës nr. 24, datë 8.4.2020 “Për pezullimin e shpërndarjes së fitimit nga bankat”
5. Vendim qarkullues i Këshillit Mbikëqyrës nr. 26, datë 8.4.2020 “Për heqjen e komisioneve të aplikuara nga bankat për transfertat e kreditit në formë jo letër për klientët e tyre, si dhe të tarifave për pjesëmarrësit banka në sistemet e pagesave AIPS dhe AECH të operuara nga Banka e Shqipërisë”

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 22, NUMËR 4, QERSHOR 2020

1. Vendim i Zëvendësguvernatores së Dytë, nr. 1734, datë 27.03.2020 “Për “Miratimin e politikës së administrimit të mjeteve financiare të fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”
2. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. prot. 1914, datë 15.04.2020 “Për revokimin e licencës të subjektit financiar jobankë “Pay and Go” sh.p.k.”

3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 06.05.2020 "për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 30, datë 06.05.2020 "Për shtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, prerjet 500 lekë dhe 2000 lekë"
5. Vendim qarkullues i Këshillit Mbikëqyrës nr. 33, datë 28.05.2020 "Për disa ndryshime në rregulloren "për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja"
6. Vendim qarkullues i Këshillit Mbikëqyrës nr. 34, datë 28.05.2020 "Për një ndryshim në vendimin për miratimin e rregullores "Për trajtimin jashtëgjyqësor nga bankat, të kredimarrësve në vështirësi financiare"
7. Vendim qarkullues i Këshillit Mbikëqyrës nr. 35, datë 03.06.2020 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – aech"

